




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtina po bëhet

RAPORTI I PUNËS

Mars, 2016

1. PËRMBLEDHJE.....	4
2. AKTIVITETET E ZYRAVE	5
a. Zyra e përfaqësimit juridik	
b. Zyra e auditimit të brendshëm	
c. Departamenti i Prokurimit	
e. Zyra ligjore	
f. Zyra komunale për Integrim evropian	
g. Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore	
3. DREJTORIA E ADMINISTRATËS	16
a. Sektori i bashkësive lokale	
b. Sektori i punëve të Kuvendit	
c. Sektori i gjendjes civile	
d. Qendra e shërbimit për qytetarë	
e. Sektori për punë të përgjithshme dhe juridike	
f. Sektori teknik	
g. Autoparku	
h. Sektori i teknologjisë informative	
4. DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS	32
a. Buxheti për vitin 2015	
b. Të hyrat vetanake	
c. Shpenzimet buxhetore	
d. Sektori i buxhetit dhe financave	
e. Sektori i tatimit në pronë	
f. Sektori i pronës	
5. DREJTORIA E ARSIMIT.....	38
6. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE.....	42
a. Qendra e Mjekësisë Urgjente – QMU	
b. Sektori i mirëqenies sociale	
c. Qendra për Punë Sociale	
d. Shërbimi administrativ financiar	
6. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT.....	55
a. Sektori i ekonomisë	
b. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural	
c. Sektori i pylltarisë	
7. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	60
a. Sektori i urbanizmit	

b. Sektori i planifikimit	
c. Sektori i ndërtimit	
d. Sektori i mbrojtjes së mjedisit	
e. Sektori i legalizimit	
8. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	68
a. Vëllimi financiar dhe fizik i projekteve të realizuara	
b. Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese	
c. Hartimi i projekteve për ofertim	
d. Projektet infrastrukturore të vitit 2011	
e. Projektet infrastrukturore të vitit 2010, të përfunduara në vitin 2011	
f. Rrugët e përcjella në vitin 2012 për shkak të pengesave të ndryshme	
g. Shqyrtimi i kërkesave	
9. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	72
a. Investimet kapitale	
b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme kulturore	
c. Sektori i kulturës	
d. Sektori i sportit dhe rinisë	
e. Institucionet kulturore ndërkomunale	
12. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHPËTIMIT	79
a. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit	
b. Qendra e informimit, alarmimit dhe koordinimit	
c. Brigada profesionale e zjarrfikësve	
13. DREJTORIA E KADASTRIT	89
a. Sektori i kadastrit	
b. Sektori i gjeodezisë	
14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT	93
a. Sektori komunal dhe i komunikacionit	
b. Sektori i inspeksionit të ndërtimit	
c. Sektori i inspeksionit komunal dhe të komunikacionit	
d. Inspeksioni sanitar dhe veterinar	
e. Sektori i tregut dhe bujqësisë	

PËRMBLEDHJE

Komuna e Prishtinës ka përgatitur dy raportet për punët e kryera gjatë vitit 2015. Raporti i parë, i cili është raporti i punës, përmbledh të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e të gjitha njësive të Kabinetit të Kryetarit dhe të sektorëve të drejtorive komunale; ndërsa raporti i dytë paraqet të gjitha zotimet që ka bërë kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti, para fillimit të mandatit dhe realizimin e tyre. Raportet janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për vetëqeverisje lokale për raportim vjetor të Kryetarit të Komunës në Kuvendin e Komunës. Në të dy raportet mund të vërehet se Prishtina ka filluar të shkojë drejt normalitetit. Në fillim të mandatit Prishtina ka qenë në vështirësi të mëdha si qytet pa planifikim të mirëfilltë, me mijëra ndërtime pa leje, mungesë të rregullit dhe investimeve kapitale, mungesë të shërbimeve infrastrukturore, deri tek ato edukative dhe shëndetësore.

Viti 2015, ishte vazhdimi i përmirësimeve të mëtejme në shërbimet edukative, shëndetësore, administrative dhe infrastrukturore. U hapën 3 çerdhe të reja, ndërsa 4 të tjera janë në proces të hapjes, u bë përmirësimi i infrastrukturës së brendshme shkollore – 32 shkolla u pajisën me kabinate mësimore, 12 shkolla u bënë me kënde të leximit, 6 shkolla u bënë me klasa verore, u dixhitalizuan shërbimet administrative, u pastruan 120 deponi ilegale, u hap tregu për shitjen e produkteve vendore, u shtua gjelbërimi, duke mbjellë 3.500 drurë dekorativë dhe u rikultivuan 17.244 m².

Viti 2015 ishte viti i infrastrukturës lokale, duke bërë përmirësime të dukshme infrastrukturore në qytet dhe fshatra. U projektuan mbi 100 rrugë lokale dhe rurale, u ndriçuan 94 km rrugë, u ndërtuan 175.43 km rrugë, u investua në përmirësimin dhe ndërtimin e kanalizimit, duke rregulluar 131.42 km kanalizim fekal dhe 17.23 km kanalizim atmosferik. Rregulluam dhe zgjeruam hapësirat publike dhe rigjeneruam mbi 10 rrugë në zonën “Qendër”, duke bërë uniformimin e shkallëve, rimodelimin e panove-reklamave dhe, më e rëndësishmja, zgjerimin dhe modernizimin e trotuareve.

Në këto dy raporte mund të shihet se edhe në vitin e dytë të qeverisjes kemi mbajtur ritmin e lartë dhe dinamikën e punës, duke instaluar rregullin dhe ligjin në Komunën e Prishtinës dhe duke realizuar projekte të shumta që kanë përmirësuar dukshëm jetën e qytetarëve të Prishtinës.

AKTIVITETET E ZYRAVE

1. Zyra e ligjore

Zyra ligjore gjatë vitit 2015, ka vazhduar me kryerjen e detyrave dhe punëve në pajtim me aktin për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës për shërbyesit civilë.

Punët e kryera nga Zyra ligjore në vitin 2015, ndër të tjera përfshijnë:

- Hartimin e planit të veprimit dhe raportimin për punën e Zyrës;
- Bashkëpunimin me drejtoritë e administratës, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjet publike lokale;
- Pjesëmarrjen në takimet e Këshillit të Drejtorëve, të Komitetit për Politikë dhe Financa, komiteteve jo obliguese dhe në mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
- Pjesëmarrjen në hartimin e akteve të cilat i miraton Kuvendi i Komunës dhe punimin e akteve në kompetencë të Kryetarit të Komunës;
- Përpilimin e kontratave, marrëveshjeve, vendimeve dhe urdhëresave;
- Ofrimin e ndihmës juridike, këshillave dhe ekspertizës për drejtori, zyra, sektorë, institucione të arsimit, të shëndetësisë dhe ndërmarrje publike lokale;
- Shqyrtimin e projektregulloreve që propozuesit i kanë dërguar për diskutim Këshillit të Drejtorëve, komiteteve përkatëse dhe për miratim Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, Statutin e Komunës;
- Përgatitjen e vendimeve dhe urdhëresave administrative të lëshuara nga Kryetari i Komunës;
- Pjesëmarrjen aktive në Kolegjiunin e zyrtarëve ligjorë, të themeluar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrjen në takime pune, trajnime lidhur me aktivitetin e zyrave ligjore dhe dispozitave që kanë të bëjnë me qeverisje lokale në përgjithësi;
- Bashkëpunimin me Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, komunat tjera të Kosovës, OJQ – të, komunitetin e biznesit, organet e administratës, institucionet e arsimit, të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike lokale;
- Kryerjen edhe të punëve të tjera që janë të përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës së Prishtinës dhe akte të tjera;
- Njoftimin e vazhdueshëm të Kryetarit të Komunës për detyrat dhe punët që i zhvillon Zyra ligjore.

Departamenti i Prokurimit

Departamenti i Prokurimit gjatë muajit janar - dhjetor të vitit 2015, ka realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore dhe punë të tjera.

Aktivitetet e implementuara:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit të prokurimeve;
- Shqyrtimi i të gjitha shkresave të drejtuar në Departamentin e Prokurimit nga njësitë kërkuese të Komunës;

- Përgatitja e njoftimeve indikative;
- Përgatitja dhe përpunimi i dosjeve të tenderëve;
- Përgatitja e dosjeve të kuotimit;
- Përgatitja e njoftimeve për kontrata;
- Përgatitja e njoftimeve për anulim të kontratave;
- Përgatitja e anulimeve për dhënie të kontratave;
- Përgatitja e formularëve të tjerë të paraparë sipas udhëzuesit për prokurim dhe Ligjit të prokurimit;
- Hapja e ofertave;
- Vlerësimi i ofertave;
- Përgatitja e vendimeve për komisionin e hapjes së ofertave;
- Përgatitja e vendimeve për komisionin e vlerësimit të ofertave;
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të drejtuara në Departamentin e Prokurimit nga ana e operatorëve ekonomikë;
- Përpilimi dhe përgatitja e kontratave (të punëve, shërbimeve dhe furnizimeve) dhe vendimeve për menaxherët e projektit;
- Të gjitha punimet brenda objekteve shkollore janë realizuar sipas dinamikës dhe planifikimeve të parapara. Pra, procesi edukativo-arsimor në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës është duke u zhvilluar me një dinamikë, sipas kalendarit të vitit shkollor.

Gjatë vitit 2015, nga dt. 01.01.2015 deri më 31.12.2015, janë udhëhequr gjithsej: 288 procedura në vlera të mëdha, të mesme dhe të vogla, ndërsa në vlera minimale janë udhëhequr gjithsej 82 procedura:

- Projekte për punë, janë publikuar gjithsej:	142
- -//- mallra, -//- -//- :	83
- -//- shërbime, -//- -//- :	60
- -//- konkurs projektimi :	3
- -//- në vlera minimale:	82

Të kontraktuara janë gjithsej:	244
Në procedurë janë:	26
Të anuluar janë:	18

Vlera e punëve të kontraktuara:	21,803,207. ⁶⁸ €
Vlera e mallrave të kontraktuara:	3,312,685. ⁰³ €
Vlera e shërbimeve të kontraktuara:	2,975,358. ⁹⁴ €
Vlera për konkurs për projekte:	4,900. ⁰⁰ €
Vlera e projekteve në vlerë minimale:	58,664. ⁹⁶ €
Vlera e projekteve të kontraktuara deri më 31.12.2015, gjithsej:	24,842,131. ⁵⁸ €

Aktivitetet në implementim e sipër

Aktivitetet të cilat janë në përfundim e sipër, por të cilat presin zotimin e mjeteve për nënshkrim të kontratës, janë:

Shërbime këshilluese për PPP, investime të huaja dhe donacione - ritender
Ndërtimi i rrugës në Lagjen e Dulevitëve
Riparimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve
Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kan. fekal në rrugën mbi lumin Prishtina
Rikonstruktimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik, viti 2015, faza II
Ndërtimi i inf. në rrugën "Sali Matoshi" dhe ndërtimi i rrugëve në Grashticë
Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor
Furnizimi me material shpenzues dhe pajisje për zyrë
Ndërtimi i dy këndeve të lodrave
Urat - Unaza qendrore, pjesa perëndimore, Prishtinë
Rrënimi, largimi i objekteve, pajisjeve, transportimi i tyre në vendin adekuat dhe intervenimet emergjente
Furnizimi me material ndërtimor për Bulevardin mbi Kurriz
Furnizimi dhe vendosja e ashensorit të jashtëm në objektin e vjetër të Komunës
Ndërtimi i krahëve të rrugëve: "Vëllezërit Fazliu", "Rugova" dhe "Vlora"
Furnizimi me kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta 240 litra
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Dabishec, Lagjja e Dulajve
Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve në viset rurale, pjesa IV, VII, IX
Riparimi dhe renovimi i objekteve të Brigadës profesionale të zjarrfikëseve
Punimi, furnizimi dhe vendosja e shenjave të adresave në komunën e Prishtinës
Renovime në disa qendra dhe ambulanca mjekësore në Prishtinë
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Slivovë
Furnizimi me pajisje sportive për klube, shkolla dhe institucione sportive, lot I dhe IV
Ndërtimi i këndeve të lojërave në lagjet "Kalabria" dhe "Kodra e Trimave"
Mirëmbajtja e objektit të Komunës
Stabilizimi i terrenit në rrugën "Mithat Frashëri"
Furnizimi dhe montimi i dyerve të drurit të dhomave të mësimi
Servisimi, pastrimi i filtrave dhe mirëmbajtja e kondicionerëve në objektin e ri të Komunës

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Gjatë vitit 2015, nga dt. 01.01.2015 deri më 31.12.2015, janë udhëhequr gjithsej: 288 procedura në vlera të mëdha, të mesme dhe të vogla, ndërsa në vlera minimale janë udhëhequr gjithsej 82 procedura:

- Projekte për punë, janë publikuar gjithsej:	142
- -//- mallra -//- -//- :	83
- -//- shërbime -//- -//- :	60
- -//- konkurs projektimi :	3
- -//- në vlera minimale:	82

Të kontraktuara, gjithsej:	244
Në procedurë:	26
Të anuluar:	18

Vlera e punëve të kontraktuara:	21,803,207. ⁶⁸ €
Vlera e mallrave të kontraktuara:	3,312,685. ⁰³ €
Vlera e shërbimeve të kontraktuara:	2,975,358. ⁹⁴ €
Vlera për konkurs për projekte:	4,900. ⁰⁰ €
Vlera e projekteve në vlerë minimale:	58,664. ⁹⁶ €
Vlera e projekteve të kontraktuara deri më 31.12.2015, Gjithsej:	24,842,131. ⁵⁸ €

2. Sektori i burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2015, Sektori i burimeve njerëzore, në kuadër të fushëveprimtarisë dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Prishtinës, është angazhuar në disa drejtime, si në:

- Plotësimin e nevojave të administratës komunale për më shumë punonjës;
- Vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të punonjësve me Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP);
- Hartimin e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të Burimeve njerëzore;
- Ofrimin e mbështetjes administrative (sekretari) për Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave dhe Komisionin disiplinor;
- Raporte, analiza, statistika dhe shkresa me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe të Institucioneve Qendrore;
- Rregullimin dhe digjitalizimin e dosjeve të punëtorëve dhe futjen në Sistemin informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ);
- Procesin e riorganizimit të administratës komunale dhe sistematizimin e pozitave të nëpunësve (Vendimi mbi organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, nga e cila del Organogrami i ri).

Ngritja e kapaciteteve të stafit është një nga prioritetet e përhershme të Burimeve njerëzore. Në Kosovë, Ligji obligon që për trajnimet që ofron Ministria e Administratës Publike përmes IKAP-it, institucionet t'i dërgojnë nëpunësit e tyre në këto trajnime. Varësisht prej temave dhe numrit të lejuar, Komuna e Prishtinës rregullisht dërgon stafin e saj në trajnimet e IKAP-it, ndërsa për shkak të buxhetit të kufizuar, vetëm në një rast ("Menaxhimi i Kantierit të Ndërtimit", me një shumë modeste) ka arritur të dërgojë staf (6 inspektorë) në tema që nuk janë përfshirë në trajnimet e IKAP-it.

Sipas Vendimit dhe Organogramit, por edhe kornizës ligjore në fuqi, Burimet njerëzore janë pjesë e Kabinetit të Kryetarit dhe janë të obliguar t'i përgjigjen dhe raportojnë **Kryetarit**. Në përputhje me këtë obligim, në mënyrë periodike dhe sipas kërkesës i përgjigjen dhe i raportojnë Kryetarit të Komunës.

Përveç raportimit dhe komunikimit të brendshëm, për shkak të natyrës së punës, obligimeve ligjore dhe procedurave, Burimet njerëzore hartojnë raporte dhe shkresa në mënyrë periodike dhe sipas kërkesës edhe për institucionet e **nivelet qendror**. Numri më i madh i këtyre akteve ka të bëjë me Ministrinë e Administratës Publike, përkatësisht Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil, por një numër i tyre i dedikohen edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Financave.

Digjitalizimi i dosjeve të punëtorëve – dosjet e punëtorëve janë dokumente të ndjeshme, për të cilat është i obliguar të kujdeset Sektori i burimeve njerëzore. Pas një vlerësimi paraprak, është konstatuar se është e nevojshme rregullimi i tyre sipas kornizës ligjore në fuqi. Ky proces tashmë ka përfunduar, por me kërkesë të DASHC.MAP, janë digjitalizuar të gjitha dosjet e personelit dhe ka filluar futja në SIMBNJ. Ky proces është vlerësuar të përfundojë jo më vonë se muaji maj 2016.

Riorganizimi i administratës komunale - në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore, në vitin 2015, Kryetari i Komunës ka filluar procesin e riorganizimit të administratës komunale. Me kërkesë të Kryetarit, në këtë proces është përfshirë edhe Sektori i burimeve njerëzore dhe ka dhënë kontributin e tij në të gjitha fazat. Si rezultat, Kryetari i Komunës ka nxjerrë **Vendimin dhe Organogramin e ri**, me të cilën është përcaktuar skema e re organizative. Me këtë skemë qartësohet struktura organizative dhe përgjegjësitë e stafit, e cila është vlerësuar se rrit efikasitetin dhe profesionalizmin e administratës dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve. Po ashtu është vlerësuar se skema e re vendos parakushtet për mbrojtjen dhe trajtimin me dinjitet të nëpunësve të Komunës së Prishtinës.

Pasqyra tabelare e punonjësve të drejtorive me numrin e përgjithshëm, kualifikimet, strukturën etnike dhe gjinore 01.01.2015 – 31.12.2015.

Nr.	Drejtoritë	Nr.	Kualifikimet				Struktura etnike				Struk. gjinore	
			Fak.	Shk e lartë	Shk. e mes me	Stafi mbësht.	Shqiptar	Serb	Turq	Të tjerë	M	F
1.	Kabineti i Kryetarit	45	33	1	11		44	1			20	25
2.	Drejtoria e Administratës	103	18	3	78	4	100	1		2	79	24
3.	Drejtoria e Arsimit	21	18	1	2		19		1	1	9	12

4.	Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit	28	16		10	2	27		1		20	8
5.	Drejtoria e Financave dhe Pronës	68	27	3	37	1	68				33	35
6.	Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	28	20		8		27			1	17	11
7.	Drejtoria e Kadastrit	33	11	1	21		33				15	17
8.	Drejtoria e Inspeksionit	61	45		16		61				42	19
9.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	10	7		2	1	10				2	8
10.	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	31	13	5	13		31				24	7
11.	Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	48	42	1	5		47		1		19	29
12.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	7	7				7					7
13.	Muzeu dhe Instituti komunal	3			3		3				2	1
14.	Arkivi i Qytetit	12	5		7		12				4	8
15.	Biblioteka "Hivzi Sylejmani"	34	7	3	22	2	34				13	21
16.	Qendra Kulturore për Fëmijë	7	4		3		7				3	4
17.	Teatri "Dodona" Prishtinë	18	2		15	1	18				15	3
	Gjithsej	557	275	18	253	11	548	2	3	4	318	239

3. Zyra për integrimi evropiane

Duke u bazuar në fushëveprimtarinë e punës së Zyrës komunale për integrimi evropiane, është raportuar në baza tremujore, sipas kërkesës së MAPL-së, për veprimet që dalin nga Plani i veprimit për ndërmjetësimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për komuna. Gjatë vitit

2015 janë mbajture takimet e rregullta të Kolegjiut të ZKIE-së në kuadër të AKK-së, si dhe takimet e rregullta me MAPL-në, takime këto të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së Zyrës për integritime evropiane.

Aktivitetet e planifikuara

Zyra për integritime evropiane parasheh që gjatë vitit 2016 të përmbushën detyrat që dalin nga Plani kombëtarë për zbatimin e MSA-së, së bashku me drejtoritë relevante dhe zyrat e tjera.

Aktivitetet e implementuara

- Duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës si ZKIE, gjatë vitit 2015 është raportuar sipas rregullit në MAPL për periudhat 3-mujore për veprimet e Komunës karshi PVMSA-së;
- Janë mbajtur 4 takime (më 09.06.2015, 04.12.2015, 10.12.2015, si dhe 17.12.2015) të Grupit punues për hartimin e PLVM me REC-në rreth finalizimit të planit;
- Po ashtu, në kuadër të Komisionit për riintegrim, janë mbajtur takime të rregullta dhe është hartuar Plani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Gjatë vitit 2015 janë realizuar këto aktivitete sa i përket koordinimit të skemave me donatorë:

- Janar – dhjetor 2015, është mbajtur punëtorja e organizuar nga AZHR Qendër – ARDA (e ndarë në tri ditë, periudha të ndryshme), me qëllim të përgatitjes së komunave të REQ-së, apo përgatitjen e projekt – fiseve për prezantim para donatorëve në Konferencën e Donatorëve. Trajnimet janë mbajtur më: **13.01.2015, 28.01.2015 dhe 03.03.2015;**
- Më **14.04.2015**, është mbajtur konferenca me donatorë;
- Më **25.05.2015**, është mbajtur sesioni informues rreth fondit nga projekti DEED i përkrahur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës, përmes UNDP-së dhe IOM-së, përkrahje bizneseve të reja, ose edhe atyre ekzistuese, të cilat marrin remitenca, pastaj ka vijuar me trajnimin treditore për bizneset apo familjet e interesuara, ku ka pasur pjesëmarrje të mjaftueshme nga Komuna e Prishtinës;
- Më **03.07.2015**, trajnim me AZHR-në “Lansimi i fondeve të BE-së”;

Trajnimet dhe seminarët

- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur dy trajnime dyditore, të organizuara nga IKAP-ja:
 - Trajnimi i parë është mbajtur më 14 dhe 15 prill, me temën “**Bashkimi Evropian dhe Procesi i Integritit**” ;
 - Trajnimi i dytë është mbajtur më 20 dhe 21 maj, me temën “**Bashkëpunimi ndërkuftar**”;
- Punëtorja dyditore, me temën “**Sfidat dhe të arriturat e komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agenda evropiane**”, më 29 dhe 30 prill 2015, organizuar nga MAPL-ja, në bashkëpunim dhe përkrahje nga GIZ-i;
- Nga **22 – 24** korrik, pjesëmarrja në Seminarin treditore në Zagreb të Kroacisë, projekti LAADER – DEAR (Development Educations Awarines Raising);

- Më 29.10.2015, takim AKK dhe GIZ, prezantimi i përvojave të komunave përfituese nga skema BEACON;
- Më 25 dhe 26.11.2015, pjesëmarrje në Konferencën “MSA – Çfarë mund të përfitojë Kosova nga përvoja e Kroacisë”, organizuar nga MIE-ja, në bashkëpunim me UNDP-në;
- Nga 30.11.2015 deri më 03.12.2015, trajnimi i organizuar nga MAPL-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, tema e trajnimit “Përvoja kroate pas nënshkrimit të MSA-së”;

4. Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (NJDNJBGJ), është mekanizëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, standardet ndërkombëtare, politikat, strategjitë dhe planet e veprimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ecuria e punës së NJDNJBGJ-së është: trajtimi i barabartë gjinor sipas Ligjit për barazi gjinore, mundësi të barabarta sipas Ligjit kundër diskriminimit, masat afirmative mbi barazinë e mundësive për personat me nevoja të veçanta, kundër dhunës në familje, mbrojtjes së të dhënave personale sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

NJDNJBGJ-ja në mungesë të kodit buxhetor, ka realizuar aktivitetet e planifikuara, duke shfrytëzuar bashkëpunimin e drejtorive përkatëse, si dhe organizatave lokale dhe ndërkombëtare.

Aktivitetet e implementuara:

- Realizimi i projektit sensibilizues kundër dhunës, ku edhe kemi vendosur posterë me moton “*Burrat e vërtetë kurrë nuk ushtrojnë dhunë ndaj gruas!*”, në bashkëpunim me OSBE-në;
- Realizimi i projektit “Teatri mobil”, ku parashihet që në formë të monologut të paraqiten dhuna në baza gjinore, pozita e femrës në trashëgim, shkollimi i femrës, ku më pas të zhvillohet debati;
- Ndarja e mirënjohjeve për 12 mësues/e veteranë të arsimit mbi moshën 80 vjeç, në bashkëpunim me Grupin e grave asambliste dhe Drejtorinë e Arsimit, si dhe me përkrashjen e Kabinetit të Kryetarit të Komunës, me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit;
- Organizimi i punëtorisë nën kornizën e aktiviteteve të OSBE-së kundër dhunës në familje. Ky aktivitet ka për qëllim formimin e grupit si mekanizëm koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në komunën e Prishtinës, ku koordinatore e grupit është zgjedhur udhëheqësja e kësaj zyre. Grupi vazhdon të punojë sipas mandatit të caktuar;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe “Save the Children”, për themelimin e asambleve komunale të fëmijëve, në bashkëpunim me Njësinë për të drejtat e njeriut – të drejtat e fëmijëve dhe Drejtorinë e Arsimit;
- Vizitat në shkolla për të parë gjendjen ekzistuese për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Organizimi Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë, në bashkëpunim me Grupin e grave të Komunës së Prishtinës, me rastin e 12 Majit, ku për dy vite radhazi u organizua fushata me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”. Më 12.05.2015, janë ndarë mirënjohje për

kontributin jetësor për 14 infermiere të QMF-së të Komunës së Prishtinës të moshave mbi 70 vjeç;

- Në bashkëpunim me KFOR-in italian dhe në mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit, është mbajtur projekti me temën “ Ngacimet seksuale”, në shkollën “Xhevdet Doda”, me klasat e 11-ta, ku gjatë këtij aktiviteti është shfaqur një film dokumentar dhe më pas është hapur debat në këtë temë;
- Në bashkëpunim me Agjencinë për barazi gjinore, është organizuar debati në vazhdimësi për shqyrtimin dhe finalizimin e projekt-udhëzimit administrativ “Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve”, me mbështetjen e USAID dhe GIZ për shqyrtimin, dhënien e komenteve, sugjerimeve dhe rekomandimeve nga ana e pjesëmarrësve nga Komuna e Prishtinës, me qëllim të plotësimit dhe finalizimit të draftit për procedim të mëtejshëm;
- Organizimi i fushatës “Muaji ndërkombëtar i luftës kundër kancerit të gjirit”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Grupit të grave. Gjatë kësaj fushate janë ftuara femrat që janë të regjistruara në qendrat për shërbime sociale, që të bëjnë falas kontrollin e mamografisë, si dhe është shpërndarë fletëpalosja me udhëzime “Si të bëjmë zbulimin e hershëm të kësaj sëmundje”, e cila është e shërueshme nëse zbulohet me kohë;
- Organizimi i aktiviteteve gjatë fushatës ndërkombëtare “*Tetori – muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara*”, me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 03/L-019 dhe Udhëzimit administrativ nr. 03/2010. Gjatë kësaj fushate janë ftuara 10 persona me aftësi të kufizuara (PAK), që të jenë pjesë e stafit Komunal për dy ditë radhazi.
- Organizimi i aktiviteteve për hir të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, në bashkëpunim me organizatën “UN Women”, zyra në Prishtinë. Me qëllim të shënimit të kësaj date dhe 16 ditëve të aktivizimit, u organizua ekspozita e fotografive “Heronjtë dhe heroinat e përditshme të barazisë gjinore”, ku edhe u shpërndanë fletëpalosje, ndërsa nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 2 viktimat të dhunës në familje janë ndihmuara me pagesën e vendbanimit, ku do të qëndrojnë për 1 vit kalendarik.

Trajnimet dhe seminarët

Konferenca rajonale “*Sfidat dhe të arriturat e gruas shqiptare në rajon*”, organizuar nga Komuna e Gjakovës, e përkrahur nga zyra UNWOMEN në Kosovë dhe me mbështetjen nga donatorët, Konferenca “*A jam e barabartë në shoqërinë kosovare*”, organizuar nga Rrjeti i Radiove Lokale (INC), në bashkëpunim me Qendrën për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD), Konferenca “*Çështjet gjinore, pronësore dhe mundësitë ekonomike në Kosovë*”, organizuar nga programi i USAID-it për të drejtat pronësore.

Konferenca “*Baballarët dhe prindërimi për barazi gjinore në Ballkan: Praktika, Politikë Kërkime*” Kjo konferencë është organizuar nga “Care Internacional” në Ballkan, në bashkëpunim me organizatat lokale joqeveritare dhe me mbështetjen e “Care” në Norvegji, Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), “OAK Foundation”.

Punëtori e organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me “Italian Cooperation” - Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë. Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte bashkëpunimi i të gjitha komunave të Republikës së Kosovës në përmirësimin dhe përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mbarë vendin.

Trajnimi “Përkatësia gjinore dhe të drejtat në pronë në Kosovë”, i organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ky trajnim kishte qëllim kryesor rritjen e njohurive të zyrtarëve komunalë, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të grupeve të grave, për barazinë gjinore dhe përmirësimin e qasjes së grave në të drejtat në pronë dhe banim në Kosovë.

Punëtorja me temën “Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor”, i organizuar nga “HELVETAS Swiss Intercooperation”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte planifikimi dhe buxhetimi më i mirë për gra dhe burra.

Trajnimi “Metodologjia për hartimin e Planit lokal për veprim në mjedis” (PLVM), i bashkë financuar nga GIZ dhe Komuna e Prishtinës.

Punëtorja për “Të drejtat sociale për grupet e marginalizuara”, organizuara nga organizata GIZ.

5. Zyra për mbrojtjen e të dhënave personale

Aktivitetet e implementuara

Në Ditën Ndërkombëtare të Privatësisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka organizuar konferencën “Privatësia në epokën digjitale”, ku janë ftuara edhe 6 nxënës të klasave të 12-ta të komunës së Prishtinës, të cilët janë marrë me aktivitete gjatë fushatës ndërgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale pas trajnimit të mbajtur më 10.12.2014.

Trajnimi i organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me temë “Masat e sigurisë / siguria dhe mbrojtja e të dhënave personale”, Mbështetje për institucionet e Kosovës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale", Projekt I BE-së që synojmë të zgjerojmë njohuritë e ZMDH-ve mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si fushë më e re në Kosovë.

6. Njësia e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm ka zhvilluar aktivitete të suksesshme në fusha të ndryshme, por ka pasur edhe ngecje në përmbushjen e planit të Njesisë së auditimit.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2015, Njësia e auditimit të brendshëm ka finalizuar raportin e auditimit për pesë aktivitete të auditimit, të cilat janë paraparë sipas planit të punës të Njesisë së auditimit të brendshëm.

Aktivitetet të cilat kanë përfunduar gjatë periudhës janar-nëntor 2015, janë:

- Sistemi i pagave;
- Rekrutimi i personelit në administratën komunale;

- Tatimi në pronë;
- Të hyrat nga lejet e ndërtimi për vitin 2015;
- Të hyrave nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Nga këto auditime janë dhënë 45 rekomandime, të cilat pritet të zbatohen në periudhën e ardhshme.

Njësia e auditimit ka në proces dy auditime, të cilat janë në fushën e auditimit të të hyrave nga Drejtoria e Shëndetësisë, e cila është në fazën e raportimit, si dhe auditimit të prokurimit për vitin 2015, i cili është në fazën e punës në terren. Gjatë muajit tetor 2015, Njësia ka përgatitur Projektplanin strategjik 2016-2018 dhe Projektplanin vjetor 2016, të cilat u janë dërguar anëtareve të Komitetit të auditimit për shqyrtim dhe miratim.

Gjatë vitit 2015, NJAB i ka përmbushur obligimet për raportim në NJQH –AB (Ministria e Financave) për tri periudha tremujore të vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë në disa trajnime, si:

- “Sigurimi i cilësisë së AB-së”,
- “Prokurimi publik”,
- “Menaxhimi i SIMFK-së” dhe
- “Planifikimi i auditimit”.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Planifikimi i projekteve dhe puna e Drejtorisë së Administratës është e bazuar në raportin “Vlerësimi organizativ dhe rekomandimet për përmirësim në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Prishtinës”.

Nga ky raport, tri detyrat më të rëndësishme që janë parashtruar para Drejtorisë së Administratës që në fillim të mandatit qeverisës, ishin:

- Sfidat e Drejtorisë dhe adresimi i atyre sfidave në mënyrë direkte;
- Zhvillimi i pozitës së balancuar administrative, e cila do të ishte e qëndrueshme për një afat më të gjatë;
- Ngritja e nivelit të efijencës, në mënyrë që qytetarët të marrin vlerën më të madhe të mundshme për taksat që ata paguajnë.

Raporti i ka adresuar këto çështje dhe ka ofruar propozimet për përmirësim – gjithsej 97 rekomandime, me qëllim që qytetarëve të komunës së Prishtinës t’u ofrohen shërbimet cilësore administrative, shërbime të shpejta dhe financiarisht të përballueshme, mbi të gjitha, shërbime administrative komunale që ata i dëshirojnë dhe i meritojnë.

Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së punonjësve, koordinimi i punëve të sektorëve dhe drejtorive, kujdesi ndaj shpenzimit të parasë publike, ngritja në nivel të lartë të komunikimit elektronik, ngritja e nivelit të disiplinës, eliminimi i korrupsionit, maksimizimi i nivelit të transparencës, hapja e dyerve për të gjithë qytetarët, respekti dhe qasja e drejtë ndaj qytetarit, shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve me kohë të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, dëgjimi i halleve dhe problemeve të qytetarëve dhe tentimi për t’i ndihmuar ose së paku këshilluar, kanë ndikuar dukshëm në ngritjen e performancës së Komunës gjatë vitit 2015.

Analiza e kujdesshme e proceseve të punës, definimi i atyre proceseve dhe optimizimi i hapave të proceseve, ka sjellë edhe deri te avancimi, ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Kur këto procese të punëve të definuara mirë të kombinohen me të arriturat e fundit të teknologjisë informative, është e pamundur që të mos ketë rezultate pozitive, qoftë edhe ato rezultate minimale, të pëlqyera ose jo, të komplimentuara ose të kritikuar, por qytetari është ai i cili e jep notën më meritore dhe më të drejtë.

Në vizionin e vet, Drejtoria e Administratës vazhdimisht tenton që të arrijë efekte maksimale, me investime minimale dhe me resurse të njëjta. Deri më tani kjo është arritur. Ngritjet e cilësisë në ofrimin e shërbimeve është pranuar shumë pozitivisht nga qytetarët, vendosja e rregullit në pritje, sigurimi i qytetarit se patjetër do ta marrë shërbimin e kërkuar, mirësjellja ndaj qytetarit, shërbimi i shpejtë dhe cilësor, luftimi i korrupsionit, eliminimi i rreshtave të gjatë dhe pritjes, tentim vjedhje në rreshta e deri te eliminimi i ngacmimit seksual në radhët e gjata.

Vendosja e receptionit dhe përmirësimi i informacionit për orientimin e qytetarit në hapësirat e Komunës, përmirësimi në dispozicionim të informacionit në lidhje me shërbimet e ofruara për qytetarë, publikimi i broshurave për dokumentet që nevojiten për marrjen e dokumenteve të drejtorive të ndryshme, publikimi i broshurave dhe i treguesve grafikë se ku duhet të orientohen qytetarët – kanë ndikuar shumë në shkurtimin e kohës që qytetari sot e kalon në Komunë.

Është ngritur në nivel të lartë përditësimi i web-faqeve të Komunës, respektimi i dygjuhësisë, hapja e kutive të ankesave të qytetarëve tanimë bëhet çdo muaj dhe çdo ankesë analizohet dhe ftohen qytetarët për shpjegime më të hollësishme (kur në ankesë e ka emrin dhe numrin e telefonit), është përfunduar përforcimi i sistemit të alarmimit në rast rreziku në 16 pika në qytet, i cili do të testohet së shpejti, është implementuar web-aplikacioni që e mundëson aplikimin online dhe shumë transparent të punësimit, pastaj aplikacioni për telefoni mobile e cila e maksimizon transparencën në shpenzimet e Komunës, e shumë avancime të tjera.

Bashkëpunimi me institucione të nivelit qendror (MAP, MAPL, ASHI, MEF), organizata ndërkombëtare (OSCE, KFOR-i italian, UNDP, HELVETAS etj.), bashkëpunimi me organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare është në nivel shumë të kënaqshëm. Posaçërisht vlen të ceket përkrahja e vazhdueshme e UNDP-së, ARC-së dhe Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat çdo herë na kanë përkrahur në zbatimin e risive në shërbim të qytetarëve.

Drejtoria e Administratës ka qenë shumë e përkushtuar edhe në plotësimin e kërkesave të arsyeshme të punonjësve:

- 182 punonjës furnizohen me nga 1 litër qumësht çdo ditë pune, sipas Rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në shërbimin civil komunal (110 zjarrfikës dhe 72 punonjës të administratës komunale);
- Janë pajisur me uniforma të punës 94 punonjës (uniforma verore dhe dimërore);
- 320 punonjës komunikojnë mes vete pa asnjë kompensim, falë kontratës me “VALA” (së shpejti presim realizimin e kontratës me kushte shumë më të volitshme për punonjës, ku do të përfshihen rreth 1800 punonjës);
- Bëhet përpjekje që të krijohen kushte optimale për punën e të gjitha drejtorive, sipas kërkesave të parashtruara;
- Të gjitha orët jashtë orarit janë të paguara përfundimisht në nëntor 2015;
- Janë sistemuar për punë praktike gjithsej 221 praktikantë, gjatë periudhës 2-vjeçare; 139 në vitin 2015; mbi 85 % e praktikantëve janë të diplomuar, 8 për qind me magjistraturë të kryer dhe pjesa tjetër me shkollë të mesme; 3 kërkesa për përgatitjen e disertacionit të doktoratës.

Administrata e Komunës në përgjithësi i ka të kategorizuara shërbimet në:

- shërbime themelore,
- shërbime të transferuara dhe
- shërbime të specializuara/shtesë.


Shërbime themelore, në kuadër të së cilave gjenden shërbimet administrative, paraqesin një nga shërbimet kryesore që ofrohen nga Komuna e Prishtinës, ku edhe është i angazhuar numri më i madh i burimeve njerëzore. Shërbimet e këtilla janë organizuar në konceptin “One-Stop Shop” dhe me këtë rast është thjeshtësuar procedura dhe dukshëm janë reduktuar pritjet e qytetarëve.

Drejtoria e Administratës zotohet se do të vazhdojë me proceset e reformimit modern të saj. Duhet të vazhdohet me zbatimin e standardeve ndërkombëtare në masë sa më të madhe të mundshme, të zhvillohen dhe avancohen shërbime të reja, por edhe të lehta ndaj qytetarëve.

Të gjithë punonjësit kapacitetet e veta duhet t'i kenë në dispozicion të funksionalizimit të këtyre shërbimeve, e në interes të qytetarëve dhe qytetit të Prishtinës.

Më shumë kanë vlerë projektet e përfunduara dhe veprat që i mbesin qytetarëve, sesa projektet e shkruara në letër dhe të parealizuara.

Struktura organizative e Drejtorisë së Administratës



Drejtorja e Administratës ka gjithsej 112 punonjës, të punësuar në sektorë të ndryshëm, sipas kësaj strukture:

Sektori	Nr. i punonjësve
Sektori i bashkësive lokale	23
Sektori i Kuvendit	9
Sektori i gjendjes civile	36
Sektori i punëve të përgjithshme	7
QSHQ	11
Sektori teknik	19
Sektori i IT	6
Drejtorja	1

Funksionimi i Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2016, ishte pa ndonjë veçori të shprehur negative. Sektorët me përpikëri kanë realizuar detyrat e parashtruara dhe të kërkuara prej tyre. Sfidë e veçantë ishte perioda nëntor 2014 – shkurt 2015, për shkak të fluksit të jashtëzakonshëm të kërkesave për pajisje me dokumente të gjendjes civile.

Aktiviteti i Drejtorisë së Administratës ishte i përkushtuar në 3 qëllimet kryesore:

1. Digjitalizimi i shërbimeve të qytetarëve;
2. Fuqizimi i bashkësive lokale;
3. Vazhdimi i zbatimit të administrimit efektiv.

Sipas planit të veprimit të Drejtorisë së Administratës, të miratuar për vitin 2015, gjithsej ishin të parapara 24 objektiva dhe 116 aktivitete. Objektivat dhe aktivitetet e ndara sipas qëllimeve, ishin:

1. Digjitalizimi i shërbimeve të qytetarëve - gjithsej 16 objektiva dhe 81 aktivitete;
2. Fuqizimi i bashkësive lokale - gjithsej 5 objektiva dhe 17 aktivitete;
3. Vazhdimi i zbatimit të administrimit efektiv - gjithsej 3 objektiva dhe 18 aktivitete.

Drejtoria e Administratës përveç objektivave të përshkruara më lart, ka zhvilluar edhe 12 objektiva, me gjithsej 56 aktivitete të tjera të parapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të Administratës në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Drejtoria e Administratës në vitin 2015, ka zhvilluar gjithsej 36 objektiva dhe 172 aktivitete.

Aktivitetet e implementuara të Drejtorisë

Gjithsej janë implementuar 28 projekte nga Plani i veprimit i vitit 2015, si në vazhdim:

Nr.	Projekti	Statusi	Vërejtje
1	E-Rekrutimi	Përfunduar	Fillon në v. 2016
2	Funksionalizimi i ofiqarisë virtuale (ONLINE qasja elektronike)	Përfunduar	
3	Rritja e transparencës përmes E-shpenzimeve transparente	Përfunduar	Fillon në v. 2016
4	Ofrimi i mundësive të ndryshme të shërbimeve për qytetarë - Pilotimi i projektit E-kiosk	Përfunduar	
5	Informimi i qytetarëve rreth shërbimeve dhe kërkesave të tyre përmes dërgimit të porosive grumbull - Bulk SMS	Përfunduar	Realizohet sipas nevojës, në bashkëpunim me VALA
6	Krijimi i "CALL Center" për t'u ofruar mbështetje qytetarëve rreth kërkesave të tyre	Përfunduar	
7	Krijimi i receptionit dhe të qendrës informative për qytetarë	Përfunduar	
8	Zhvillimi i web-faqes së re, me qëllim të informimit të qytetarëve rreth aktiviteteve të Komunës dhe mundësive të tyre në Komunë	Përfunduar	
9	Përmirësimi i zërimit në sallën e Kuvendit	Përfunduar	
10	Votimi digjital në sallën e Kuvendit	Përfunduar	

Nr.	Projekti	Statusi	Vërejtje
11	Krijimi i sistemit të integruar të menaxhimit të radhës dhe "one-stop shop" në objektin e ri	Përfunduar	
12	Zhvillimi dhe aplikimi i E-arkivës në Intranetin e Komunës	Përfunduar	
13	Inventarizimi i dokumentacionit të nevojshëm – web-faqe	Përfunduar	
14	Ngritja e kapacitetit përmes trajnimit të stafit të bashkësive lokale	Përfunduar	
15	Pajisja me internet	Përfunduar	
16	Ngritja dhe aftësimi i sistemit të alarmimit të qendrës së qytetit (ndërtesa e vjetër e Komunës, Radio Prishtina dhe Inspeksioni)	Përfunduar	
17	Riaftësimi i gjashtë pikave të tjera të alarmimit (1. "Dardania" - përballë çerdhes së fëmijëve; 2. "Arbëria" - te shkallët në shtyllë; 3. "Kodra e Trimave" mbi stacionin policor; 4. "Velania" - afër udhëkryqit në shtyllë; 5. Rruga "Dubrovniku" - te trafoja kryesore; 6. "Dardania" - ndërtesa e fundit afër "Viva Fresh")	Përfunduar	
18	Pajisja e punonjësve me uniformë	Përfunduar	
19	Furnizimi me qumësht	Përfunduar	
20	Vetëshërbimi digjital	Përfunduar	
21	Digjitalizimi i shërbimeve në Stacionin e Autobusëve (biletat digjitale dhe lura digjitale)	Përfunduar	
22	Sensorët për matjen e cilësisë së ajrit (6 pika)	Përfunduar	
23	LAN instalimet në QMF dhe institucionet e Komunës	Përfunduar	
24	Mirëmbajtja e pajisjeve TI, furnizim me tonerë, furnizim me serverë	Përfunduar	
25	Dizajnimi dhe vendosja e receptionit në hyrje të objektit të vjetër të Komunës	Përfunduar	
26	Definimi i procesit të punës në tatim në pronë (sistemi i menaxhimit të radhës, onestop shop, Posta e Kosovës)	Përfunduar	
27	Infographics - UNDP	Përfunduar	
28	Kalendari kulturor	Përfunduar	

Projektet që janë iniciuar dhe që pritet të implementohen gjatë vitit 2016 :

Nr.	Projekti	Statusi	Vërejtje
1	Qasja digjitale në obligimet në tatim në pronë dhe potencialisht shtypja e faturës	Iniciuar	Përfundon në mars 2016, sipas MEF
2	Menaxhimi i integruar i sistemit të prokurimit në Komunë	NA	Shtyhet për vitin 2016

Nr.	Projekti	Statusi	Vërejtje
3	Sinjalizimi vertikal dhe horizontal	NA	Mungesa e mjeteve buxhetore, shtyhet për vitin 2016
4	Renovimi i hapësirave komunale dhe vënia e tyre në shërbim të komunitetit	Pjesërisht	Është ndërprerë kontrata me OE për shkak të mos realizimit të punëve me kohë.
5	Hartimi i Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Prishtinës	Pjesërisht	Nga shtatori 2015, kjo pikë e rendit të ditës nuk po arrin të kalojë për shkak të mos mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës
6	Rritja e numrit të ofiqarëve në BL ku nuk ekziston ofiqaria	NA	Pritet miratimi i rregullores së re për ndarjen e BL-ve, pastaj sistemimi i ofiqarëve
7	Instalimi i ashensorëve për persona me nevoja të veçanta në objektin e vjetër të Komunës	Pjesërisht	
8	GËRMIA, parku - digjitalizimi i laurave	Pjesërisht	Shtyhet për vitin 2016

Sektori i bashkësive lokale

Gjatë periudhës raportuese, ky sektor ka organizuar bashkëpunimin më të mirë të Komunës dhe qytetarëve të bashkësive lokale në identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme, kryesisht nga lëmi i infrastrukturës.

Me kërkesën e Kryetarit të Komunës, janë organizuar dhe mbajtur 39 takime me banorë të bashkësive lokale të qytetit dhe fshatrave, me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të qytetarëve, si dhe caktimin e prioriteteve të ndryshme në lëmin e infrastrukturës lokale.

Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime të ndryshme administrative, ku sipas kërkesave të palëve janë lëshuar 19800 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme etj.

Është shtuar numri i shërbyesve civilë për ofrimin e shërbimeve në objektet e bashkësive lokale.

Kemi bërë shpërndarjen e të gjitha njoftimeve publike për orarin e mbajtjes së takimeve të Kryetarit të Komunës dhe strukturave të tjera udhëheqëse të Komunës në bashkësitë lokale.

Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në shkallë të dytë janë shqyrtuar dhe është vendosur për 50 ankesa.

Spektori i bashkësive lokale ka ofruar shërbime edhe për drejtoritë e tjera në kuadër të Komunës.

Spektori i punëve të Kuvendit

Spektori i punëve të Kuvendit gjatë periudhës janar-dhjetor 2015, në shërbim të Kuvendit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve të Kuvendit dhe komisioneve të ndryshme të Kuvendit, ka kryer këto punë dhe shërbime:

- Punë profesionale dhe administrative në përgatitjen e materialeve (rregulloret, vendimet etj.), për mbledhje të Kuvendit;
- Bashkëpunim me drejtoritë komunale në hartimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme;
- Konsultime dhe ndihmë në miratimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme;
- Përgatitje të rregulloreve, vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga organet e lartshënuara;
- Përcjellje të zbatimit të vendimeve dhe rregulloreve të miratuara në Kuvend;
- Përkthim, lekturim dhe shpërndarje të materialeve;
- Hartim të transkripteve dhe ekstrakteve të mbledhjeve të Kuvendit;
- Informim për aktivitetin e Kuvendit dhe të ekzekutivit nga shërbimi përkatës i këtij Spektori;
- Koordinim të punëve në mes të organeve të Komunës: Kuvendit, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve të Kuvendit dhe komisioneve të tjera etj.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur:

- 6 mbledhje të rregullta të Këshillit të Drejtorëve,
- 9 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje urgjente dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit,
- 9 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje urgjente dhe 1 mbledhje e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa,
- 12 mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitete,
- 4 mbledhje të Komitetit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim,
- 3 mbledhje të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim,
- 4 mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Sport,

- / mbledhje të Komitetit për Zhvillim Ekonomik,
- 3 mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike,
- / mbledhje të Komitetit për Pronë,
- 4 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive,
- 39 mbledhje - tubim me qytetarë,
- 9 mbledhje – debate me qytetarë për planifikimin e buxhetit,
- 50 mbledhje të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave të vendeve tjera publike të komunës së Prishtinës, (*ky numër ka të bëjë edhe me mbledhjet të cilat janë mbajtur nëpër bashkësi lokale*).

Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar:

- 3 rregullore,
- 36 vendime.

Në bashkëpunim me DEMOS-in, ka filluar ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për bashkësi lokale. Lidhur me ndryshimet dhe propozimet e reja për një Rregullore të re, janë organizuar tri takime me kryetarët e bashkësive lokale. Kryetarët e BL-ve kanë pasur obligim që të sjellin sugjerimet e veta pas takimeve me qytetarët e lagjeve. Rregullorja tashmë e ka draft-versionin e vet, dhe pritet që të formohet edhe grupi punues, i përbërë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, në mënyrë që ta marrë formën përfundimtare. Është propozuar edhe ndarja e re territoriale, e bazuar në zonat kadastrale të qytetit. Kjo nënkupton se nga 33 BL, do të propozohet formimi i 42 BL-ve. Kjo është edhe e arsyeshme, pasi që ka shumë lagje të reja të formuara që nuk i kanë të formuar këshillat e lagjeve.

Zgjedhjet për këshillat e lagjeve dhe kryetarët e BL-ve, është dashur të organizohen në nëntor të vitit 2015, mirëpo, pasi që me kryetarët e BL-ve jemi pajtuar që të presim miratimin e Rregullores së re të BL-ve, këto zgjedhje janë shtyrë deri në miratimin e kësaj rregulloreje gjatë vitit 2016.

Spektori i gjendjes civile

Fushëveprim i këtij sektori përfshinë punë dhe detyra që kanë të bëjnë me statusin civil të qytetarëve, regjistrimin e të lindurve, të kurorëzuarve, të vdekurve dhe dhënien e certifikatave që dëshmojnë gjendjen civile të qytetarëve, duke përfshirë edhe certifikatën e vendbanimit, ndërrimin e emrit personal, vërtetimin e dokumenteve në bazë të dokumenteve origjinale dhe të gjitha punët e tjera në bazë të kompetencave të deleguara nga pushteti qendror.

Gjatë vitit 2016 është vazhduar me digjitalizimin e shërbimeve të ofiaqrisë. Më 11 qershor të vitit 2015, është implementuar sistemi "E-Kiosk", sistemi i parë i tillë në Evropën Jugperëndimore, por që duket edhe më gjerë. Këndi i përgatitur për E-Kiosk, në të vërtetë është një vetëshërbim digjital. Kjo nga arsyeja se përveç E-Kioskut, aty janë të vendosura edhe njësi punuese, ku qytetari në formë elektronike mund të dërgojë shkresa, ankesa, kërkesa etj. Këto dy njësi punuese e luajnë rolin e QSHQ-së, ndërsa E-Kiosku e luan rolin e zyrtarit të gjendjes civile.

Duke pas parasysh se ky shërbim ishte risi absolute në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, pritjet e Komunës së Prishtinës nuk ishin aq të mëdha sa u treguan në realitet.

- Shërbim pa kontakt me personin zyrtar,
- Shërbim në vetëm 30 sekonda,
- Pagesë e njëjtë sikurse në sportele,
- Dokument i sigurt, i certifikuar dhe i pranuar edhe nga ambasadat e BE-së,
- Qasja e sigurt dhe e mbikëqyrur nga 4 kamera të jashtme dhe 1 kamerë e brendshme,
- Shërbim 24 orë, shtatë ditë në javë (sipas raportimeve, mujore qytetarët janë pajisur me dokumente edhe në orët e hershme të mëngjesit – 3:00, 3:46; 5:15 etj.),
- Shërbim pa korrupsion,
- Atraksion për qytetarët, e posaçërisht për bashkatdhetarët që jetojnë në botën e jashtme.

Kjo ka ngritur dukshëm shërbimin ndaj qytetarëve, sa që në shumë komente në rrjetet sociale është cekur se tashmë Komuna e Prishtinës e ka marr primatin në rajon për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Mirëpo këto janë vetëm vlerësime të qytetarëve, të cilat mund të jenë edhe subjektive dhe emocionale në momente të caktuara.

Vetëm për 6-mujorin e parë të funksionimit të këtij shërbimi, nga E-kiosku janë marr 6200 dokumente. Nga E-kiosku nga tetori, do të mund të merren 5 lloje të dokumenteve, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Zgjerimi i rrjetit të E-kisoqeve do të vazhdojë edhe në v. 2016 dhe 2017.

Interesimi i shumë mediave elektronike, vizita nga ambasadat e huaja dhe interesimi për sigurinë e informacionit dhe mundësinë e implementimit në shtetet e tyre, ftesa për prezantimin e E-Kioskut pranë Ministrisë së Administratës dhe Teknologjisë në Maqedoni, vizitat e shumta të komunave të tjera, si dhe interesimi për këtë shërbim në të gjitha konferencat ndërkombëtare ku punëtorët e Administratës kanë marr pjesë (derisa në Konferencën e organizuar në Tiranë, lidhur me fazën e dytë të programit të partneritetit për qëndrueshmërinë sociale dhe angazhimin e qytetarëve, ka ndryshuar kahja e konferencës në ditën e dytë të saj) – është kënaqësia më e madhe për punëtorët e Komunës dhe për punën e cila po kryhet në favor të qytetarëve në Komunën e Prishtinës.

Sektori i gjendjes civile ka ofruar këto informacione statistikore për vitin 2015:

Duke aplikuar qasjen tekniko-ekonomike të definimit të produktivitetit si një masë e efijencës (output/input), rezulton se produktiviteti total i punës së sektorit si rezultat në raport me numrin e të punësuarve, është:

7912	kërkesa të shqyrtuara nga një i punësuar, për vitin 2013
21.67	kërkesa të shqyrtuara përgjatë një dite pune nga një i punësuar
2.70	kërkesa të shqyrtuara për orë pune nga një i punësuar

Qendra për shërbim me qytetarë

Edhe pse Qendra për shërbim me qytetarë (QSHQ) i takon Kabinetit të Kryetarit, Drejtoria e Administratës e ka marrë përsipër përkujdesin ndaj QSHQ-së, për shkak të natyrës së punëve dhe shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Bazuar në Udhëzimin administrativ të MAPL-së, QSHQ ofron:

- komunikim korrekt me qytetarë,

- është në dispozicion të qytetarëve përmes dëgjimit, pranimit dhe trajtimit të kërkesave të qytetarëve,
- këshillime dhe ndihmë juridiko-administrative lidhur me mënyrën e plotësimit të kërkesave;
- regjistrimin e të gjitha kërkesave të palëve,
- raportimin statistikor mujor mbi statusin e lëndëve të pranuar,
- arkivimin e lëndëve dhe kujdeset për ruajtjen e tyre.

Struktura e lëndëve në fund të vitit :

	Drejtoria	Pa shqyrtuara	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Total
1	Administrata	9,800	2	78,046	13	4,311	1	192,173
2	Shëndetësia	274	-	2,086	233	-	-	2,593
3	Arsimi	3,952	-	463	6,700	-	654	11,769
4	Ekonomia	552	3	1,775	146	-	-	2,476
5	Urbanizmi	531	-	2,679	-	-	-	3,210
6	Infrastruktura	99	2	495	50	1	436	1,083
7	Shërbimet Publike	38	4	943	5	-	1,196	2,186
8	Kultura	878	-	1	-	-	-	879
9	Inspeksioni	2,564	1	1,450	-	-	-	4,015
10	Financat	2,542	57	47,270	1	38	-	50,408
11	Kadastrri	45	2	22,900	54	38	-	23,039
	TOTAL	21,275	71	258,108	7,202	4,888	2,287	293,831

Nga gjithsej 298,831 kërkesa të paraqitura të qytetarëve, vetëm 7.24% janë të pashqyrtuara, që paraqet rezultat shumë të mirë.

Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike

Fushëveprimi i këtij sektori është arkivimi i lëndëve dhe mbajtja e lëndëve pasive të organeve të administratës komunale, zyrave dhe njësive të tjera, dhënia e ndihmës juridike për qytetarët e komunës së Prishtinës, punët e byro-technikës etj.

Numri i përgjithshëm i punonjësive në këtë sektor është pesë (5) dhe struktura kualifikuese e tyre është 1 (14%) me fakultet dhe 6 (86%) me shkollë të mesme.

Dërgimi i postës

Gjatë periudhës raportuese, punonjësit e këtij shërbimi kanë shpërndarë brenda drejtorive të organeve të administratës dhe jashtë vendit gjithsej 45932 lëndë.

Shërbimi i byrotechnikës

Sipas kërkesës së organeve të Administratës, ky shërbim ka fotokopjuar gjithsej 217422 lëndë.

Asistent për punë administrative- teknike

Ka pranuar numër të palëve për takim me drejtorin e Administratës, ka njoftuar shefat e sektorëve për takim me drejtorin dhe ka kryer edhe punë të tjera.

Arkivi pasiv

Ka përgatitur lëndë për arkivim dhe asgjësim prej 20 m gjatësi. Për pjesën e materialit të asgjësuar, nga kompania kemi marrë letër të formatit A-4 në kompensim. Sipas kërkesës së Avokaturës Publike të Komunës, janë gjetur disa kopje të lëndëve që kanë të bëjnë me procedurë gjyqësore.

Sektori teknik

Sipas Vendimit për organizim dhe sistemim të Komunës së Prishtinës, fushëveprim i këtij sektori është përgjegjës për logjistikën dhe funksionimin e saj, ku përfshihet sigurimi i objekteve, menaxhimi i parkut të automjeteve, kujdesi për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare etj.

Numri i përgjithshëm i punonjëseve në këtë sektor është 19 dhe struktura kualifikuese e tyre është 1 (5%) me fakultet, 14 (74%) me shkollë të mesme dhe 4 (21%) me shkollë fillore.

Për kryerjen dhe realizimin e punëve me efikasitet dhe azhurn, Sektori teknik ka kryer disa punë për muajt janar – dhjetor, ku përfshihen: objekti i vjetër i Komunës, objekti i ri i Komunës, objekti te Policia e Kosovës - ish-AKI (Drejtoria e Inspeksionit), bashkësitë lokale, Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale dhe Qendrës për Punë Sociale.

Ky sektor ka kryer punë të përditshme në sigurimin e objekteve të Komunës, në koordinim me policinë e Kosovës dhe me kompaninë e sigurimit “Rojet e Nderit” për mbajtjen e rendit dhe qetësisë.

Ky sektor ka punuar në:

- punët në mirëmbajtjen e objekteve të Komunës, si në pastërti, në rregullimin dhe mirëmbajtjen e energjisë, të nxehjes së objektit dhe në punë të tjera,
- koordinimin e punëve me Sektorin e Kuvendit për përgatitjen e seancave të Kuvendit, për punët teknike gjatë seancave,
- koordinimi i punës me Sektorin e punëve të përgjithshme juridike, për largimin-asgjësimin e dokumentacionit të vjetër, për vendosjen – arkivimin e dokumentacionit dhe për ruajtjen e tij,
- punët në rezervuarin e ujit në objektin e ri të Komunës,
- punën dhe hidroizolimimin e tarracës në objektin e vjetër të Komunës,
- aktivizimin e detektorit në Drejtorinë e Inspeksionit,
- kërkesat për furnizimin me material hidro-elektro-sanitar dhe të mjeteve të punës,
- punët në furnizimin dhe montimin e derës nga qelqi në objektin e ri të Komunës,
- planifikimin e pushimeve vjetore të punonjësve,
- në objektin e Bashkësisë Lokale në Mëhallën e Muhaxhirëve, e cila është rinovuar, është bartur inventari në lokacionin e caktuar, si dhe intervenimet në BL-të dhe në Qendrën për Punë Sociale,
- ngjyrosjen e pjesës së regjistrimit civil (Ofiqarisë), vendosjen e inventarit dhe karrigeve të reja,
- punët në digjitalizimin e regjistrimit civil,
- servisimi dhe mirëmbajtja e centralit telefonik dhe transferin e numrave të telefonisë,
- servisimin dhe mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit,
- servisimin e kilmave në objektet e Komunës së (Air Condition),
- servisimin dhe montimin e pajisjeve për ngrohje në objektin e ri të Komunës,

- testimin dhe servisimin e sistemit të ajrosjes dhe klimatizimit në objektin e ri të Komunës,
- mirëmbajtjen e ashensorëve në objektin e ri të Komunës,
- servisimin dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve,
- aktivizimin dhe funksionimin e pusit para objektit të vjetër të Komunës,
- rritjen e azhurnitetit të punës dhe detyrave të punës dhe disiplinës në punë për të gjithë punëtorët e Sektorit teknik.

Autoparku

Sipas raportit përfundimtar nga autoparku i Komunës, shpenzimet e derivateve për 51 automjete që janë në përdorim në Komunën e Prishtinës, janë këto:

Muaji	Km të kaluara	Derivate të shpenzuara (lit)	Vlera në Euro
Janar	33,268.00	3,816.95	4,349.93
Shkurt	35,365.00	4,197.18	3,861.41
Mars	50,528.00	5,777.40	5,315.21
Prill	46,596.00	5,345.26	4,917.64
Maj	43,943.00	4,947.04	4,551.37
Qershor	49,244.00	5,989.00	5,509.81
Korrik	47,699.00	5,758.00	5,663.01
Gusht	44,747.00	5,702.00	6,033.18
Shtator	50,299.00	5,537.80	5,857.93
Tetor	53,450.00	6,036.00	6,385.77
Nëntor	47,459.00	5,472.66	5,547.64
Dhjetor	44,218.00	4,751.14	4,509.08
Gjithsej	546,816.00	63,330.43	62,501.98

Në bazë të shënimeve, në vitin 2015 automjetet kanë kaluar gjithsej 546.816 km.

Shpenzimi i derivateve i shprehur në litra është – 63.330.43 litra, në vlerë prej 62.501.98 €.

Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015 ka më shumë kilometra të kaluar për 61.643 km. Po ashtu, ka rritje të shpenzimit të derivateve për 6.611 litra, por ka zvogëlim në vlerën e shpenzuar për 6,052.64 €.

Sektor i teknologjisë informative

Ky sektor është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative për të gjitha drejtoritë e Komunës së Prishtinës. Numri i përgjithshëm i punonjëseve në këtë sektor është 6 dhe struktura kualifikuese e tyre është 3 (50%) me fakultet dhe 3 (50%) me shkollë të mesme. Kjo zyrë menaxhon edhe teleprezencën. Përmes këtij procesi MAPL monitoron të gjitha mbledhjet e Kuvendit.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore nga fusha e teknologjisë informative, gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, Zyra për teknologji informative në kuadër të Komunës së Prishtinës ka kryer këto punë:

- Shërbime softuerike dhe harduerike, ndihma për shfrytëzuesit komunalë për zgjidhjen e problemeve:
 - instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative, printerëve,
 - konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN);
- Kujdesi për siguri në teknologji informative në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Kemi bërë kopjet (backup) ruajtjen e të dhënave të rëndësishme nga bazat e të dhënave të ndryshme që kemi në Komunë;
- Krijimi i llogarive në e-mail-in zyrtar për stafin e Komunës, në bashkëpunim me MAP/Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI);
- Mirëmbajtja e Serverit e Intranetit të ri, Serverit e Intranetit të vjetër, File Serverit, dhe Serverit të Urbanizmit;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrjetit LAN dhe, sipas nevojës, kyçja e kablove në kabinete, switch-a, dhe përcaktimi i porteve;
- Mirëmbajtja e softuerit të intranetit të ri, softuerit të intranetit të vjetër dhe softuerit për dhënie të lejeve të punës;
- Mirëmbajtja e E-kioskut;
- Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të radhës;
- Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës përmes teleprezencës;
- Postimi i lajmeve të ndryshme që vijnë nga Zyra për marrëdhënie me publikun dhe mirëmbajtja e web-faqeve të Komunës.

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e kontratave:

- Furnizimi me pajisje të TI-së për qendrat për karrierë;
- Furnizimi, montimi dhe instalimi i LAN-it në objektet dhe institucionet e Komunës së Prishtinës;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të TI-së të Komunës, shkollave dhe institucioneve të tjera komunale;
- Furnizimi me serverë;
- Furnizimi me kompjuterë;
- Furnizimi me tonerë për nevojat e Komunës së Prishtinës;
- Përgatitja e kontratës “Furnizimi me aparate fotokopjuese, printerë, kompjuterë, laptopë dhe tabletë”.

Trajnimi i zyrtarëve të TI-së:

- Trajnimi i zyrtarëve të TI-së për web-faqet e Komunës;
- Trajnimi i zyrtarëve për mirëmbajtjen e Intranetit;
- Trajnimi për aplikacionin e e-Pasurisë;

- Pjesëmarrje në Kolegjiumin e TI-ve të komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrje në tryezën me temë “Decentralizimi dhe monitorimi i web-faqeve të komunave”;

DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS

Zyra e financave dhe pronës e Komunës së Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme, si dhe ofrimin sa më të saktë të të hyrave dhe shpenzimeve, informimin e qytetarëve rreth faljeve të borxheve, faturimin e tatimit në pronë për vitin 2016 etj.

Aktivitetet e implementuara të Drejtorisë janë:

- Regjistrimi i të hyrave vetjake dhe barazimet mes drejtorive;
- Regjistrimi i pasurive komunale;
- Regjistrimi i faturave të pranuar;
- Procedimi i pagesave prej zotimit-përpunimit-shpenzimit të mjeteve;
- Arkivimi dhe regjistrimi i pagesave;
- Menaxhimi dhe raportimi i buxhetit,
- Përpunimi i pasqyrave financiare për vitin 2015;
- Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015;
- Menaxhimi i alokimit të të hyrave vetjake;
- Menaxhimet e arkës;
- Menaxhimi i pagave.

Spektori i buxhetit dhe financave

Fushëveprimi i Sektorit

Spektori i buxhetit dhe financave merret me menaxhimin për grumbullimin e regjistrimin e të hyrave vetjake, barazimet dhe alokimet e të hyrave në bazë të projekteve të parapara nga të hyrat për buxhetin komunal dhe menaxhimin, ekzekutimin e buxhetit nga zotimet e mjeteve, përpunimet, shpenzimet e mjeteve e deri te arkivimi i tyre.

Fushëveprimi specifik i këtij sektori:

- Regjistrimi i të hyrave vetjake dhe barazimet mes drejtorive;
- Regjistrimi i pasurive komunale;
- Regjistrimi i faturave të pranuar;
- Procedimi i pagesave prej zotimit-përpunimit-shpenzimit të mjeteve;

- Arkivimi dhe regjistrimi i pagesave;
- Menaxhimi dhe raportimi i buxhetit;
- Përpunimi i pasqyrave financiare për vitin 2015;
- Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015;
- Menaxhimi i alokimit të të hyrave vetjake;
- Menaxhimet e arkës;
- Menaxhimi i pagave.

Shpenzimet e Komunës së Prishtinës						
01.01.2015 - 31.12.2015		616.00				
Fondet	Pagat	M & Sh	Komunalet	Subvencionet	Kapitalet	Totali
Grantet Qeveritare (10)	27,239,672	5,786,988.72	1,791,507.76	-	755,684.67	35,573,852.87
Te hyrat vetanake (21)		1,041,659.73	-	1,168,788.68	10,062,339.91	12,272,788.32
Te hyrat vetanake (22)	162,049	1,909,820.50	288,402.70	459,262.59	13,563,988.06	16,383,522.40
Donacionet	2,925	269,959.35	-	-	29,603.00	302,487.35
Totali	27,404,645	9,008,428.30	2,079,910.46	1,628,051.27	24,411,615.64	64,532,650.94
Pa donacione	27,401,720	8,738,468.95	2,079,910.46	1,628,051.27	24,382,012.64	64,230,163.59
Pagat	27,401,720.27	Buxheti 2015				
M & Sh	8,738,468.95	Gr.Qeveritar(10)	THV (21)	THV te bart(22)	Totali	
Komunalet	2,079,910.46	27,239,743.83	-	162,048.55	27,401,792.38	
Subvencionet	1,628,051.27	5,918,545.00	1,440,000.00	2,043,935.09	9,402,480.09	
Kapitalet	24,382,012.64	1,793,000.00	-	300,000.00	2,093,000.00	
Totali	64,230,163.59	-	2,210,000.00	573,357.36	2,783,357.36	
		755,742.00	23,512,609.00	14,814,648.26	39,082,999.26	
Donacionet	302,487.35	35,707,030.83	27,162,609.00	17,893,989.26	80,763,629.09	
	64,532,650.94				-	
					-	
Prishtinë, 03.02.2016						
Perpunoi: Eroll Raskova udheheqes sektori per buxhet dhe financa						
K.K. Prishtine						

PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2015				
Nr	PËRSHKRIMI	Planifikimi	Realizimi	%
1	Taksa për leje ndërtimi	9,500,000.00	6,536,565.07	68.81
2	Legalizimi i ndërtimeve pa leje	1,000,000.00	92,577.45	9.26
3	Tatimi në pronën e paluajtshme	6,300,000.00	5,623,478.46	89.26
4	Licenca në biznes	70,000.00	78,668.00	112.38
5	Taksa për shfrytëzimi i sip. publike	1,500,000.00	989,230.62	65.95
6	Infrastrukturë rrugore	40,000.00	50,545.05	126.36
7	Taksa nga kadastri dhe gjeodezia	500,000.00	457,865.34	91.57
8	Taksa për transaksion në pronë	500,000.00	581,153.00	116.23
9	Të hyra nga inspekcioni	30,000.00	9,271.00	30.90
10	Taksa për certifikim dhe dokumente zyrtare	280,000.00	263,667.71	94.17
11	Taksa për automjete motorrike	550,000.00	530,345.00	96.43
12	Taksa për shërbime arsimore	1,300,000.00	1,015,552.60	78.12
13	Taksa për shërbime shëndetësore	250,000.00	303,810.90	121.52
14	Gjobat në trafik	600,000.00	375,687.90	62.61
15	Qiraja e banesë dhe renta	150,000.00	83,304.09	55.54
16	Participime / Donacione	500,000.00	215,655.54	43.13
17	Të hyrat nga Parkingu + Hortikultura	1,000,000.00	290,978.00	29.10
18	Të hyrat tjera (Konf.Tenderi)	-	21,054.91	-
19	Shitja e Pasurisë	-	15,370.97	-
20	Gjohat të tjera	-	9,389.82	-
21	Agjensioni i pyjeve	-	6,815.54	-
22	Gjohat nga gjykatat	600,000.00	380,260.00	63.38
23	Shpërndarje	2,492,609.00	320,125.00	12.84
25	Taksa për Arkivin Komunal	-	275.30	-
	T O T A L	27,162,609.00	18,251,647.27	67.19
TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE		27,162,609.00	18,251,647.27	
GRANT		39,124,940.00		
TOTALI I BUXHETIT 2015		66,287,549.00	18,251,647.27	
PREJ 01-01-2015 DERI 31-12-2015				

Sektori për tatim në pronë

Fushëveprimi i sektorit

Sektori i tatimit në pronë merret me menaxhimin dhe grumbullimin e tatimit në pronë, me menaxhimin e transaksioneve të pronave, me regjistrimin dhe verifikimin e pronave dhe gjendjes së tyre që janë subjekt i tatimit në pronë, me mbledhjen e ngarkesës rrugore komunale për regjistrim të automjeteve dhe me vlerësimin e pronave.

Fushëveprimi specifik i këtij sektori:

- Planifikon dhe mban evidencën e të hyrave vetjake të tatimit në pronat e paluajtshme;
- Bën identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluajtshme;
- Përgatit faturimin e borxhit (tatimit) për të gjitha pronat e paluajtshme;
- Angazhohet dhe siguron shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë;
- Bën shpërndarjen e vërejtjeve për tatimpagues borxhlinj;
- Bën verifikimin dhe rianketimin e të dhënave në sistem me gjendjen ekzistuese në terren;
- Koordinimi i punës së operatorëve të futjes së të dhënave në sistem;
- Shqyrtimi i ankesave të tatimit në pronë nga bordi komunal;
- Në bashkëpunim me Zyrën ligjore, harton propozimrregulloren për tatimin në pronë të paluajtshme;

- Koordinon punën me Departamentin e tatimit në pronë të Ministrisë së Financave;
- Koordinon punën me drejtorinë kompetente për punët e ndërtimit dhe të kadastrat, në aspektin e lejeve të ndërtimit dhe të dhënave kadastrale;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të Ligjit të tatimit në pronën e paluajtshme dhe akteve nënligjore.

Në vitin 2015, sipas analizave të të hyrave në krahasim me vitin e kaluar, arkëtimi i tatimit në pronë ka zbritje në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Gjithashtu, gjatë muajit qershor Sektori për tatim në pronë ka kryer shërbime për qytetarë në mënyrën më të shpejtë të mundshme në aspektin e përgatitjes së të dhënave, sidomos të shërbimi i operatorëve, me ç'rast çdo kërkesë për shërbime komunale është trajtuar dhe, si përfundim, ata që i kanë kryer obligimet kanë marrë vërtetime të nevojshme në lidhje me shërbimet përkatëse komunale.

Të hyrat nga tatimi në pronë

	Realizimi 2015
01.01.2015 – 31.12.2015	5623478.46 €

Zyra e transaksionit

Statusi i lëndëve	Numri i lëndëve
Lëndë të miratuara, të kryera	3181
Lëndë në procedurë	57
Totali	3241

* Të pakryera, ngase palët nuk i kanë kryer obligimet.

Terreni

Aktiviteti	Numri
Regjistrime të reja	8451
Rianketime	5249
Verifikime	5639
Rianketime me ankesa	2617
Anketime për vlerësim	600
Dërgesa	1137
Totali	23693

Zyra pritëse/operatorët

Statusi i lëndëve	Numri i lëndëve
Të kryera	18213
Të pakryera*	1909
Totali	20122

* Të pakryera, ngase palët nuk i kanë kryer obligimet.

Ngarkesa rrugore komunale

Aktiviteti	Numri i automjeteve	Vlera
-------------------	----------------------------	--------------

Ngarkesa rrugore komunale	/////	530,345.0€
---------------------------	-------	------------

Sektori i vlerësimeve

Lloji	Numri
Kontrata të shitblerjeve	1700
Anketimet direkte	390
Anketime indirekte	300
Për bordin komunal të ankesave	330
Falja e borxheve	800
Kontribute të pensioneve	46
Totali	3566

Operativa (kontabiliteti)

Lloji	Numri
Regjistrimet e reja (objekte)	8451
Rianketime të objekteve	5249
Verifikime të objekteve	5639
Rianketime me ankesa	2617
Anketime për vlerësime	600
Dërgesa si vërejtje për mos pagimin e tatimit, zhbllokime, bllokime.	1137
Vendimet nga BKSHA	804
Deklarata mbi dakordimin e borxhit	2420
Kontrata për falje të borxhit (me këste)	32
Gjithsej	26949

Sektori i pronës

Fushëveprimi i Sektorit

Sektori i pronës merret me menaxhimin e pronave komunale, ku përfshihet mbajtja e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna, me zhvillimin e procedurës së shpronësimit, këmbimit të tokës në pronësi të Komunës me tokën e personave privatë të planifikuar për interes publik, si dhe me trajtimin dhe zhvillimin e procedurave administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

Fushëveprimi specifik i këtij sektori:

- Mban shënime për tërë tokën dhe objektet në pronësi të Komunës;
- Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës;
- Përgatit vendimet e shpronësimit për personat fizikë dhe juridikë;
- Trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;

- Nxjerr vendimet për lirimin e pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
- Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore – juridikë lidhur me pronën komunale;
- Zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
- Bën identifikimin dhe matjet gjeodezike në bazë të kërkesës së drejtorive për realizimin e projekteve komunale;
- Përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore - juridike;
- Përgatit iniciimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
- Harton materialin e nevojshëm për Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvendin e Komunës;
- Përcjell vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikim në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Thërret dhe njofton palët e interesit për nxjerrjen e vendimit të shpronësimit;
- Bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe me Drejtorinë e Kadastrit, për të dhënat gjeodezike dhe ato pronësore;
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjatë muajit janar 2016, në Sektorin e pronës janë parashtruar gjithsej 28 kërkesa. Nga këto kërkesa të kryera janë gjithsejtë 13. Ndërsa nga viti paraprak ky sektor ka kryer gjithsejtë 40 kërkesa, si dhe 12 janë kryer sipas detyrës zyrtare. Këto kërkesa kanë të bëjnë me lëndët nga lëmi i uzurpimeve arbitrare, kërkesa për shpronësimin e pronave për interes publik, kërkesa për këmbim etj.

Lëndët nga 01.01.2015 deri më 31.12.2015:

Statusi i lëndëve	Numri i lëndëve
Të pranuar sipas kërkesës	947
Të kryera nga lëndët e pranuar	718
Të kryera nga muajt paraprak	132
Të iniciuara sipas detyrës zyrtare	184
Të kryera gjithsej	1034
Në procedurë	336

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria komunale e Arsimit gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2015, ka realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore, por edhe punë të tjera.

Aktivitetet e implementuara të Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Vizita speciale në të gjitha institucionet parashkollore, vizitat kishin karakter kontrollues: kontrollimin e gjithë dokumentacionit të stafit edukativ-arsimor, administrativ për përgatitjet e tyre profesionale, si dhe inspektimin e përgjithshëm në të gjitha dosjet e fëmijëve të pranuar në çerdhe përkatëse, se a janë respektuar vendimet-kriteret e Drejtorisë së Arsimit për pranimin e fëmijëve dhe a ka pasur regjistrime të fëmijëve pa konkurs, mbas konkursit të qershorit të vitit 2014;
- Drejtoria e Arsimit me përkrahje dhe mbështetje të BIT-Austria, ka filluar zbatimin e Ditarit digjital dhe Sokrates në pesë institucione edukativo-arsimore: SHFMU "Hilmi Rakovica", SHFMU "Xhemail Mustafa", SHFMU "Dardania", SHML "Xhevdet Doda" dhe "Gjin Gazulli";
- Analizë dhe statistikë e suksesit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2014/15;
- Organizimi dhe mbajtja e Olimpiadës matematike;
- Drejtoria e Arsimit, për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, ka hapur konkurs për 68 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, në konkursin e shpallur më 05.01.2015, dhe në kohë të planifikuar, gjatë muajit shkurt janë realizuar të gjitha intervistat për këto pozita. Kështu që mësimdhënësit e përzgjedhur sipas kualifikimeve dhe performancës së treguar gjatë intervistimit, kanë lidhur kontratë pune, përveç pozitës me kodin 58 dhe 68, të cilat janë anuluar;
- Pranimi i fëmijëve në institucionet parashkollore, sipas konkursit të shpallur më 26.02.2015;
- Drejtoria e Arsimit ka realizuar ndarjen e 120 bursave për studentë të komunës së Prishtinës;
- Drejtoria e Arsimit ka formuar ekipin profesional për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta;
- Në kohë të planifikuar janë realizuar intervista dhe përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore për 18 pozita të shpallura. Komisioni pas vlerësimit të performancës së kandidatëve, ka propozuar për emërim dhjetë drejtorë të shkollave dhe pesë zëvendësdrejtorë të shkollave, kurse për tri pozita komisioni ka propozuar anulimin dhe hapjen e konkursit të ri;
- Mbikëqyrje dhe kontroll të vazhdueshëm shkollave që organizojnë mësim joformal;
- Organizimi dhe mbajtja e vlerësimit ndërkombëtar PISA;
- Organizimi dhe mbajtja e Testit të arritshmërisë;

- Organizimi dhe mbajtja e Provimit shtetëror të maturës, në afatin e qershorit dhe në muajin gusht-shtator;
- Caktimi i monitoruesve dhe administruesve për mbikëqyrjen dhe monitorimin e procesit të testit të arritshmërisë dhe të maturës;
- Është realizuar analizë dhe statistikë rezultateve të Testit të arritshmërisë dhe Provimit shtetëror të maturës;
- Analizë dhe statistikë suksesit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2014/15;
- Përgatitja e raportit të suksesit për fundvitin shkollor 2014/15 dhe analiza e vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm;
- Përgatitja e raportit për ecurinë e procesit edukativo-arsimor për tremujorin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015/16;
- Realizimi i konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë (X), për vitin shkollor 2015/16;
- Realizimi i konkursit plotësues, afati i gushtit, për regjistrimin e nxënësve në klasë X, për vitin shkollor 2015/16;
- Realizimi i konkursit për mësim joformal në: SHML “Gjin Gazulli”, “28 Nëntori”, “Hoxhë K. Prishtina”, “Abdyl Frashëri” dhe “7 Shtatori”;
- Drejtoria e Arsimit për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, ka hapur konkurs për 56 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, në konkursin e shpallur më 25.11.2015;
- Zyrtarët e lartë të arsimit kanë realizuar vizita speciale në institucionet e nivelit parauniversitar, lidhur me: respektimin e vendimit të Drejtorisë së Arsimit për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë dhe të dhjetë, respektimin e zonimit, kushtet dhe kriteret e përcaktuar për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë (X) dhe respektimin e Udhëzimit administrativ mbi numrin maksimal të nxënësve në paralele;
- Pranimi i fëmijëve në institucionet parashkollore, sipas konkursit të shpallur më 16.06.2015;
- Vizita speciale në të gjitha institucionet e nivelit parashkollor, vizitat kishin karakter kontrollues: kontrollimin e gjithë dokumentacionit të fëmijëve të pranuar në çerdhe përkatëse lidhur me respektimin e vendimeve-kritereve të Drejtorisë së Arsimit për pranimin e fëmijëve në çerdhet e caktuara;
- Realizimi i aktivitetit “Prishtina lexon”;
- Realizimi i garës për temën “Përralla më e mirë”;
- Realizimi i kampingut “Robotiks”;
- Përgatitja e databazës për mësimdhënës, drejtorë, zv. drejtorë dhe punëtorë teknikë;
- Drejtoria e Arsimit, për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, ka hapur konkurs për 91 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, në konkursin e shpallur më 09.07.2015, dhe në kohë të planifikuar, gjatë muajit gusht, janë realizuar të gjitha intervistat për këto pozita. Kështu që mësimdhënësit e përzgjedhur sipas kualifikimeve dhe performancës së treguar gjatë intervistimit, kanë lidhur kontratë pune;

- Për plotësimin e 20 vendeve të lira në pozitë për staf administrativ-teknik në institucionet arsimore, Drejtoria e Arsimit në kohë të duhur ka realizuar intervistat dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Në procesin e përzgjedhjes së stafit mësimdhënës dhe menaxhues të institucioneve edukativo-arsimore, Drejtoria e Arsimit ka përfshirë gjithnjë përfaqësuesit e Këshillit Drejtues, Këshillin e prindërve, të komunitetit dhe të shoqërisë civile;
- Për përzgjedhjen sa më profesionale dhe objektive të stafit arsimor dhe menaxhues të shkollave, janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm;
- Mësimi joformal në të tri nivelet e arsimit është duke u realizuar sipas planifikimit të paraparë;
- Sipas planifikimit të paraparë, Drejtoria e Arsimit ka funksionalizuar institucionet e nivelit parashkollor me komunitetin në bazë: në lagjen “Mati-II”, çerdhen “Botanika”, në fshatin Hajvali, çerdhen “Ngjyrat” dhe në fshatin Besi çerdhja “Shtëpia Magjike”;
- Drejtoria e Arsimit për vitin shkollor 2015/16, ka hapur dy paralele të reja për nivelin e arsimit parafillor në shkollën fillore “Meto Bajraktari”;
- Në tri institucione arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ka filluar zbatimi i projektit mësimi tërëditor, në SHFMU: “Faik Konica”, “Model” dhe “Afrim Gashi”;
- Vizita të përgjithshme, speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Përgatitja e vendimeve për mësimdhënësit e pranuar në bazë të konkurseve të realizuara;
- Mbatja e tri debateve publike për rishikimin e rregullores për IEAA;
- Plotësimi i rregullores në bazë të propozimeve pas mbajtjes së debateve publike;
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të drejtuara në DKA;
- Në bashkëpunim me stafin e shkollave, është bërë modifikimi dhe rishikimi i kontratave pa afat të caktuar për të gjithë stafin e kualifikuar në institucione arsimore të komunës së Prishtinës;
- Janë furnizuar 12 shkolla me biblioteka shkollore, me nga 100 tituj të rinj (gjithsej janë 35 000 ekzemplarë), si dhe janë në furnizim të tri shkollave në të cilat është duke u zhvilluar mësimi tërëditor me nga 1000 tituj të rinj;
- Janë furnizuar në mënyrë sistematike të gjitha institucionet arsimore me materiale didaktike, sipas nevojave të tyre;
- Janë furnizuar me materiale higjienike të gjitha institucionet arsimore, sipas nevojave të tyre;
- Janë furnizuar me inventar institucionet e nivelit parashkollor me komunitet në bazë: çerdhet: “ Botanika”, “Ngjyrat “ dhe “Shtëpia Magjike”;
- Furnizimi me dru i institucioneve arsimore;
- Përgatitja e databazës për mësimdhënës;
- Formimi i komisionit profesional për intervistimin e kandidatëve për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë në institucionet edukativo-arsimore;
- Formimi i komisioneve profesionale për intervistimin e kandidatëve për staf teknik në institucionet arsimore;

- Këshillimi profesional në aspektin ligjor për stafin menaxhues të institucione edukativo-arsimore dhe stafin e DKA-së;
- Përpilimi dhe përgatitja e kontratave dhe vendimeve për mësimdhënësit e pranuar me konkurs në institucionet edukativo-arsimore, si dhe për mësimdhënësit e angazhuar nga databaza në raste specifike;
- Propozim-ndryshimi i akteve ligjore dhe nënligjore në MASHT, komfor gjendjes aktuale në IEAA;
- Përgatitja me komisionin komunal për modifikimin dhe rivlerësimin e sistematizimit e vendeve të punës dhe planifikimin e përcaktimit të koeficientëve sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Administratës Publike (MAP);
- Shqyrtimi i të gjitha shkresave të drejtuara në DKA-ja;
- Planifikimi i buxhetit për institucionet shkollore;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Shpallja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Tërheqja e petty cashit për gjashtë institucione shkollore dhe DA;
- Futja e të dhënave të 1300 lëndëve në databazë;
- Transporti i gjashtë fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat speciale, nënlokimet për 12 muaj për paga;
- Kontrollimi i disa pagesave kapitale, M&SH, dhe komunalive, të cilat i janë në disponim dhe aprovimi (pagesa) e tyre;
- Të gjitha pagesat që arrijnë në shërbimin financiar dhe të cilat i pranohen nga zyrtari i shpenzimeve;
- Gjatë kësaj periudhe, janar-dhjetor, është intervenuar në sanimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore në: rikonstruktim dhe gëlqerosje, rikonstruktim të nyjave sanitare, rregullim të dysHEMEVE dhe plafonëve, rikonstruktimi dhe mirëmbajta të kulmeve të shkollave, furnizim dhe montim të rezervarëve të ujit në shkolla dhe institucione parashkollore, fillimi i ndërtimit të çerdhes, ndërtimi i sallave sportive;
- Rikonstruktimi dhe gëlqerosja e shkollave është bërë në: SHFMU “Zenel Hajdini”, SHML “28 Nëntori”, SHFMU “Xhavit Ahmeti”, SHML “Gjin Gazulli”, SHFMU “Faik Konica”, SHFMU “Tefik Çanga”- Koliq (amë dhe paralelet e ndara Ballaban dhe Podaj- Koliq), SHFMU “Avni Rustemi” dhe SHFMU “Pjetër Bogdani”;
- Rikonstruktimi i nyjave sanitare në disa shkolla të Prishtinës, është intervenuar në: SHFMU “Zenel Hajdini”, SHFMU “Pjetër Bogdani”, IP “Gëzimi Ynë”, SHFMU “7 Marsi”, IP “Botanika”, SHFMU “Shkëndija” në Hajvali;
- Rikonstruktimi dhe mirëmbajta e kulmeve është bërë në: SHFMU “Shkolla e Gjelbër”, SHFMU “Faik Konica”, SHFMU “Avni Rustemi”, SHFMU “Hilmi Rakovica”, SHFMU “Zenel Hajdini” dhe SHFMU “Asim Vokshi”;
- Furnizimi dhe montimi i rezervarëve të ujit në shkolla dhe institucione parashkollore, janë vendos në: IP “Fatosat”, IP “Buzëqeshja”, IP “Ardhmënia”, IP “Lulevera”, IP “Gëzimi Ynë”, SHFMU “Asim Vokshi”, SHFMU “Elena Gjika”, SHFMU “Emin Duraku”, SHFMU “Gjergj Fishta”, SHFMU “Hasan Prishtina”, SHFMU “Ismail Qemali”, SHFMU “Iliria”, SHFMU “Naim Frashëri”, SHFMU “Pjetër Bogdani”, SHFMU “Zenel Hajdini”, SHFMU

“Hilmi Rakovica”, SHFMU “Andon Z. Çajupi”, SHFMU “Ali Kelmendi”, SHFMU “Dituria”, SHFMU “Ganimet Tërbeshi”, SHFMU “Mitrush Kuteli”, SHFMU “Shkëndija”, SHFMU “Xhavit Ahmeti”, SHFMU “Shkolla e Gjelbër”, SHFMU “Afrim Gashi”, SHML “Eqrem Çabej”, SHML “Dr. Ali Sokoli”, SHML “28 Nëntori” dhe SHML “7 Shtatori”;

- Është realizuar rikonstruktimi i çerdhes në Mat, është përfunduar renovimi dhe rregullimi i oborreve të çerdheve në Besi dhe Hajvali, si dhe pajisjet me inventar dhe material didaktik IP Mat.
- Po ashtu, janë pajisja me rekuizita sportive nëntë salla të edukatës fizike, si dhe është punuar rreth marrjes së lejeve ndërtimore dhe përgatitjes për tenderim të projekteve. Është bërë shpallja e tenderit “Ndërtimi i objektit të shkollës në Mat 1”. Janë rinovuar kabinetet për pajisje të dhuruara nga donatorët gjermanë;
- Të gjitha punimet brenda objekteve shkollore janë realizuar sipas dinamikës dhe planifikimeve të parapara, pra procesi edukativo-arsimor në të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës është duke u zhvilluar me një dinamikë sipas kalendarit të vitit shkollor .

Aktivitetet e Drejtorisë në implementim e sipër:

- Hartimi i Rregullores komunale për stafin mësimor, jo mësimor dhe për të drejtat dhe detyrat e nxënësve;
- Nënshkrimi i kontratave pa afat të caktuar për të gjithë stafin e kualifikuar në institucionet arsimore të Komunës së Prishtinës;

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese:

BUXHETI i ARSIMIT per vitin 2015 Planifikimi-Alokimi-Shpenzimi dhe mbetjet						
Nr.	Kategoria e shpenzimeve	Planifikimi sipas Buxhetit 2015	Janë Alokuar në vitin 2015	Shpenzimet ne vitin 2015	Mbetjet-të pa shpenzuara ne vitin 2015	Të pa alokuara ne vitin 2015
1	PAGAT-sipas planifikimit buxheti i Arsimit	16,961,260.00				
	Pagesa shtesë përë eksperiencën nga MF	744,202.26	17,705,462.26	17,705,462.26	-	-
2	KOMUNALI-sipas planifikimit për Arsim	620,000.00	620,000.00	619,999.23	0.77	-
	Komunali-të paguara nga mjetet Komunale		110,251.12	110,251.12	-	
3	KAPITALET-planifikimi i buxhetit DA-2015	3,400,000.00	1,464,884.52	1,207,967.64	256,916.88	1,935,115.48
	Kapitalet-Bartja nga viti 2014		1,150,859.04	978,566.87	172,292.17	
4	SUBVENCIONET e planifikuara per 2015	210,000.00	120,000.00	70,964.75	49,035.25	90,000.00
	Bartja e subvencioneve nga viti 2014		23,357.36	1,715.95	21,641.41	
5	MALLRAT dhe SHËRBIMET	3,516,545.00	3,516,545.00	3,434,050.34	82,494.66	-
6	DONACIONET	17,639.50	17,639.50	14,435.50	3,204.00	-
	Total buxheti 2015	25,469,646.76	24,728,998.80	24,143,413.66	585,585.14	2,025,115.48

Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës mars-shtator, ka realizuar mbi 870 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara çdo të hënë dhe të enjte.

Takimet me institucione të tjera:

- Takim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë;
- Takim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit të qytetit të Dortmundit të Gjermanisë;
- Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave;
- Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Administratës Publike;
- Takim me përfaqësuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Takim me Përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Takim me kryetarin e komunës së Namurit të Belgjikës;
- Takime me përfaqësuesit e KFOR-it;
- Takime me organizata të ndryshme joqeveritare;
- Takime me përfaqësuesit e policisë së Kosovës;

Diskutime publike / takimet me qytetarë:

- Janë zhvilluar disa diskutime – takime publike me qytetarë, mësimdhënës në fshatrat: Besi, Trudë, Bardhosh dhe Bërnice; në lagjet: “Kolevica e Re” dhe “Sofalia” dhe në shkollat: “Faik Konica”, “Model”, “Afrim Gashi”, “Shkolla e Gjelbër”, “Nëna Terezë”, “Fan S. Noli” etj.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Gjatë vitit 2015, në Drejtorinë e Arsimit janë pranuar gjithsej **11775** lëndë, janë miratuar **477** lëndë, janë refuzuar **8763** lëndë dhe janë pezulluar **710** lëndë;
- **Vërejtje:** lëndët që figurojnë **1825** të papërfunduara, janë aplikacionet e konkursit të shpallur për mësimdhënës në institucionet e nivelit parauniversitar.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Gjatë vitit 2015, DSHMS-ja ka pranuar rreth 1900 lëndë në shqyrtim, ku sipas rezultatit del se:

Viti	Lëndë të pranuara	Lëndë të miratuara	Lëndë të refuzuara	Lëndë të hedhura Poshtë	Lëndë të pezulluara	Lëndë të pakryera
2013	994	755	229	2	8	-
2014	1376	920	418	2	36	-
2015	1865	1597	212			56
(01.01-20.03.)2016	1239	527	4	-	-	708

I gjithë stafi në këtë drejtori (edhe pse jo i mjaftueshëm), ka pasur me dhjetëra takime me qytetarë, të cilat përveç shërbimeve që kanë marrë, janë njoftuar edhe me procedura dhe me çështje të tjera sipas interesit dhe kërkesave të tyre. Në bashkëpunim edhe me organizata të tjera, e sidomos me Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pranë Asamblesë komunale, DSHMS-ja ka përcaktuar prioritetet dhe planin e veprimit për vitin 2015. Sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, e sidomos Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, janë përcaktuar katër prioritate të qarta:

- Planifikimi dhe ngritja e nivelit të transparencës;
- Ngritja e nivelit të cilësisë;
- Përmirësimi i nivelit të infrastrukturës dhe
- Ngritja e kapaciteteve të punës.

Planifikimi dhe ngritja e nivelit të transparencës

Në fillimi të vitit 2015, siç ishte vepruar edhe në vitin 2014, të gjithë profesionistëve shëndetësorë brenda Kujdesit Parësor Shëndetësor, u është komunikuar buxheti për vitin 2015 dhe në koordinim të plotë me shefat dhe kryeinfermierët e çdo institucioni shëndetësor në komunë, është rënë dakord që për një periudhë 2-mujore, të përgatiten të gjitha kërkesat nga çdo njësi në bazë të buxhetit të prezantuar. Gjithashtu, në drejtim të standardizimit të procedurave, është krijuar një zyrë e veçantë brenda Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për pranimin dhe seleksionimin e këtyre kërkesave. Janë organizuar edhe dëgjime publike në drejtim të informimit korrekt të palëve dhe publikut dhe gjetjes së një zgjidhjeje më të mirë. Pas pranimit dhe seleksionimit të këtyre kërkesave, janë bërë projektet dhe janë përgatitur për procedura të prokurimit. Në këto procedura, janë përfshirë edhe raportet e Komitetit për Shëndetësi nga Kuvendi komunal, i cili është punuar në bazë të vizitave që janë bërë në secilën qendër, që përveç të tjerash përmban edhe rekomandime mbi rregullimin e infrastrukturës dhe furnizimit me pajisje përkatëse. Po ashtu, është hapur web-faqja e QKMF-së, ku ofrohen të gjitha informacionet në lidhje me shërbimet shëndetësore në komunën e Prishtinës dhe informacione të tjera me interes për publikun.

Gjatë vitit 2015, është bërë dhe kompletuar rrjeti kabllor i të gjitha qendrave dhe tani të gjitha këto qendra kanë qasje në internet. Vlenë të përmendet se me masa informuese për publikun dhe rritjen e transparencës brenda QKMF-së, niveli i pjesëmarrjes është rritur dukshëm (nga 190.000 € në 2013 në mbi 300.000 € në vitin 2015). Në QKMF gjithashtu ka pasur me dhjetëra takime me stafin menaxhues, në drejtim të skanimit të procesit punues dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Në këtë drejtim janë formuar grupe punuese, për të bërë një vlerësim adekuat të resurseve humane dhe materiale. Konkurset vazhdimisht kanë qenë të monitoruara nga Sindikata e Punëtorëve Shëndetësorë, Kuvendi i Komunës, Shoqëria Civile etj., dhe në të gjitha proceset, notat nga të gjithë monitoruesit kanë qenë shumë pozitive. (<http://www.qkmf-pr.org/sq/ballina>)

Ngritja e nivelit të cilësisë

Gjatë vitit 2015, janë kompletuar tri komitetet pranë Qendrës Kryesore për Mjekësi Familjare. Komiteti për Cilësi, Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional dhe Komiteti për Edukim dhe Promovim të Shëndetit. Me përzgjedhjen e koordinatorëve të këtyre komiteteve, është rënë dakord që të krijohet një rreth vicioz, ku analizat të cilat dalin nga Komiteti për Cilësi, të shërbejnë për ngritjen e kapaciteteve për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe edukim dhe promovim të shëndetit, e pastaj analizat e nxjerra nga këto dy komitete të shërbejnë si bazë për hulumtime të tjera shtesë nga Komiteti për Cilësi të shërbimeve.

Gjatë vitit 2015, janë bërë disa hulumtime nga Komiteti për Cilësi, si: “Auditimi për Përdorimin e Antibiotikëve”, “Hulumtimi mbi Kënaqshmërinë e Pacientëve” etj. Pas rezultateve të cilat janë publikuar në web-faqen e QKMF-së, Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional ka organizuar shumë ligjërata dhe trajnime për stafin shëndetësor, në bashkëpunim edhe me QKUK-në, e sidomos me Klinikën Emergjente, Klinikën Endokrinologjike dhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente. Synimi i këtyre trajnimeve ka qenë ngritja profesionale e stafit. Gjithashtu, komiteti për Edukim dhe Promovim të Shëndetit, ka organizuar me dhjetëra takime dhe ligjërata me qytetarë me sëmundje të ndryshme, në mënyrë që të edukohen dhe të merren drejt me sëmundjet e tyre. Në kuadër të promovimit, janë organizuar edhe dhjetëra ligjërata nëpër shkollat e Prishtinës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit. Ligjëratat janë zgjedhur për grupmosha të caktuara, në bazë të analizave paraprake, me tema të veçanta dhe me interes për këto grupmosha.

Për herë të parë, pas më shumë se 14 vjetëve, në bashkëpunim me OBSH-në, është botuar revista shëndetësore “SHËNDETI 038”, ku përveç informimit të qytetarëve mbi shërbimet që ofron Kujdesi Parësor Shëndetësor në Komunën e Prishtinës, ka edhe informacione të shumta mbi sëmundjet dhe parandalimin e sëmundjeve.

Disa nga aktivitetet gjatë vitit 2015, në kuadër të “Edukimit dhe promovimit të shëndetit”:

- Java e preventimit të kancerit të qafës së mitrës, janar;
- Aktiviteti për promovim shëndetësor për femra të moshës së rrezikuar, në Hajvali dhe Shkabaj, si dhe në kolektivin e çerdhes “Gëzimi Ynë”;
- Shëndeti oral “Buzëqeshi Jetës”, mars;
- Dita Botërore e Luftës Kundër TBC-së, mars;
- Java Evropiane e Imunizimit, prill;

- Dita e Infermierisë, Dita e Hipertensionit dhe Dita Botërore pa Duhan, maj;
- Dita Ndërkombëtare Kundër Drogës, qershor;
- Dita Ndërkombëtare e Zemrës dhe Dita e Promovimit të Gjdhënies, shtator;
- Muaji i Luftës Kundër Kancerit të Gjiri, ku u ofrua mamografia falas për 100 femra të rasteve sociale gjatë tërë muajit, tetor;
- Dita Botërore Kundër Diabetit, nëntor;
- Shënimi i Ditës Kundër HIV-AIDS për nxënësit e klasave të 11-ta dh 12-ta në shkollat e mesme: "Gjin Gazuli", "Xhevdet Doda", "28 Nëntori" dhe "Eqrem Çabej", dhjetor.

Përmirësimi i nivelit të infrastrukturës

Gjatë vitit 2015, vetëm në QKMF ka pasur 900.000 vizita të pacientëve dhe mbi 2 milionë shërbime shëndetësore. Kjo ka sjellë një nevojë për ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe pajisjen me aparatura përkatëse të të gjitha qendrave. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në kërkesat paraprake nga Qendrat, ka vazhduar renovimi dhe përshtatja e ambienteve në Qendrat Shëndetësore sipas kritereve bashkëkohore.

Duke u nisur edhe nga numri i vizitave dhe volumi i punës, fillimisht janë përzgjedhur qendrat më të mëdha, duke filluar nga QKMF-ja, ku përveç renovimeve dhe përmirësimit të ambientit, është instaluar edhe **ashensori**, i cili tani iu mundëson të gjithë qytetarëve, pa dallim, të marrin të gjitha shërbimet shëndetësore në këtë qendër. E njëjta ka ndodhur edhe me Qendrën në lagjen "Bregu i Diellit", ku është instaluar gjithashtu **ashensori** dhe janë bërë ndryshime të shumta për shkak të vjetërsisë së objektit, duke instaluar edhe dyer e dritare të reja, riorganizim dhe përmirësim të hapësirave për pacientët dhe stafin shëndetësor. Në Qendrën në lagjen "Dardania" gjithashtu është bërë rinovimi komplet i kësaj qendre, konform standardeve dhe hapjen e shërbimit preventiv stomatologjik për fëmijë, i pari i kësaj natyre në komunën e Prishtinës.

Në këtë fazë të rinovimit janë përfshirë edhe objekte të tjera dhe njëkohësisht, bazuar në raportin e Komitetit për Shëndetësi dhe analizimit të situatës në terren, ka filluar edhe kompletimi dhe funksionalizimi i plotë i shumë ambulancave në zona rurale. Përveç ndërhyrjeve, janë hapur edhe puse për të siguruar ujë të mjaftueshëm për organizimin e punëve në këto ambulanca. Intervenimi dhe funksionalizimi i plotë i këtyre qendrave është akoma në proces dhe pritet të përfundojë nga mesi i vitit 2016. Në secilën qendër janë standardizuar këndet e njoftimeve dhe identifikimeve të shërbimeve dhe stafit përkatës përmes tabelave sinjalizuese, të cilat u ofrojnë qytetarëve të gjitha informacionet e nevojshme nga hyrja në Qendër deri te emri i personelit dhe shërbimet që ata ofrojnë. Është hapur edhe Qendra e Mjekësisë Familjare nr.11, në Lagjen e Muhaxhirëve, e ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore.

Nr.	Emërtimi i projektit	Punëkryesi (emri i kompanisë)	Vlera e kontratës	Shuma e paguar, janar - qershor 2015
1	Ndërtimi i QMF në Lagjen e Muhaxhirëve në Prishtinë	“Al Trade” sh.p.k.	487,987	97,642.65
2	Ndërtimi i objektit banesor për rastet sociale	“Olti Trasing” sh.p.k.	765,986	106,600.30
3	Furnizim me dy autoambulanca për nevojat e QMU-së	“Delfin@Nera Med”	118,960	118,960.00
4	Furnizim me inventar për nevojat e QKMF-së, Prishtinë	“Duglas’	21,076.00	21,076.00
5	Ndërtimi dhe renovimi infrastrukturës në: QKMF, në disa qendra të tjera, pjesa III dhe QMF V	“CTA” N.N.P	54,159	54,159
6	Ndërtimi dhe renovimi i QKMF-së dhe në disa qendra të tjera pjesa e I-rë	“Delta Ing” sh.p.k.	35,862.50	32,256.88
7	Ndërtim dhe renovimi i QKMF-së dhe në disa qendra të tjera, pjesa IV	OE “Tribune&Andi Group”	137,955.87	69,991.17
8	Ndërtimi dhe renovimi infrastrukturës në QKMF dhe disa qendra të tjera, pjesa II	AHV-SH.P.K@KAËA Group	69,598.75	24,175.52
9	Furnizim me pajisje mjekësore - pjesa I, II,III	Koslabor	59,710	59,710
10	Furnizim me pajisje mjekësore -pjesa IV	“KO Made” NP	9,670	9,670
Gjithsej:				594,241.52

Ngritja e kapaciteteve të punës – Gjatë vitit 2015, bazuar në:

- Analizat e viteve paraprake;
- Kërkesat e punonjësve shëndetësorë;
- Vizitat sistematike në shkollat fillore dhe të mesme;
- Kërkesat e qytetarëve;
- Raportet dhe rekomandimet nga Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pranë Asamblesë komunale.

Është parë e nevojshme pajisja e qendrave me aparatura dhe rrjedhimisht edhe shtimi i shërbimeve shtesë për qytetarët. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2015, pasi që është bërë pajisja e të gjithë stafit shëndetësor me mjetet themelore të punës – bazuar edhe në kërkesat që dalin nga Udhëzimet administrative për kujdesin parësor shëndetësor, është investuar edhe në një RTG Digjitale, RTG Stomatologjik, disa karrige stomatologjike, ku përveç shërbimit preventiv në QMF Dardania, për herë të parë është hapur shërbimi stomatologjik edhe në QMF nr.9 në lagjen “Vreshtat”. Në QMF VI në lagjen “Bregu i Diellit”, është kompletuar dhe funksionalizuar komplet shërbimi stomatologjik. Duke parë rëndësinë e sterilizimit dhe mbrojtjes së pacientëve, pas analizës së bërë në shkurt të 2014-s, ku rezultoi një nivel shqetësues i sterilizimit, dhe vetëm 4 sterilizatorë kanë plotësuar standardet nga 25 sa ishin, janë marrë masa dhe tani të gjithë sterilizatorët në të gjitha qendrat janë funksionalizuar në tërësi dhe tani janë në kontroll strikt

të sterilizimit në bazë të standardeve të kërkuara. Gjithashtu, me ndihmën e KFOR-it italian, në bazë të një donacioni për një ultrazë, për herë të parë në komunën e Prishtinës ka filluar ekzaminimi sistematik i kukave të fëmijët e vegjël. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve është bërë investim në sigurimin e pajisjeve digjital, ku një pjesë e tyre është dhënë donacion nga organizata të ndryshme. Pas analizës së rezultateve pas vizitave sistematike në shkollat e Prishtinës, secila Qendër është pajisur me Skoliometër, i cili diagnostifikon dhe përcakton shkallën e devijimit të boshtit kurrizor të fëmijët. Gjithashtu, në QKMF, për herë të parë, bazuar në këto vizita sistematike, ka filluar edhe ekzaminimi i shputës të fëmijët pas blerjes së Pedoskopit, i cili e përcakton se sa e rrafshët është shputa të fëmijët me këto probleme. Gjithashtu, pas hapjes së QMF 11 në Lagjen e Muhaxhirëve, ka vazhduar shpërndarja racionale e stafit shëndetësor konform nevojave në terren.

Në kuadër të ngritjes së kapacitetit të punës, duhet patjetër të përmenden vizitat sistematike, që për herë të parë në vitin 2015 ka filluar edhe për klasat IX. I gjithë procesi ka zgjatur më shumë se tre muaj, dhe fal një donacioni nga shteti Çek, i gjithë procesi ka qenë i digjitalizuar, ku të gjitha të dhënat janë futur menjëherë në sistem. Edhe rezultatet e këtij viti tregojnë se fëmijët në komunën e Prishtinës vazhdojnë të përballen me probleme shëndetësore. Për dallim nga viti 2014, ku higjiena orale ka qenë një nga problemet kryesore të fëmijëve në shkolla, falë punës në edukim dhe ligjërata gjatë gjithë vitit 2014, në vitin 2015 ky problem rezulton të jetë më pak i shprehur. Gjatë vizitave në vitin 2015, problemet kryesore rezultojnë të jenë problemet muskulo-skeletore, si deformimet të boshtit kurrizor, shputat e rrafshëta etj. Në këtë drejtim, bashkë me Drejtorinë e Arsimit, kanë filluar masa në drejtim të ligjëratave dhe uljes së peshës së çantave, sidomos të fëmijët e klasave të ulëta.

Përfshirja e nxënësve në vizita sistematike										
Numri i nxënësve	Kl.I		Kl.V		Kl.IX		Totali			
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat	Nr. Qytet	Nr. Fshat	Totali	%
Nxënës të evidentuar	3229	471	3036	551	3221	579	9486	1601	11087	100%
Vizita sistematike të realizuara	2806	333	2745	337	2887	363	8389	1033	9471	85.4%
	91.7%	70.7.1%	90.1%	61.2%	86.4%	62.7%	89.3%	64.5%		
Mungojnë	260	138	295	214	448	216	1003	568	1616	14.6%
	8.3%	29.3%	9.9%	38.8%	13.6%	37.3%	10.7%	35.5%		

Qendra e Mjekësisë Urgjente

Gjatë vitit 2015, në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU) janë realizuar gjithsej 36934 vizita mjekësore, prej të cilave 12410 janë vizita të realizuara në terren. Me kërkesë të stafit shëndetësor në këtë qendër dhe me disa vërejtje-këshilla nga Inspektorati, janë bërë edhe renovimet e nevojshme, ku përveç evitimit të problemeve teknike paraprake, është bërë edhe një riorganizimi i infrastrukturës së brendshme në favor të lehtësimit të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve për pacientët. Gjithashtu, për herë të parë në këtë Qendër është formuar Komiteti për cilësi, ku koordinatori i këtij komiteti në bazë të hulumtimeve dhe analizave, ka përcaktuar disa aktivitete në drejtim të ngritjes së cilësisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Në

drejtim të rritjes së transparencës dhe informimit korrekt të qytetarëve për shërbimet në këtë qendër, gjatë vitit 2015 është filluar punimi i web-faqes së kësaj qendre, e cila pritet të finalizohet së shpejti.

Qendra e Mjekësisë Urgjente gjatë vitit 2015, ka pasur një mori aktivitete:

- Në bashkëpunim me ekspertët e KFOR-it gjerman, në Spitalin Ushtarak është mbajtur trajnimi për përkrahje bazike për jetë, “Përkrahja e avancuar për jetë dhe mbështetja paraspitalore për mbijetesë të traumat”), Prizren, janar;
- Me trajnerët nga Suedia, është mbajtur trajnimi për licencimin e 7 dispeçerëve në sistemin e komunikimit “Paratus”, ku mundësohet lidhja e drejtpërdrejtë e ekipeve në terren me QMU-në dhe Klinikën Emergjente në QKUK, mars;
- Është mbajtur kursi për Defibrilimin e jashtëm, për punëtorët shëndetësor të QMU-së, të qendrave të Mjekësisë Familjare nga komunat e Kosovës dhe stafi mjekësor i FSK-së, maj;
- Konferenca e Gjashtë e Mjekësisë Emergjente, me pjesëmarrje ndërkombëtare. QMU u prezantua me dy punime shkencore; mbajtur në hotel „Grand” në Prishtinë, maj;
- Ushtrim i organizuar nga Bashkimit Evropian lidhur me menaxhimin e fatkeqësive dhe katastrofave, Maqedoni, qershor;
- Dita e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Prishtinë, qershor;
- Shënimi i Ditës Botërore të Ndihmës së Parë, Prishtinë, shtator;
- Dita e Menaxhimit të Fatkeqësive, janë mbajtur ligjërata lidhur me rreziqet që i kanosen popullatës në Kosovës, në Qendrën e telemjekësisë, shtator;
- Simpozium i përbashkët i punëtorëve shëndetësorë nga QMF-të dhe QMU-së, shtator;
- Është improvizuar shpërthim i zjarrit, Ushtrimi për menaxhimin e fatkeqësive, në gjimnazin “Xhevdet Doda”, ku kanë intervenuar ekipet e Brigadës së zjarrfikësve për evakuim dhe shpëtim, tetor.

Sektori i mirëqenies sociale

DSHMS-ja Sektorin e mirëqenies sociale e mbulon përmes Sektorit të veçantë, po ashtu edhe mbi bazën e kompetencave të deleguara e mbikëqyrë punën e Qendrës për Punës Sociale. Në këtë drejtim, DSHMS-ja ka realizuar shumë takime me qytetarë, të cilët kanë qenë në cilëndo mënyrë palë në procedurat e ndryshme administrative të zhvilluara brenda këtij sektori.

DSHMS-ja përmes Sektorit të mirëqenies sociale, në bashkëpunim me QPS-në, brenda një periudhe të shkurtë është duke përgatitur dokumentet të rëndësishme për funksionimin e kësaj qendre. Kjo çështje është me prioritet, sepse me nxjerrjen e këtyre akteve do të lehtësohet aktiviteti i QPS në drejtim të funksionalitetit optimal. Po ashtu, me këto akte do të qartësoheshin kompetencat e organeve të brendshme të QPS-së. Gjatë vitit 2015, kanë qenë mbi 1800 kërkesa për subvencione për raste sociale, ku shumica e tyre në bazë të dokumentacionit të ofruar, janë subvencionuar me vendim nga Komisioni në shumta të ndryshme, varësisht nga dokumentet e prezantuara dhe situatës në terren. Gjithashtu, gjatë këtij viti ka filluar subvencionimi i qirasë për disa familje pa strehë, me theks të veçantë, familjeve që kanë qenë në kontejnerë në Fushën e Pajtitimit.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucion komunal, i cili funksionon në mbikëqyrjen dhe kujdesin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) të Komunës së Prishtinës, në funksion të gjithë qytetarëve të saj në gjendje të nevojës sociale, pa marrë parasysh moshën, gjininë, nacionalitetin, religjionin etj. Secila palë që përfiton çfarëdo shërbimi në QPS ka dosjen e vet, numrin rendor dhe të gjitha dokumentet e domosdoshme të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi. Brenda QPS-së funksionojnë tri njësi organizative (“Qafa”, “Kodra e Trimave” dhe “Kodra e Diellit”), kemi në funksion disa forma për grumbullimin e informatave, si në versionin të shkruar ashtu edhe në formën elektronike për grumbullimin e të dhënave, siç janë:

- Sistemi i grumbullimit të të dhënave për palët përfitues të shërbimeve sociale profesionale përmes bazës së shënimeve, e cila është në funksion prej shumë vitesh;
- Sistemin elektronik të bazës së të dhënave për evidentimin e klientëve përfitues të ndihmave materiale, e njohur si Skema e asistencës sociale;
- Sistemin elektronik të bazës së të dhënave për personat me nevoja të veçanta;
- Sistemin manual individual, ku secili punonjës mban dosjen e tij/saj fizike për secilin shfrytëzues të shërbimit;
- Arkivi i QPS-së, ku ruhen dosjet për shumë vite, me rendësi të veçantë, ato të adoptimit.

Numri aktual i palëve është 1872, ku janë të përfshirë 47 kategori të palëve, si: fëmijë të braktisur, fëmijë me sjellje asociale, fëmijë në konflikt me ligjin, fëmijë të prindërve të ndarë apo në proces të ndarjes e shkurorëzimit, fëmijë lypsarë, delikuentet e mitur, persona me çrregullime mendore të strehuar në Institucion rezidenciale, viktima të dhunës në familje dhe trafikim, tentim vetëvrasje, prindër vetushqyes, të moshuar në nevoje për strehim etj.

Për këto kategori të identifikuar të llojit të palëve, QPS-ja gjatë kësaj periudhe ka ofruar 8892 shërbime. Llojet e shërbimeve që ofrohen janë 55, ku do t’i përmendim vetëm disa nga to, si: bashkimi familjar, kujdestaria, strehimi familjar, adoptimi vendor, adoptimi ndërshtetëror, shërbimet për peronat e rritur me çrregullime mendore, shërbimet për fëmijët në konflikt me ligjin, shërbime në realizimin e kontaktimit mes fëmijëve dhe prindërve të ndarë, vendosja në institucione të ndryshme dhe përcjellja e rasteve, mendime dhe anamneza për gjykatë dhe shumë shërbime të tjera. (*Shih aneksin 1*)

Të dhënat për Skemën e asistencës sociale, janar - dhjetor 2015

Gjithsej numri i familjeve përfituese të Skemës së asistencës sociale për muaj gjatë vitit 2015, është rreth 1600 familje, me rreth 6000 anëtarë. Ky numër është përafërsisht i njëjtë secilin muaj. Familjet e kategorisë së parë janë rreth 1100, kurse nga kategoria e dyte janë 500 familje. Njëkohësisht kemi dhjetëra familje të refuzuara për arsye të ndryshme, si: jo riaplikim me kohë, mos tërheqja e mjeteve për dy muaj, nuk i ka format e plotësuara në mungese të dokumentacioneve, adresa e gabuar, familja realizon të ardhura të tjera etj.

Sipas njësive, prinë Njësia “Kodra e Trimave”, me numrin e përfituesve të SAS, pasi që në atë pjesë edhe varfëria është më e theksuar.

- “Kodra e Trimave”, 866 familje me 3441 anëtarë,
- “Qafa”, 386 familje me 1525 anëtarë,
- “Kodra e Diellit”, 326 familje me 1247 anëtarë.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, janë lëshuar 1526 vërtetime për posedim arme, fitim apo humbje shtetësie dhe punësim.

Skema e pagesave për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët marrin mjete në shumën prej 100 euro në muaj, është rreth 300 fëmijë.

Pagesat nga MPMS-ja për klientët e QPS-së Prishtinë e që nga aspekti profesional menaxhohen nga stafi i QPS-së, kurse mjetet i disponon dhe i kryen pagesat MPMS-ja, për një vit arrin shumën rreth 2, 140, 000 euro:

Skema e Asistencës Sociale -SAS	1,700,000 euro
Strehim familjar brenda familjes	40,000 euro
Strehim familjar jashtë familjes	10, 000 euro
Fëmijë me aftësi të kufizuar	350, 000 euro
Raste të dhunës në familje	30, 000 euro
Ndihma të njëhershme	10, 000 euro

Aktivitetet e ndërmarra gjatë periudhës janar – dhjetor 2015:

- Përfundimi i renovimit të QPS, përfshirë tri njësit organizative;
- Bashkëpunimi me OSBE-në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe planifikimi për mbajtjen e dy tryezave të menaxhimit të rasteve;
- Zhvillimi i projektit për Institucionalizimin e TMR-së, në bashkëpunim me QGMF, e dorëzuar në Ambasadën amerikane në Prishtinë;
- Përgatitja e kërkesës për pajisjen e tri dhomave të kontaktimit, përmes donacionit të Ambasadës gjermane;
- Bashkëpunimi me GIZ-in në fushën e këmbimit të përvojave rreth TMR dhe punës së fëmijëve në situatë rrugë;
- Aksioni i javës sociale dhe organizmi i vizitave sistematike për 50 persona përfitues të skemës së asistencës sociale, të moshës mbi 50 vjeç, në spitalin “Medica”;
- Njoftimi dhe organizmi i trajnimit dhe prezantimit të planit të veprimit me gjithë stafin e QPS Prishtinë;
- Organizimi i takimit në bashkëpunim me OSBE-në, rreth zhvillimit të mekanizimit koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, ku të përfshirë kanë qenë më tepër se 20 aktorë të kësaj fushe;
- Bashkëpunimi i ngushtë me projektin “Matra” rreth zhvillimit të strehimit familjar të fëmijëve pa përkujdesje prindërore;
- Takime koordinuese ndërministrorë tripalëshe mes Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë, rreth fuqizimit të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rrugë;
- Pjesëmarrja me Asociacionin e Komunave të Kosovës në grupin punues, rreth ndryshim-plotësimit të katalogut për pagat e shërbyesve civilë të Kosovës;
- Organizimi i trajnimeve për stafin e QPS në fushën e planit të veprimit, Ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare, si dhe në standardet për fushat e caktuara të mbrojtjes së fëmijëve;
- Puna e përbashkët me OJQ “Terre de Hommes” në zhvillimin e protokollit për Tryezën për menaxhimin e rasteve;

- Trajnimi për trajnerë për udhëheqjen dhe menaxhimin e tryezave për menaxhim të rasteve, organizuar nga ekspertë nga Holanda, me përkrahjen e OJQ “Terre de Hommes”;
- Përpilimi i planit të punës dhe bashkërendimit të aktiviteteve me GIZ-in për periudhën e ardhshme të vitit 2015;
- Organizimi i takimit rajonal me Policinë e Kosovës, QMGF dhe QPS rreth praktikës së punës për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje;
- Ndhimat në pako dhe mjete materiale nga donatorë të ndryshëm, si:
 - ✓ “Bereqeti”, 100 pako,
 - ✓ Shoqata bamirëse “Iniciativa Fisniku”, 83 pako,
 - ✓ 25 familje nga 150 euro, gjithsej 4000 euro donator privat;
- Pjesëmarrja në takimet informuese, të organizuara nga MPMS dhe projekti i BE-së;
- Pjesëmarrja dhe prezantimi i punës në konferencën regjionale, të mbajtur në Sarajevë, rreth zhvillimeve dhe sfidave të mbrojtjes sociale;
- Takimi rreth strategjisë për mbrojtjen e fëmijëve, në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë të Kryeministrit;
- Pjesëmarrja në grupin punues për zhvillimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, mbajtur në Durrës;
- Prezantimi në takim koordinues me OJQ PVPT, “Mbrojta dhe rehabilitimi i viktimave të trafikimit”;
- Prezantim njëditor i punës së QPS Prishtinë për studentët e Departamentit të Punës Sociale nga Gjermania;
- Dy takime rreth finalizimit të dokumentit për zhvillimin mekanizmit koordinues dhe caktimin e koordinatorit për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje;
- Emërtimi në pozita të ushtruesit të detyrës për tre muaj në disa pozicione, si shef i njësisë “Kodra e Diellit”, shef i Shërbimeve Sociale “Kodra e Diellit”, shef i Shërbimeve Sociale “Kodra e Trimave”, shef i Skemës së SAS, njësia “Qafa”;
- Transferim i stafit nga njësia “Qafa” në njësinë “Kodra e Trimave” deri në plotësimin e vendeve të lira të punës, më sistem rotativ korrik – dhjetor;
- Trajnimi i gjithë stafit të licencuar për rilicencim, organizuar nga projekti i BE-së;
- Marrja e donacionit nga OSBE-ja në pajisje të teknologjisë informative;
- Organizimi dhe shpërndarja e ndihmave për familjet në skemën sociale nga donatorët e ndryshëm gjatë muajit të Ramazanit;
- Caktimi i koordinatorit të Këshillit komunal kundër dhunës në familje;
- Pjesëmarrja në takime punuese rreth ndryshimit të ligjit për regjistrim civil me MPB;
- Pjesëmarrja e stafit në Punëtorinë për zhvillimin strategjisë kundër përdoruesve të drogës, organizuar nga “Labirynth”;
- Takimi me përfaqësues të Ambasadës amerikane në Prishtinë rreth mundësisë së organizimit të trajnimeve për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge;
- Pjesëmarrje dhe prezantim në takim me forumin e të rinjve të komunës së Prishtinës;
- Organizimi i tryezave për menaxhim e rasteve në mbrojtjen e fëmijëve kundër dhunës në familje;
- Takime me agjencinë për ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje, trafikim dhe krime seksuale dhe koordinimi i aktiviteteve;
- Pjesëmarrje në takim me UNHCR lidhur me intervistimin e fëmijëve azilkërkues në Kosovë;

- Trajnim për të gjithë stafin profesional lidhur me rilicencim, i cili ka zgjatur dy ditë;
- Pjesëmarrje në zhvillimin e Ligjit për mbrojtën e fëmijëve dhe ndikimet në ligj;
- Trajnimet për tryezat për menaxhimin e rastit;
- Themelimi i Këshillit koordinues komunal për viktimat e dhunës;
- Pjesëmarrje në zhvillimin e strategjisë 2016-2021, kundër viktimave të dhunës në familje;
- Organizmi i ditës së të drejtave të fëmijëve dhe fushata sensibilizuese në terren, në bashkëpunim me “Amici de Bambini” për strehimin familjar, ku pas këtyre veprimeve kemi pasur rritje të interesimit të familjeve dhe tani jemi në proces të rekrutimit të disa familjeve të reja;
- Përgatitja e listave dhe shpërndarja e ndihmave në dru për ngrohje 200 m³, dhurata 497 pako dhe donacione të ndryshme të fund vitit nga persona fizikë apo juridikë;
- Organizmi i disa takimeve nëpër shkolla të mesme dhe fillore të Prishtinës, për ngritjes e vetëdijes kundër dhunës në familje, sidomos gjatë fushatës 16 ditore kundër dhunës në familje;
- Zbatimi i projektit rreth eliminimit të fëmijëve dhe të rriturve nga situata e rrugës, me theks të veçantë në udhëkryqe dhe në sheshet e Prishtinës me rastin e festave të fundi vitit.

Të dhënat për shërbime sociale profesionale, janar – dhjetor 2015

	Lloji i palës / kategorisë	Gjithsejtë
Nr.		
1	Fëmijët e braktisur	6
2	Fëmijët e braktisur, prindërit e të cilëve janë të panjohur (NN)	0
3	Fëmijët jetim	1
4	Fëmijët e prindërve të penguar të kryejnë detyrën prindërore	4
5	Fëmijët e prindërve që u është marr zotësia e veprimit	1
6	Fëmijët e prindërve që janë në vuajtje të dënimit	0
7	Fëmijët me sjellje asociale deri 14 vjeç	59
8	Fëmijët kryes të veprave penale, pa përgjegjësi penale (nën 14 vjeç)	41
9	Të miturit në konflikt me ligjin 14 -16 vjeç	74
10	Të miturit në konflikt me ligjin 16-18 vjeç	330
11	Përmirësimi i marrëdhënieve bashkëshortore	87
12	Fëmijët e prindërve me probleme familjare e bashkëshortore, në procesin e ndarjes e të shkurorëzimit dhe të ndarë e të shkurorëzuar	145
13	Fëmijët që realizojnë kontakte me prindërit e shkurorëzuar e të ndarë	604
14	Fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme	62
15	Fëmijët e keqtrajtuar, neglizhuar e lënë pas dore	9
16	Fëmijët viktimat të dhunës në familje	19
17	Fëmijët viktimat të trafikimit	4
18	Fëmijët viktimat të krimeve seksuale	6
19	Fëmijët përdorues të substancave psiko-aktive	0

20	Fëmijët që kryejnë punë të rënda dhe të rrezikshme	23
21	Të miturit në martesë para moshës madhore	4
22	Fëmijët e rrëmbyer, me element ndërkombëtar	0
23	Fëmijët e rrëmbyer, me element vendor	3
24	Fëmijët lypsarë	44
25	Të rritur lypsarë	26
26	Personat e rritur me çrregullime mendore	169
27	Personat e rritur, viktimat të dhunës në familje	48
28	Personat e rritur, viktimat të trafikimit	1
29	Personat e rritur, viktimat të krimeve seksuale	0
30	Personat e rritur, përdorues të alkoolit	0
31	Personat e rritur, përdorues të drogës	0
32	Personat e moshuar pa përkujdesje familjare	6
33	Personat në situatë për marrjen e zotësisë së veprimit	11
34	Kërkesë për adoptim vendor	16
35	Kërkesë për adoptim ndërkombëtar	1
36	Kërkesë për strehim familjar brenda familjes	9
37	Kërkesë për strehim familjar jashtë familjes	1
38	Kërkesë për strehim familjar për fëmijët me nevoja të veçanta	2
39	Ndihma emergjente për personat në gjendje të nevojës sociale	1
40	Tentim vetëvrasje	2
41	Kërkesë për dhënien e pëlqimit për bartje të pasurisë për të mitur	4
42	Ikje nga shtëpia	6
43	Prind vetushqyes	2
44	Fëmijët në punë	6
45	Kategoritë e tjera në gjendje të nevojës sociale	21
46	Personat në situatë për marrjen e së drejtës prindërore	12
47	Pëlqim për dokument të udhëtimit jashtë vendit	2
		1872
	Shërbimet e ofruara në QPS	
1	Kujdestaria për të mitur	66
2	Kujdestaria për të rritur	3
3	Kujdestaria për raste të veçanta	29
4	Bashkimi familjar	66
5	Adoptimi me element vendor	111
6	Adoptimi me element ndërkombëtar	15
7	Fëmijët në strehim familjar brenda familjes	102
8	Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes	25
9	Fëmijët me nevoja të veçanta në strehim familjar	22
10	Strehimi i përkohshëm në shtëpitë për strehim të përkohshëm	27
11	Strehimi në shtëpitë me bazë në komunitet	5
12	Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje	28
13	Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit	8
14	Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të krimeve seksuale	0

15	Shërbimet për personat e rritur me çrregullime mendore	1253
16	Shërbimet për rehabilitim e riintegrim të viktimave në familje e komunitet	121
17	Vizita në familje, shkollë, komunitet etj.;	1090
18	Dhënia e ndihmës emergjente (e një hershme)	3
19	Dhënia e ndihmës në natyrë	28
20	Shërbimet për fëmijët në konflikt me ligjin	726
21	Bashkëpunimi me gjykatë – pjesëmarrja	314
22	Mbikëqyrja e shtuar e Organit të Kujdestarisë	46
23	Bashkëpunimi me institucione tjera të ndërlidhura me fëmijët në konflikt me ligjin	240
24	Këshilla martesore	200
25	Ndihma në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore e familjare	301
26	Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve	52
27	Dhënia e mendimit për martesë të të miturve	26
28	Shërbimi në realizimin e kontaktimit mes fëmijëve e prindërve të ndarë e shkurorëzuar	765
29	Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer me element ndërkombëtar	0
30	Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer me element vendor	3
31	Ndihma në regjistrimin e mëvonshëm të fëmijëve	53
32	Ndihma në rregullimin e dokumentacionit të udhëtimit	36
33	Shërbimet për personat e rritur, viktimë të trafikimit	0
34	Shërbimet për personat e rritur, viktimë të krimeve seksuale	7
35	Shërbimet për personat e rritur, përdorues të alkoolit	0
36	Shërbimet për personat e rritur, përdorues të drogës	14
37	Shërbimet për personat e moshuar e pa përkujdesje familjare	77
38	Shërbimi për prindërit në nevojë për adoptim	124
39	Shërbimet për familjet e vlerësuar për strehim familjar	25
40	Shërbimet për familjet që strehojnë fëmijë jashtë familjes	43
41	Shërbimet për familjet që strehojnë fëmijë brenda familjes	182
42	Shërbimet për familjet që strehojnë fëmijë me nevoja të veçanta	9
43	Shërbimet për personat e rritur me nevoja të veçanta	28
44	Mendimi për gjykatë	150
45	Zhvendosja nga një institucion në tjetrin	44
46	Marrja e deklaratës	671
47	Shërbimet për fëmijët lypsarë	53
48	Shërbimet për të rriturit lypsarë	27
49	Pëlqimi për hyrje në martesë të parakohshme	5
50	Pëlqimi për shitblerjen e patundshmërisë për personat e mitur	13
51	Shërbimet gjatë kujdestarisë jashtë orarit dhe vikendeve	111
52	Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme	719
53	Referim për vendosje në institucione tjera rezidenciale dhe/apo OJQ	14
54	Shërbimet tjera/ kategori e paspecifikuar	788
55	Shërbime për personat në proces të marrjes së të drejtës prindërore	0
56	Shpallje e personit të zhdukur -vdekur	3
		8892

	<u>Punë administrative</u>	
1	Konstatime zyrtare për lirim nga shtetësia	313
2	Konstatime zyrtare për fitimin e shtetësisë	182
3	Vërtetim për posedim të armëmbajtjes	346
4	Vërtetim për punësim	637
5	Oda e avokateve	45
6	Konstatim zyrtar për vendosje të fëmijëve në kopshtin e fëmijëve	3
		1526

Koment: Në këtë raport përfshihen të gjitha rastet aktive, të cilat kanë qenë dhe janë në QPS Prishtinë aktive, pasi që kemi shumë raste të cilat janë në sistem të mbrojtjes sociale, të cilave nuk arrihet t'u bëhet zgjidhje me vite të tëra, bazuar në standardet dhe procedurat e përcaktuara me ligj.

Shërbimi administrativo – financiar

Paga dhe mëditje	210, 205 €
Komunali	15, 012 €
Mallra dhe shërbime	19, 574 €
Gjithsej	244, 791 €

Aktivitetet tjera:

- Përpilimi i kërkesave për servisim të kompjuterëve, aparateve fotokopjuese, përgatitja dhe përkujdesja për furnizim me pajisje, material zyrtar për nevojat e Qendrës dhe njësisë në Kodrën e Trimave dhe Kodrën e Diellit.
- Arkivimi dhe mbajtja e evidencës së listave të pagave dhe mbajtja në rregull e dosjeve personale të çdo punonjësi të Qendrës.

Pasqyra e kilometrave të kaluara dhe sasia e derivateve e paraqitur në litra, janar-dhjetor:

QPS	AUTOMJETI	Litrat e shpenzuara
Qendra	“Suzuki” 01z – 53 - 19	850.19
Kodra e Trimave	“Suzuki” 01z – 54 – 19	1035.99
Kodra e Diellit	“Suzuki” 01z – 52 – 19	792.88
Kodra e Trimave	Gjeneratori	800
Kodra e Trimave	Nxehja qendrore	2500

DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

Në periudhën janar-dhjetor 2015, në Sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural përveç projekteve të realizuara, janë zhvilluar edhe aktivitete që kishin për bazë përcjelljen e punëve në lëmin e bujqësisë, si: procesi i mbjelljeve pranverore, procesi i korrje-shirjeve, këshillime profesionale të fermerëve, procesi i mbjelljeve vjeshtore. Në lëmin e pylltarisë aktivitet kryesor ka qenë ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve (prerje ilegale, erozioni etj.), pastaj damkosja (në stivë) e masës drusore (e lejuar për shfrytëzim), vlerësimi i dëmeve në pyje, si dhe përgatitja dhe përcjellja e fletëparaqitjeve në gjykatat përkatëse.

Aktivitetet e realizuara të Drejtorisë:

Shërbimi i bujqësisë		
Nr.	Subvencionet/projektet/aktivitete	Vlera / €
1.	Subvencione/projekte	
1.1	Përkrahja e fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore	40,672.00
1.2	Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patateve	39,984.00
1.3	Përkrahja e fermerëve në perimtari - serra	105,000.00
1.4	Përkrahja e fermave në lëmin e shpësërisë - pula vojse	69,956.60
1.5	Përkrahja e fermerëve në blegtori	148,888.00
1.6	Veterina mobile-vaksinimi i gjedheve dhe qenve shtëpiakë, si edhe mbarsim artificial i gjedheve	28,956.00
1.7	Përkrahja e bletarëve në bletari	48,876.00
1.8	Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve me mjedër	91,000.000
1.9	Përkrahja për mbjelljet vjeshtore me grurë	149,560.00
		722,892,00
2.	Aktivitete	
2.1	Këshillime profesionale	
2.2	Realizimi i mbjelljeve pranverore	
2.3	Përcjellja e procesit të korrje-shirje	
2.4	Realizimi i mbjelljeve vjeshtore	

Subvencionet në fushën e bujqësisë

Përkrahja e fermerëve për ujitje të sipërfaqeve bujqësore - Janë përkrahur fermer të cilët kanë kultivuar pemë dhe perime, me hapje të pusit deri në një thellësi prej 25m, si dhe sistem të ujitjes. Janë përkrahur gjithsej 55 fermerë (34 fermerë për hapje të pusit dhe 21 me sistem të ujitjes). Vlera e përkrahjes për një fermer ka qenë në proporcion me sipërfaqet e mbjella me pemë dhe perime.

Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patates - Subvencionimi i fermerëve për mbjelljet pranverore me patate, përfitues gjithsej 35 fermerë, me një sipërfaqe prej 98 ha, sipas kategorive, si më poshtë:

a) Kategoria I	-----	408,00€ (1ha patate)
b) Kategoria II	-----	612,00€ (1.5 ha)
c) Kategoria III	-----	816,00€ (2 ha)
d) Kategoria IV	-----	10200,00€ (2.5 ha)
e) Kategoria V	-----	1,224.00€ (3 ha)
f) Kategoria VI	- -----	1,428.00€ (3.5 ha)
g) Kategoria VII	-----	1,632.00€ (4 ha)
h) Kategoria VIII	-----	1,836.00€ (4.5 ha)
i) Kategoria IX	-----	2,040.00€ (5 ha)

Përkrahja e fermerëve në perimtari-serra - Me qëllim të përkrahjes së fermerëve në perimtari-serra, gjatë muajit maj është bërë thirrja e fermerëve për aplikim, ku kanë aplikuar gjithsej 42 fermerë, ndërsa janë përkrahur gjithsej 15 fermerë.

Fermerët janë përkrahur me nga një serrë, në sipërfaqe prej 500 m², vlera e përkrahjes nga Komuna ka qenë 7,000.00 €, ndërsa fermerët kanë participuar me nga 3,000.00 €.

Përkrahja e fermave në lëmin e shpeshërisë - pula vojse - Janë përkrahur gjithsej 10 ferma komerciale me një numër prej 46.700 pula vojse, me ushqim të koncentruar në sasi prej 250 tonë. Janë përkrahur ato kategori të fermave komerciale që kanë pasur nga 2000 deri 7000 copë pula vojse.

Përkrahja në lëmin e blegtorisë - Janë përkrahur kategoritë e fermerëve që kanë nga 3-10 krerë gjedhe qumështore, kanë përfituar 342 fermerë, me gjithsej 2229 krerë gjedhe qumështore, në vlerë prej 110,584.00 €. Gjithashtu, janë përkrahur fermerët që kanë 20-150 krerë të kafshëve të imëta (dele dhe dhi), kanë përfituar 49 fermerë, me gjithsej 4256 krerë (dele dhe dhi), në vlerë prej 38,304.00 €.

Vaksinimi i gjedheve, qenve shtëpiakë dhe mbarësimi artificial i gjedheve - Janë vaksinuar 5352 krerë gjedhe, 426 qen (copë) në pronësi të pronarit, si dhe janë mbarësuar 1104 krerë gjedhe. Ky projekt është duke vazhduar.

Përkrahja e bletarëve - Janë përkrahur kategoritë e bletarëve që kanë nga 10-30 shoqëri bletësh, kanë përfituar 177 bletarë, me gjithsej 2626 shoqëri bletësh.

Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve me mjedër - Ngritja e pemishteve me pemë të imëta - mjedër (për përfituesit që janë përzgjedhur në vitin 2014), është bërë gjatë muajit prill të vitit 2015, ndërsa gjatë muajve tetor dhe nëntor të këtij viti janë mbjellë sipërfaqe të reja me mjedër. Kanë përfituar gjithsej 35 fermerë për mbjelljen e sipërfaqeve me mjedër prej 0.50 ha për një fermer. Sipërfaqet e përgjithshme të mbjella me mjedër e të përkrahura nga Komuna e Prishtinës, janë 17.5 ha.

Përkrahja e fermerëve për mbjelljet vjeshtore - grurë - Janë subvencionuar fermerët që kanë mbjellë prej 1 deri 2 ha me kulturën e grurit. Kanë përfituar gjithsej 462 fermerë me një sipërfaqe prej 799 ha. Për një hektar të mbjellë fermerët janë përkrahur në vlerë prej 187.00 €

Aktivitetet

Këshillime profesionale të fermerëve

Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe USAID-in, janë realizuar shërbime këshillimore në fusha të ndryshme të bujqësisë, me fokus perimtarinë dhe pemët e imëta, ku janë përfshirë të gjitha kategoritë e fermerëve, si:

- fermerëve ekzistencial,
- fermerëve gjysmë komercial dhe
- fermerëve komercial.

Realizimi i mbjelljeve pranverore

Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2015, në Komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 568.8 ha me kultura pranverore.

Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore/ha:

Nr.	KULTURAT	Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje/ha	Sipërfaqet e mbjella/ha
1	Misër për kokërr	132	141
2	Misër me fasule	35	39
3	Misër i gjelbër	84	106
4	Elb	9.0	11
5	Tërshërë	18	13
7	Bimë foragjere	19	23
8	Bimë industriale	---	---
9	Perime në serra	7.5	8.0
10	Perime në fushë të hapur	5.0	7.8
11	Patate	135	189
12	Fasule monokulturë	27	31
13	Gjithsej	471.5	568.8

Korrje-shirjet 2015

Procesi i korrje-shirjes ka filluar më 11. 07.2015 dhe ka përfunduar më 26.07.2015. Rendimentet mesatare në këtë vit janë 3000 kg/ha. Sipërfaqet e mbjella me drithëra të bardha në komunën e Prishtinës janë gjithsej 1099 ha.

Në territorin e komunës së Prishtinës janë evidentuar gjithsej 47 autokombajna, të cilët kanë qenë të angazhuara në procesin e korrje-shirjeve, mirëpo në funksion të realizimit të korrje-shirjeve janë angazhuar edhe autokombajna të ardhur nga komunat e tjera.

Çmimi për korrje-shirje ka qenë 100 €/ha (pa lidhëse) dhe në disa raste ky çmim ka qenë edhe më i ulët.

Me drithëra të bardha në komunën e Prishtinës (2014-2015) janë mbjell gjithsej 1099 ha.

Grurë 1075 ha,
 Tërshërë..... 11 ha,
 Elb 13 ha.

Realizimi i mbjelljeve vjeshtore

Procesi i mbjelljeve është realizuar sipas planifikimeve dhe kushtet klimatike kanë qenë të volitshme për mbjelljen e kulturave vjeshtore. Furnizimi me farë të grurit dhe plehra minerale ka qenë i mirë, gjithashtu edhe operacionet agro-teknike kanë qenë në nivel të duhur. Në bazë të të dhënave që ne kemi siguruar në këtë vit (2015) me kultura bujqësore, si; grurë, bimë foragjere dhe pemë (kryesisht pemë të imëta-mjedër) janë mbjell si në tabelën e më poshtme:

Nr.	Kultura	Sipërfaqe/ha
1.	Grurë	1128
2.	Bimë foragjere	35
3	Pemë	33
Gjithsej		1196

Shërbimi i pylltarisë

Përveç aktiviteteve të zakonshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, janë realizuar edhe aktivitete tjera me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve rreth rëndësisë për ruajtjen e pyjeve, por është bërë edhe pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat lidhur me sasinë e masës drusore të konfiskuar, fletëparaqitjet, kërkesat për prerje të masës drusore dhe të dhëna të tjera.

Konfiskimet / Gjendja në depo

Nr. rend	Viti	Masa drusore e bartur nga viti 2013.	Konfiskimi i masës drusore ilegale 2015	Gjithsej masa drusore e konfiskuar 2013+2014	Përkrahja e kategorive të ndryshme sociale	Gjendja momentale në depo
1.	2015	00m ³	25.93 m ³	18.53m ³	m ³	25.93 m ³

Kërkesat për prerje në pyje private

Të miratuara 2014		Të pa miratuara		Gjithsejtë kërkesa
Kërkesa	144 copë	3		447copë
Gjithsej m ³	m ³			
Të përcjella me f.përcjellëje	Në proces			

Shitjet e masës drusore në këmb me tender pyje shtetërore

Nr.	Viti	Gjithsej m ³ e shitur	Vlera në €	Gjithsej e përcjellë
1.	2015	1128.19 m ³	22468.28	Në Proces

Të hyrat

	Pyjet private	33,984.16 €	
--	---------------	-------------	--

janar-nëntor	Pyje publike	11,234.12 €	Gjithsej të hyra 1+2 45,218.28€
--------------	--------------	-------------	-------------------------------------------

Fletëparaqitjet për prerësit ilegalë të iniciuara për gjykatat kompetente 2015

Fletëparaqitjet	Sasia	Dëmi	Vlera e dëmit
Penale	122 copë	m ³	€
Kundërvajtjeje	30 copë	m ³	€
Gjithsejtë	152 copë	1218.99m³	120,474.61€

Pyllëzimi

Rep.	Vç	Hektar
Prishtina I	Slivov/Kukavic	10

Prerje fito sanitare - Pastrim

Rep.	Vç	Hektar	m ³
Prishtina I	Gërgaq	10	49
Prishtina II	34- Dubok	5	20
Gjithsej		15	69

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, si qëllim kryesorë për vitin 2015 ka qenë procesi i legalizimit, proces ky i cili ka filluar në shkurt të vitit 2014, me fazën e parë-regjistrimin; ndërsa në shkurt të vitit 2015 ka filluar faza e dytë – aplikimi, e cila zgjat deri në mars të vitit 2016. Gjatë vitit 2015, kujdes i veçantë i është kushtuar përfundimit të lëndëve të vjetra për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë, duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Me miratimin e revidimit të Plani rregullues “Arbëria III”, kanë filluar së trajtuar lëndët e pezulluara. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim ende pa arritur zgjidhjet urbane, andaj është themeluar grupi për zgjidhje urbane që do t’u ndihmojë kërkuessve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë II.


Gjatë këtij viti janë përfunduar lëndët e vjetra me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Për më tepër, vonesa paraqesin procedurat për legjitimimin e marrëveshjeve të ndryshme pronësore si bashkimi i parcelave ose shpronësimi, si dhe ndërrimi i destinimit të tokës, duke mos lënë anash edhe vonesat e palëve për të marrë informimet për plotësim dokumentacioni.

Koha	Leje ndërtimi	Kushte ndërtimi	Pëlqimet	
Janar	2	11		
Shkurt	8	10		
Mars	18	8		
Prill	10	13		
Maj	17	16		
Qershor	22	17		
Korrik	13	14		
Gusht	13	15		
Shtator	17	11		
Tetor	23	12		
Nëntor	6	7		
Dhjetor	9	8		45
Gjithsej	158	142		45

Sektori i urbanizmit

Gjatë vitit 2015, është evidentuar numër i madh i kërkesave dhe intensiteti i punës në sektor ka treguar rritje. Janë evidentuar mbi 1200 kërkesa, prej të cilave 429 kërkesa për leje ndërtimi. Janë trajtuar 393 kërkesa, nga 429 sa janë pranuar. Janë lëshuar 158 leje ndërtimi, nga të cilat 61 ndërtesa të banimit shumëkatëshe dhe 97 ndërtesa individuale. Sikur edhe është paraqitur në tabelë, gjatë këtij viti janë përcaktuar kushte ndërtimi për 142 kërkesa, derisa 45 kërkesa janë përfunduar me pëlqime të ndryshme, si riparime të ndryshme, pëlqime paraprake sa i përket pronës dhe të ngjashme. Numri më i madh i shqyrtimit të lëndëve është shënuar në

muajin qershor, 197 lëndë të trajtuara, që kanë përfunduar me një dokument, derisa në muajin tetor janë lëshuar 23 leje ndërtimi, duke shënuar muajin me më shumë leje ndërtimi të lëshuara.



Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit (Permit tracking System), ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit, duke përfshirë sugjerimet e ekspertit nga projekti i USAID-it, të cilat informata janë përgatitur në formë postierësh dhe do të publikohen në vende të dukshme për informimin sa më të mirë të qytetarëve me procedurat dhe dokumentet e nevojshme për pajisje me leje ndërtimi. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim.

Po ashtu, edhe Zyra për regjenerim urban, e cila është në kuadër të kësaj drejtorie, ka bërë një punë të jashtëzakonshme gjatë vitit 2015, duke theksuar rregullimin e rrugës “Garibaldi”, dekorimin e qytetit për festat e fundvitit, si dhe dizajnin e parkut “Blok pas bloku”, të iniciuar nga UN HABITAT dhe Komuna e Prishtinës.

Një ndër punët më me rëndësi është dhe emërtimi i rrugëve, i udhëhequr nga Sektori i shërbimeve të përbashkëta, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv.

Duhet theksuar se këtë vit është krijuar dhe Zyra për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DUNMM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

- Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;
- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;

- Vlerësimi i lëndëve nga Kolegjiumi, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin GIS;
- Përpunimi i web-faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
- Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
- Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve (Permit Tracking System);
- Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
- Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
- Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
- Takimet-punëtoritë e rregullta me banorët e lagjes “Bregu i Diellit”, po ashtu gjatë muajit dhjetor është prezantuar projekti ideor para banorëve dhe komunitetit të lagjes dhe ky projekt tani më ka arritur në fazën përfundimtare të kompletimit të projektit kryesor - zbatues për parkun në lagjen “Bregu i Diellit” (Mine Craft);
- Gjatë muajit qershor është prezantuar ideja për lëshimin e informatave nga plani – online;
- Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
- Përgatitja e detyrave projektuese;
- Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
- Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
- Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve nga Arkivi i Qytetit, të ndërtuara me leje;
- Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve të ndërtuara pa leje në tërë qytetin e Prishtinës;
- Bartja-inkorporimi i këtyre të dhënave të aplikantëve në sistemin GIS;
- Dizajni i mbështjellësve të lëndës dedikuar vetëm për Sektorin e legalizimit;
- Fillimi i trajtimit të lëndëve të vitit 2010;
- Hartimi i databazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- Fushata informuese dhe sensibilizuese;
- Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
- Legalizimi i objekteve të para;
- Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
- Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
- Vazhdimi i pilot-projektit për ndarjen e mbeturinave në lagjen “Dardania”;
- Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
- Menaxhimi i mbeturinave;
- Përfundimi i detyrës projektuese për fushatë vetëdijesuese;
- Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
- Revidimi i planit lokal për menaxhimin e mbeturinave dhe rregulloret për mbeturina;

- Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
- Mbjellja e drurëve dekorativë;
- Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitetet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPH;
- Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2015, ka qenë udhëheqja e Komisionit për emërtimin e rrugëve publike në komunën e Prishtinës, ku kryesuese e këtij komisioni ka qenë znj. Florina Rrahmani, shefe e Sektorit të shërbimeve të përbashkëta.
- Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

Aktivitetet e implementuara:

- Publikimi i Udhëzuesit për qytetarë;
- Plotësimi i “Permit Tracking System” me lëndët e muajve të parë të vitit;
- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Publikimi i lejeve ndërtimore në web-faqen e Komunës;
- Mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- Publikimi i lejeve të ndërtimit në web-faqen e Komunës;
- Publikimi i informatave për qytetarë në formë të postierëve- Infographics, përkrahur nga UNDP-ja;
- Pjesëmarrje aktive në hartimin e Planit të veprimit për energji të qëndrueshme (PVEQ-SEAP) dhe mbikëqyrjen e zbatimit;
- Nga dt. 21.09.2015, ka filluar implementimi dhe përdorimi i aplikacionit për Aplikim të informatave nga plani Online , nga data e lansimit të këtij sistemi gjithsej aplikacione për informata nga plani, kanë aplikuar 357 qytetarë;
- Është mbajtur punëtorja me qytetarët e lagjes “Bregu i Diellit”, lidhur me projektin e “Mine Craft”, i cili është në bashkinvestim në mes të Komunës së Prishtinës dhe “Un Habitat”;
- Mbikëqyrja e 21 projekteve të porositura nga Komuna e Prishtinës;
- Mbikëqyrja e 35 kontratave të investimeve të Komunës;
- Mbikëqyrja e planeve rregulluese të Komunës (Ndryshimi dhe plotësimi i Planit rregullues “Arbëria 3”);
- Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve nga Arkivi i Qytetit, të ndërtuara me leje;
- Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve të ndërtuara pa leje në tërë qytetin e Prishtinës;
- Bartja-inkorporimi i këtyre të dhënave të aplikuesve në sistemin GIS;
- Futja në përdorim e mbështjellësve të lëndës, dedikuar vetëm për sektorin e legalizimit;
- Trajtimi i lëndëve të aplikuara në vitin 2010, njëkohësisht pranimit dhe trajtimit i aplikimeve të reja dhe procedimi i tyre;

- Implementimi i data-bazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- Shtypja e materialit informues dhe pranimi i tyre (fushata sensibilizuese), siç janë: fletëpalosjet, aromatizuesit, doorhanger, stikersat, panotë në format A0, A1 dhe A2, billboardat;
- Shpërndarja e materialit informues në bazë të planit dinamik, siç janë: fletëpalosjet; aromatizuesit; dooranger; billboardat; panot në formatin A0, A1 dhe A2;
- Realizimi dhe transmetimi i dy videoreklamave sensibilizuese për regjistrim të ndërtimit pa leje dhe për aplikim për legalizim të ndërtimeve pa leje;
- Shpërndarja e kërkesave për regjistrim të protokolluar të ndërtimeve pa leje në zonat rurale, të cilat i kemi regjistruar në terren me iniciativë të Sektorit të legalizimit;
- Pranimi i stafit shtesë në lëmenjtë përkatës për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
- Legalizimi i objekteve të para;
- Gjatë kësaj periudhe janë shtuar afërsisht 30.000 m² hapësirë gjelbëruese;
- Rregullimi i parkut në lagjen “Dardania”, platoja të çerdhja “Lulevera” dhe të biblioteka “Hivzi Sylejmani”, rregullimi i parkut të Fusha e Pajtitimit;
- Mbjellja e 1650 drurëve dekorativë në qytet, po ashtu 1850 të planifikuar për vitet 2015-2016;
- Është implementuar në tërësi emërtimi i rrugëve dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës, ku për një periudhë rreth 7-mujore, pasi që janë mbajtur 50 mbledhje, Komisioni ka propozuar 1491 emërtime dhe 413 propozime për listën rezervë;
- Është implementuar me sukses puna në lidhje me ngritjen profesionale, e cila vërehet edhe tek vendimet e organit të shkallës së dytë, ku janë zvogëluar në masë të madhe shfuqizimet e vendimeve të DUNMM-së;
- Projektpropozimi për shfrytëzimin e Zonës industriale në Prishtinë;
- Hulumtim dhe analiza rreth projekteve të disa bashkësive lokale dhe disa çerdheve;
- Lista e lejeve, kushteve dhe pëlqimeve të lëshuara nga kjo drejtori;
- Projekti zbatues i sheshit “Adem Jashari”;
- Digjitalizimi i procesverbaleve nga takimet e mbajtura me palë dhe zyrtarë, digjitalizimi i të gjitha zgjidhjeve urbane;

Aktivitetet në implementim e sipër:

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
- Po punohet në përmirësimin e sistemit të informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
- Po punohet në funksionalizimin e skemës së re të ristrukturuar të stafit, ashtu që të bëhet e ditur ndarja e përgjegjësisë;
- Po bëhen përgatitjet për funksionalizimin e Kolegjiumit, i cili do të merret me trajtimin e lëndëve që konsiderohen si të komplikuar dhe nevojitet inputi i më shumë zyrtarëve;

- Po punohet në zgjidhje të ndryshme urbane, deri në miratimin e tyre;
- Po vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të lëshuara ndërtimore nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Vazhdimisht janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve;
- Gjatë periudhës shkurt – mars, do të përfundojë hartimin i projektit për parkun në lagjen “Bregu i Diellit” (Minecraft), dhe pas përfundimit të procedurave të prokurimit do të fillojë edhe zbatimi i tij.

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Të hyrat nga lejet e ndërtimit:

Të hyrat e planifikuara	Të hyrat e realizuara	%	Obligimet e mbetura për vitin 2015	Borxhet e përgjithshme	Janë dhënë leje m ²
9,500,000.00	6,567,884.91	69.13	196,242.26	9,311,031.54	520,218.22

Diskutimet publike / takimet me qytetarë:

- Punëtori me qytetarët dhe komunitetin e lagjes “Bregu i Diellit”, lidhur me projektin e parkut për “Minecraft”;
- Diskutim publik me banorët e lagjes “Mati 2”, lidhur me hartimin e Planit rregullues “Mati 2”;
- Diskutim publik me banoret e lagjes “Kalabria”, lidhur me hartimin e Planit rregullues “Kalabria”;
- Punëtori: Planet rregulluese të identifikuara nga komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUNMM). Më sfiduese për implementimit të tyre janë: Prishtina e Re - Zona Perëndim, Mati 1, Qyteza Pejton, Qendra 1 dhe Tophane. Ky proces ka filluar në janar 2015 dhe diskutimet me palë të interesit përfunduan në fund të qershorit 2015. Raporti paraqet punën e përbashkët të të gjitha palëve të interesit të përfshira, si: DUNMM e Komunës Prishtinës, Grupi këshillues i komunitetit (GKK), ekipi i planerëve të projektit “Promovimi i pjesëmarrjes aktive në planifikim hapësinor në nivelin lokal” i implementuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” (CHWB) dhe financuar nga USAID-i dhe qytetarët në përgjithësi. Gjatë kësaj kohe janë përfshirë më shumë se 1500 persona gjatë punës në terren dhe punëtori të ndryshme, të organizuar më qëllim të identifikimit të këtyre problemeve, ku në fund është hartuar raporti nga pjesëmarrja e publikut në identifikimin e problemeve në 5 PRRU në Komunën e Prishtinës.

Punëtori për çështje urbanistike

Janë mbajtur pesë (5) punëtori për identifikimin e problemeve kryesore të planeve rregulluese të lagjeve. Këto punëtori janë mbajtur në kuadër të një projekti të financuar USAID-i dhe e ka implementuar CHëB.

- Qendra 1 dhe 2;
- Mati I;
- Tophane;
- Pejton;
- Prishtina e Re - Zona Perëndim;
- UN Habitat Kosovo: “E-qeverisjen dhe E-pjesëmarrjen për politika më të mira urbane dhe përmirësim të cilësisë së jetës”.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Nr.	Përshkrimi i lëndës	Numri i lëndëve të trajtuara Gjithsej:
1	Aktpërcjellës	156
2	Aktvendim kompensimi (për leje ndërtimi)	
3	Caktim i pikave të ndërtimit	130
4	Caktim i vijës rregulluese	67
5	Dispozita urbanistike	129
	Dërgesë dokumentacioni	
5	Pranime të projekteve për infrastrukturë	
6	Garanci bankare - pagesa për leje	
7	Informime për çështje të ndryshme urbane	105
8	Informime nga Plani (PZhU, PRRU)	621
8	Interpretime ligjore	
9	Kërkesa nga DUNMM nga institucionet tjera	
10	Konkluzione të ndryshme për përmirësim të vendimeve	
11	Konstatime të situacionit	
12	Kushte ndërtimore	142
13	Komisione	26
14	Leje të përkohshme	
15	Leje mjedisore komunale	53
16	Leje ndërtimi - Infrastrukturë	35
17	Leje ndërtimi	158
18	Leje përdorimi	4
19	Leje rrënimi	
20	Njoftime publike	
21	Pëlqime për bashkim të parcelave	65
22	Parcelime	110
23	Pëlqime të ndryshme (mjedisor/renovim/rrethojë)	
24	Pëlqime për infrastrukturë	106
	Kontrollim të projekteve	
23	Plotësime dokumentacioni	904
24	Refuzime	381
25	Renovime	

26	Mbikëqyrje të projekteve	4
26	Ndërrim destinimi	10
27	Tërheqja e lëndës nga pala	
28	Vendime të tjera (pezullim i vendimit)	4
29	Vërtetim për dëme lufte	4
30	Zgjidhje urbane	
31	Numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë	
32	Numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë	
33	Vendim për kompensim	16
34	Konkluzion	13
35	Qasje në dokumente zyrtare	208
36	Kërkesa për kthim të parave	7
37	Legalizime	7
38	Numri i lëndëve në trajtim e sipër	
Gjithsej		3465

DREJTORI E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale (DIL) ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e Komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe paralogarive, si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform kontratave dhe projekteve etj.

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2014, DIL-ja ka proceduar 1102 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formim të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 1102 kërkesave të pranuar, 1101 janë zgjidhur, kurse vetëm një lëndë është bartur për vitin 2016.

Projektet infrastrukturore të vitit 2013-2015 të bartura në vitin 2016:

Nr	Emri i projektit	Punë kryerësi	Vlera e
1.	Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku", faza e dytë	"Ledi Ing" & "Kastrioti"	847,542.44
2.	Rregullimi i shtratit të lumit Prishtina, faza I, segmenti Fusha e Pajtimi	"Rexha" sh.p.k. & N.T.P. "Fidani-L" Sh.p.k.	398,401.78
3	Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekale prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjeve "Arbëria" dhe "Kodra e Trimave"	N. SH,,Dimi Bau & Linda"sh.p.k	384,501.82
4.	Asfaltimi i rrugës në Hajvali	"Bageri" & "Ulpiana"	468,015.78
5.	Ndërtimi i kanalizimit fekal Bardhosh - Prugovc – Barilevë	"Belvedere" & "Idriz Seferi"	108,946.00
6.	Ndërtimi i rrugëve në Mati 1	"Ekskavatori" & "Kema Company"	322,887.75
7.	Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku", pjesa e parë	"Beni-Com"	1187768.19
8	Ndërtimi i rrugës "Naser Hajrizi"	"TOIFOR"	129,873.70
9	Ndërtimi i rrugës "Stanbolli", faza e dytë	Sh.p.k. "Jehona"	649,285.30
10	Ndërtimi i rrugës Llukar-Siqevë	"Drini Company"	341,520.00
11	Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të	"Shkoza"	324,680.00
12	Ndërtimi i rrugës Breznicë - Barilevë	"Sopi" & "Teknika Project"	290,303.60
13	Ndërtimi i rrugës Koliq-Lagjja Peraj,	"Ekskavatori" sh.p.k. Ferizaj	196,936.25

14	Ndërtimi i rrugës "Hasan Remniku", Kolovicë	"Gashi Ing."	186,929.08
15	Ndërtimi i rrugëve në Hajkobillë	"Veha Group" shpk.dhe "Çlirimi"	247,076.00
16	Ndërtimi i rrugës Rimanishtë - Vranidoll	OE "Bageri"	318,073.97
17	Ndërtimi i rrugës Keqekollë - Nishec	"Eskavatori"	342,717.17
18	Ndërtimi i rrugës "Mithat Frashëri"	"Ndërtimi" & "Albakos"	80,286.60
19	Ndërtimi i rrugës Matiqan-Butovc-Kolovicë	"Sopi" & "Teknika Projekt"	486,367.86
20	Ndërtimi i rrugës pranë sistemit të ujitjes "Iber Lepenc", Bërnice e Poshtme	Eskavatori	235,032.10
21	Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq, lagja "Sheqiraj" dhe ndërtimi i rrugës në fshatin Grashticë, lagja "Koprant"	"Drini Company "	248,022.44
22	Ndërtimi i bulevardit mbi "Kurriz"	"Rexha"	977,725.51
23	Rindërtimi, sanimi i kanalizimeve fekale primare dhe	„TOIFOR “	299,716.00
24	Ndërtimi i rrugës Slivovë - Kukaj	"Jehona" sh.p.k.	370,013.15
25	Ndërtimi i rrugës lidhëse me rrugën "Isa Kastrati" në lagjen Mati 1 rruga K3-2	„Beni-Com “	284,573.30
26	Ndërtimi i infrastrukturës në Veternik	"Gërlica Company"	241,008.61
27	Rikonstruktimi i rrugës "Luan Haradinaj"	"Jehona" Sh.p.k.	399,081.50
28	Ndërtimi i rrugës në Hajvali dhe ndërtimi i trotuareve në rrugën "Muharrem Fejza"	"Gashi ING"	195,107.90
29	Rikonstruktimi i rrugës "Garibaldi" & "Perandori Justinjan"	N.N.T "Eing Com"	238,559.30
30	Ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanalizimeve fekale në lagjen "Arbëria"	"Kema Company" & "Eskavatori"	293945.5
31	Zhvendosja e rrjetit kryesor furnizues të Batllavës	"ALFA-I"	158,017.00
32	Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni-Lagja Vakovc	"RSM" sh.p.k.	396,009.34
33	Ndërtimi i infrastrukturës në Sofali dhe kanalizimi fekal në Besi		588,711.15
34	Ndërtimi i urave betonarme në fshatrat e komunës së Prishtinës	"Beni-Com"	157,414.25
35	Ndërtimi i rrugës në fshatin Bardhosh	Vefa&AS ING	57,770.33
36	Ndërtimi i rrugës Barilevë-Besi	"Rexha Benita Arhiko Ing"	965,582.96
37	Ndërtimi i rrugës Dabishevc-Mutivodë, Prishtinë	"Ulpiana"	176,985.82
38	Ndërtimi i disa rrugëve në lagjen "Kolovica"	"Kema Company" & "Eskavatori"	347,023.00
39	Ndërtimi i rrugës paralele me rrugën "B"	"Beni-Construction"	279,939.59

40	Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni në lagjen në Hajvali	"Gerlica Company"	200,002.50
41	Rehabilitimi, planifikimi dhe stabilizimi i dheut nga rrëshqitja në fshatin Siqevë, Prishtinë	"Ledi ING"	163,723.64
42	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen "Kolovica"	"Noti Beton"	71,923.00
43	Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni në Lagjen e Spitalit në Prishtinës	"Kema Company"& "Ekskavtori"	371,966.54
44	Ndërtimi i infrastrukturës në rrugë Çagllavicë - Ibër Lepenc, Prishtinë	"Linda" sh.p.k	144,128.60
45	Ndërtimi i mureve mbrojtëse		170,556.78
46	Ndërtimi i rrugës "Perandori Justinian"	N.N.T "Eing Com"	211,870.40
47	Ndërtimi i disa rrugëve lidhëse me rrugën për Gazimestan	N.N.P. "Sopi"	172,395.70

Projektet infrastrukturore të vitit 2015 të përfunduara:

Nr	Emri i projektit	Punë kryerësi	Vlera kontraktuar
1.	Ndërtimi i rrugës te parku në lagjen " Arbëria "	Sh.p.k. "Jehona"	241,791.04
2.	Mbulimi i Xhamisë së Çarshisë	"Brezi Kufitar"	2,976.00
3	Ndërtimi i kanalizimit fekal ne rrugën "Mbretëresha Teutë	"Vefa" & "AS ING"	54,889.30
4.	Ndërtimi i rrugës "Basri Canolli"	"ATC COM"	50,854.50
5.	Ndërtimi i rrugës "Gallapi", Prishtinë	"Beni Com"	167222.5
6.	Ndërtimi i rrugës "Xheladin Kurbaliu", Prishtinë	"Euro Famis"	74,939.90
7.	Ndërtimi i rrugës "Esat Mekuli"	OE"Veha Group" & "Clirimi"	86,866.10
8.	Ndërtimi i rrugës prej rrugës së Mramorit deri te Pylli i Ariut-Badovc	"Bejta Commerce" & "Bass Com"	338,301.19
9.	Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të lagjes "Kalabria"	"Kema Company" & "Ekskavtori"	144,995.20
10.	Rregullimi i pllato së pranë çerdhes së fëmijëve "Lulevera" në lagjen "Dardania"	"Kapital" & "Arian Co"	97,603.00
11.	Ndërtimi i rrugës Bernicë e Poshtme - M2	NPSH "Bageri"	296,067.72
12.	Ndërtimi i rrugës Koliq-Lagja Peraj, Prishtinë	"Ekskavatori" sh.p.k. Ferizaj	196,936.25
13	Rregullimi i parkut në lagjen "Dardania"	"Beli" & "Elektrostublla"	89,999.08
14	Ndërtimi i infrastrukturës në Lagjen e Ramabajëve Hajvali	"Gërlica Company"	36,003.64

15	Ndërtimi i rrugës Koliq – Keqekollë	“Ledi Ing”	254,166.25
16	Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Vranidoll dhe Prugoc	“Kushtrimi NM”	142,999.99
17	Ndërtimi i rrugës lokale në lagjen “Sylaj”, Busi dhe fshati Mramor.	“Veha Group” & “Çlirimi”	56911.45
18	Ndërtimi i murit mbrojtës në Rimanishtë me gjatësi L=110m	“Delta ING”	58,264.92
19	Ndërtimi i rrugës Sharban Koliq”	“Sopi” & “Teknika Projekt”	
20	Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq- Lagja e Bushovitëve	“Papenburg” & “Adriani”	157,806.28
21	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Llumnicë dhe Barilevë	“Muratori”	36,478.80
22	Ndërtimi i parkingjeve dhe trotuareve në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”	“Co Ing”	19,108.80
23	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Prugoc	“Papenburg” & “Adriani Company”	163,722.61

Vëllimi financiar

Në vitin 2015, vlera kontraktuese e punimeve ishte:	17 017 249.48 €
Shuma e mjeteve të realizuara nga projektet e viteve 2013-2014:	2 165 811.63 €
Shuma e mjeteve të realizuara nga projektet e vitit 2015:	8 848 017.38 €
Shuma e mjeteve të realizuar arrin vlerën, gjithsej:	11 047 017.38 €

Vëllimi fizik i rrugëve të ndërtuara gjatë viteve 2014-2015:

Vëllimi fizik i rrugëve të ndërtuara në vitin 2014

Asfalti në rrugët urbane :	88129,34m ²	17,62 km
Asfalti në rrugët rurale :	169526,86m ²	33,90 km

Vëllimi fizik i rrugëve të ndërtuara në vitin 2015

Asfalti në rrugët urbane :	18,82 km
Asfalti në rrugët rurale :	37.08 km

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Sektori i kulturës

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga drejtoria dhe Komuna.

- Janë dorëzuar të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e aplikacionit Online për subvencione në Sektorin e kulturës. Me jetësimin e këtij aplikacioni, palët kanë pasur mundësi të shkarkojnë udhëzuesin, si dhe formën e buxhetit të planifikuar për realizim të projektit;
- Në kalendarin kulturor në vazhdimësi regjistrohen aktivitetet e organizuara nga Komuna e Prishtinës dhe aktivitete për të cilat njoftohemi përmes shkresave dhe njoftimeve në media;
- Është ndryshuar Këshilli Drejtues në Teatrin e Qytetit të Prishtinës;
- Është nënshkruar Marrëveshja e mirëkuptimit mes Komunës së Prishtinës dhe organizatës “Save the Children” lidhur me rithemelimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve të Prishtinës, e cila funksionon si mekanizëm për promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Aktivitetet e implementuara:

- Më 21 janar, me rastin e Ditës së Arkivit, në hapësirat e Arkivit Komunal të Prishtinës është hapur ekspozita me disa nga materialet arkivore të këtij institucioni;
- Më 17 shkurt, Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës organizoi manifestim solemn për fëmijë, i mbajtur në Sallën e Kuqe, Pallati i Rinisë;
- Më 7 dhe 8 mars, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, u realizua aktiviteti me program artistik dhe u bë shpërndarja e mirënjohjeve nga Drejtoria e Arsimit për 10 mësimdhënëse veterane, për kontributin e dhënë në arsim;
- Më 18 prill, përveç vizitave zyrtare të varrezat e dëshmorëve, Komuna e Prishtinës organizoi Akademinë përkujtimore për dëshmorët e komunës së Prishtinës;
- Më 23 prill, në Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtave të Autorit, kishte aktivitete të organizuara nga OJQ “Art Polis”, në bashkëpunim me bibliotekën “Hivzi Sulejmani” dhe botues të tjerë, duke mbajtur panairin e librit, ku kalimtarët e rastit përveç që mund të blinin libra me çmime më të ulëta, gjithashtu edhe mund të anëtarësoheshin pa pagesë në bibliotekën “Hivzi Sulejmani”;
- Më 15 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Familjes, QKF në bashkëpunim me znj. Lindita Hajdari, organizuan debatin, i cili u mbajt në Qendrën Informativë dhe Kulturore të UE-së;
- Më 23 maj, është organizuar manifestimi për shënimin e vendosjes së shtatores së Ismail Qemalit në oborrin e ish - Rilindjes. Për këtë aktivitet janë angazhuar Shoqata kulturore “Rexho Mulliqi” dhe Kori i filarmonisë për interpretim të këngëve të ndryshme;

- Më 31 maj dhe 1 qershor, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, është realizuar projekti “Prishtina lexon”. Në disa pika të vendosura përgjatë sheshit “Nëna Terezë” janë krijuar grupe, ku personalitete publike kanë lexuar pjesë nga përrallat bashkëkohore për fëmijët pjesëmarrës. Gjithashtu, të pranishmit kanë pasur mundësi të blejnë libra dhe të regjistrohen pa pagesë në bibliotekën “Hivzi Sulejmai”;
- Më 11 qershor, me rastin e Ditës së Prishtinës u organizua koncerti i mbrëmjes me interpretues vendorë, si: Lovers, Arti dhe Labi dhe Gipsy Groove, Gillespie dhe DJ Labinot Spanca. Koncerti ka filluar në orën 20:30 dhe ka përfunduar në 23:50;
- Më 15 qershor, janë krijuar kushtet optimale për vendosja e skulpturës së Nallës në Parkun e qytetit. Të pranishëm gjatë vendosjes ishte autori i veprës, Lila Skaveli nga projekti “Culture for All” dhe zyrtarë nga DKRS-ja.
- Më 21 qershor, me rastin e Ditës së Muzikës, në 4 pika të qytetit u vendosën binat dhe pajisjet teknologjike për interpretimin e artistëve dhe muzikantëve të zhanreve të ndryshme. Në njërin nga këto pika interpretuesit ishin angazhuar nga Ambasada franceze dhe Aleanca franceze në Prishtinë, gjersa në pikat tjera interpretuesit vendorë u ftuan për pjesëmarrje nga DKRS-ja;
- Më 2 gusht, koncerte verore, në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës;
- Më 23-26 shtator, teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”, në patronatin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ka organizuar edicionin V të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove të Kukullave;
- Më 11-13 shtator, Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës për herët XIV ka organizuar Festivalin Ndërkombëtarë të Këngës dhe Valleve për Fëmijë “Ylberi i Prishtinës”;
- Më 9 dhe 10 tetor, Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Fondacionit “INTERARTS” (projekt në kuadër të "Culture for All - Faza III" të Programit të BE-së, implementuar nga “INTERARTS”) ka realizuar projektin “Prishtina Open Music Night”, dy ditë me koncerte me muzikë të gjallë;
- Më 5 tetor, me rastin e **Muajit Ndërkombëtarë të Luftës kundër Kancerit të Gjirit**, në bashkëpunim me NJDNJ dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, u organizua aktiviteti , ku iu mundësua rasteve sociale të komunës së Prishtinës ta bëjnë kontrollin mjekësor të gjirit (mamografisë) pa pagesë . Rastet janë identifikuar nga Qendra për Pune Sociale dhe është bërë shpërndarja e fletëpalosjeve si fushatë informuese, ndërsa Qendra e Mjekësisë Familjare ka ofruar kontrollin;
- Më 17 tetor, realizimi i aktivitetit “Ecje për shërim”, DKRS-ja në bashkëpunim me OJQ-në “Jeta –Vita” dhe Presidencën e Republikës së Kosovës, në pjesëmarrje të Presidentes së Kosovës, përfaqësuesve nga Komuna e Prishtinës dhe qytetarëve të shumtë. Gjatë aktivitetit u mbajt edhe një program artistik, pastaj filloi ecja;
- Më 10 tetor, shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Shëndetit Mendor, realizuar në bashkëpunim me OJQ “Klubi Dëshira”, me Grupin e Grave të Komunës së Prishtinës dhe DKRS-në, me ç ‘rast u organizua vizita në klubin “Dëshira” dhe u realizua programi artistik me muzikë të gjallë në kitarë;
- Më 28 nëntori, me rastin e Ditës së Flamurit, është planifikuar manifestim muzikor me artistë të zhanreve të ndryshme, i cili për shkak të rrethanave të njohura është anuluar;

- Më 5 dhjetor, realizimi i aktivitetit të përbashkët t NJDNJ-së, DKRS dhe Drejtorisë së Shëndetësisë me “UN Women” për realizimin e projektit “16 ditë të aktivizimit” në kuadër të së cilit u organizua ekspozita e fotografive në sheshin “Zahir Pajaziti”, ku një grup i vajzave dhe djemve kanë fotografuar heronjtë dhe heroinat e tyre të përditshme të barazisë gjinore, si dhe është bërë shpërndarja e fletushkave nga vullnetarët e komunës së Prishtinës;
- Gjatë muajit dhjetor, dekorimi i qytetit me rastin e festave të fundvitit.

Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese:

- Nga buxheti i planifikuar për periudhën raportuese janar – qershor 2015, janë shpenzuar kryesisht mjetet për organizime e manifestimeve kulturore dhe shënimin e datave me rëndësi historike dhe kulturore;
- Gjithashtu, është iniciuar projekti për renovimin e degëve të bibliotekës “Hivzi Sulejmani” dhe ndërtimin e hapësirës shtesë në Arkivin Komunal;
- Janë shpenzuar afro 200 mijë euro, në mbështetjen e kërkesave për subvencionim në fazën e parë;
- Furnizimi i bibliotekës “Hivzi Sulejmani” me tituj të rinj;
- Vlerësimi i dëmeve të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes dhe riparimi i të njëjtit në ndërtesën e re të bibliotekës “Hivzi Sulejmani”;
- Furnizimi me shtëpiza për tregun dimëror;
- Dekorimi i qyteti me rastin e festave të fundvitit;
- Furnizimi me material ndërtimor për bulevardin mbi Kurriz.

Diskutime publike / takimet me qytetarë:

- Pjesëmarrje në “Community Design Symposium” Youth and the New urban Agenda – AUK;
- Pjesëmarrje në tryezën e organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit me akterët relevantë në fushën e turizmit;
- Tryezë diskutimi për filmin si instrument i diplomacisë kulturore - Qendra Informativë dhe Kulturore e BE- së;
- Pjesëmarrje në konferencën “Fëmijët dhe obligimet e shtetit ndaj tyre”. Konferenca është mbajtur në hotelin “Victory” dhe u organizua nga “Save the Children” dhe OJQ “Syri i Vizionit” ku u diskutua për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe zëri i tyre në vendimmarrje, si dhe angazhimi i institucioneve të tjera në mbrojtjen e fëmijëve.
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët, e cila është organizuar nga “Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë” në kuadër të kampanjës “Autizmi dhe talentët” në bashkëpunim me Ambasadën austriake.
- Pjesëmarrje në aksionin vullnetar “Dhuro gjak, shpëto jetë”, të organizuar nga Grupi i Grave Asamblistë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me NJDNJ-në me rastin e shënimit të Ditës së Infermierisë;

- Pjesëmarrje në ceremoninë e shpërndarjes së mirënjohjeve për infermierët për kontributin jetësorë, që u organizua nga Grupi i Grave të Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë. Me këtë rast u ndanë 14 mirënjohje për infermieret e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në moshën mbi 70 vjeç,
- Pjesëmarrje në diskutimin publik të Projekudhëzimit administrativ “Regjistrimi i pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve”, organizuar nga Zyra e Kryeministrit – Agjencia për Barazi Gjinore, në mbështetje nga USAID/Programi për të Drejtat Pronësore dhe GIZ/ Projekti “Menaxhimi i pronës dhe kadastrit”;
- Pjesëmarrje në fokus-grupin “Si të matet kultura”, fokus-grup në kuadër të projektit “Forumi për zhvillim kulturor”;
- Pjesëmarrje në takimin publik për shqyrtimin e propozimbuxhetit për vitin 2016 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Në fazën e parë janë pranuar mbi 215 kërkesa për subvencionim, të cilat tejkalojnë shumën 1 milion euro. Janë përkrahur në fazën e parë gjithsej 110 kërkesa;
- Në fazën e dytë kanë arritur gjithsej 159 kërkesa, që janë në proces të shqyrtimit nga Komisioni për përzgjedhjen e projekteve.

Sektori i rinisë dhe sportit

Sektori i rinisë dhe sportit gjatë vitit 2015, ka punuar dhe zhvilluar takime të ndryshme me përfaqësues të sportit dhe përfaqësues të OJQ-ve rinore, ku janë diskutuar çështje të ndryshme.

Gjatë vitit 2015 janë realizuar kërkesat nga klubet sportive për regjistrim në regjistrin e klubeve në Sektorin e sportit, gjithnjë në përputhje me kriteret për regjistrim që mban DKRS-ja. Numri i klubeve sportive që janë regjistruar 7 (shtatë): klubi i parkourit “Atom3run”, klubi i karatesë “Kampioni”, klubi i pingpongut “Dodona”, klubi i shahut “Dardania”, klubi i qitjes sportive “Trigger”, klubi i xhudos “Prishtina” dhe AS Peshku “Prishtina”.

Sektori i Sportit si çdo vit, ka bërë mbledhjen e informatave të klubeve sportive të kryeqytetit, përmes një formulari, me pyetje të përgjithshme. Plotësimi i formularëve të sportit komunal nga ana e klubeve sportive publike, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e klubeve sportive në këtë sektor, është obligues, pasi që qëllimi i plotësimit të tij nga ana e tyre është që të njihemi me gjendjen aktuale të klubit, duke përfshirë informata të përgjithshme të klubit. Me mbledhjen e këtyre informatave, sektori arrin të bëjë një selektim të klubeve sportive publike të përgjegjshme dhe të atyre të papërgjegjshme apo jo aktive, ku sipas këtyre statistikave kemi arritur që t’i evidentojmë 20 klube jo aktive.

Komuna e Prishtinës në dhjetor të vitit 2014, ka nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit me Komitetin Olimpik të Kosovës, me qëllim të mbështetjes së Ekipit Kombëtar Olimpik të Kosovës për rritjen e performancës së sportistëve dhe paraqitjes së dinjitetshme të tyre në

Lojërat evropiane “Baku 2015” dhe “LO Rio 2016”, ku në mesin e sportistëve të përzgjedhur janë edhe dy notarët e komunës së Prishtinës Lum Zhaveli dhe Rita Zeqiri. DKRS në bazë të kësaj marrëveshje, ka përkrahur financiarisht këta dy sportistë nga muaji gusht i vitit 2015 dhe vazhdon deri në muajin korrik 2016, me shumë prej 166,66 USD në bazë mujore (gjithsej për 20 muaj).

Gjatë vitit 2015 janë organizuar takime nga DKRS-ja, përkatësisht nga Sektori i rinisë dhe sportit, me anëtarët e komisionit, të angazhuar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e subvencioneve në fushën e rinisë dhe sportit, gjegjësisht kanë qenë tri faza të përkrahjes, bazuar në kërkesat dhe nevojat e shumta të klubeve sportive dhe OJQ-ve rinore për zhvillimin e aktiviteteve, si dhe realizimin e projekteve të tyre në përgjithësi.

Duke filluar nga ky vit, të gjitha klubet sportive që janë të regjistruara në regjistrin që mban Sektori i sportit, do të përkrahen financiarisht me një shumë vjetore, ku vlera e saj është përcaktuar në bazë të rezultateve dhe sukseseve që tregojnë klubet sportive.

Aktivitetet e implementuara:

- “Pajisja me rekuizita sportive e klubeve, shkollave dhe institucioneve sportive”, është njëri ndër projektet kapitale të DKRS, në të cilin janë përfshirë katër loto, ku në secilën nga to përfshihen pajisje të sporteve të ndryshme që veprojnë në komunën e Prishtinës. Dy prej këtyre lotove janë tenderuar me sukses, ku dorëzimi i këtyre pajisjeve sportive nga Komuna e Prishtinës drejt klubeve sportive përfituese, është bërë në fund të muajit korrik 2015, si dhe ka vazhduar edhe gjatë muajit gusht të këtij viti. Furnizimi i klubeve sportive me pajisje sportive ka ndikuar në ngritjen e cilësisë, zhvillimin dhe masivizimin e sportit në përgjithësi. Dy lolot të tjera do të ritenderohen në muajt në vazhdim;
- Në muajin qershor të viti 2015, pikërisht në hapjen e sezonit veror të Pishinës së Gërmisë, është finalizuar projekti “Rindërtimi i pishinës së Gërmisë”;
- Me rastin e **21 Marsit, Ditës së Pranverës**, Sektori i Rinisë dhe Sportit organizoi aktivitet për pastrimin dhe mbjelljen e luleve në parkun e lagjes “Dardania”. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me ndërmarrjen “Hortikultura”, e cila siguroi lulet dhe pajisjet tjera të nevojshme. Me këtë rast, rreth 17 të rinjë mbollën lule me asistencën e përfaqësuesve të ndërmarrjes “Hortikultura”. Aktiviteti u mirëprit nga banorët e lagjes “Dardania”, të cilët shprehën falënderimin ndaj Komunës së Prishtinës për gjelbërimin e hapësirave publike;
- Në patronatin e Komunës së Prishtinës dhe organizuar nga klubi i shahut “Prishtina”, është mbajtur “Turneu tradicional mbarëkombëtar në shah “**Memoriali Mesut Gashi 2015**”, në të cilin pjesëmarrës ishin shahistë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Presheva. Ky turne u mbajtur më 6 prill 2015;
- Me rastin e **23 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit**, Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Sektori i rinisë, në bashkëpunim me bibliotekën “Hivzi Sylejmani”, organizuan “Takim poetik” me poetë dhe nxënës të shkollave të mesme të Prishtinës. Aktiviteti u mbajtur në sallën e leximit në bibliotekën “Hivzi Sylejmani”;
- Më 10 maj, në Prishtinë është mbajtur për të pesëmbëdhjetën herë Gjysmë maratona ndërkombëtare “Prishtina 2015”. Me moton "Vrapo për paqe dhe tolerancë", ky

aktivitet mblodhi rreth 1400 atletë nga e gjithë bota. Kjo është gjysmëmaratona e parë e organizuar nga Federata e Atletikës së Kosovës që nga pranimit i saj në Federatën Ndërkombëtare të Atletikës. Komuna e Prishtinës vazhdon ta mbështesë këtë ngjarje të madhe sportive me karakter ndërkombëtar;

- Më 11 qershor, për nder të **Ditës së Çlirimit të Prishtinës**, u mbajt turneu në basketboll dhe futboll, me shkollat fillore dhe të mesme të kryeqytetit. Ky aktivitet sportiv i organizuar nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sporteve, në mbështetje të Komunës së Prishtinës, ka për qëllim krijimin e ligave të shkollave dhe natyrisht të jetë tradicional. Pjesëmarrës në këtë turne ishin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të kryeqytetit;
- Në korrik të këtij viti është përkrahur Kampi “Zbulo kopshtin tënd”, organizuar nga OJQ “Toka”, i cili është mbajtur në Parkun e Gërmisë, konkretisht në shtëpizat e Qendrës Rekreative. Mbajtja e këtij kampi ka pasur për qëllim socializmin e të rinjve të lagjeve të ndryshme të kryeqytetit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme edukative /rekreative.
- Më 12 gushtit, me rastin e **Ditës Ndërkombëtare të Rinisë**, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Sektori i rinisë, organizoi një sërë aktivitete të ndryshme, të cilat u mbajtën në Pishinën e Gërmisë dhe në Parkun e Gërmisë. Aktivitetet ishin të ndryshme, si p.sh. kalimi i çiklistëve/ paralajmërimi i fillimit të aktiviteteve të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, caktimi i grupeve të gjakut, matja e nivelit të sheqerit dhe presionit të gjakut, Aktivitete akrobatike të parkour, shigjetari, shah, karate, pikturë, vaterpol dhe shumë aktivitete të tjera.
- Më 30 shtator, në Prishtinë është mbajtur aktiviteti rinor **“Ditët e rinisë 2015”**, për të pesëmbëdhjetën herë me radhë, me moton “Rini merr pjesë edhe Ti”, ngjarje kjo e cila organizohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me MKRS – Departamenti i Rinisë. U zhvilluan aktivitete të ndryshme rinore, kulturore dhe sportive me të rinjtë e kryeqytetit në sheshet “Zahir Pajaziti”, “Nënë Tereza” dhe “Skënderbeu”, ku e gjithë kjo ngjarje e madhe rinore u përmyll me një koncert me grupe muzikore të të rinjve. E veçanta e këtij manifestimi tradicional kushtuar Ditëve të Rinisë, me moton “Rini merr pjesë edhe Ti”, Muzeu i Kosovës organizoi takim prezantues të aktiviteteve të muajit shtator. Më këtë rast, dy nxënëse nga Komuna e Prishtinës u shpërblyen me mirënjohje: Qëndresa Aliu, nga shkolla “Dr. Ali Sokoli” për esenë me të mirë dhe Rinesa Rafuna, nga shkolla “Dardania”, për rezultatin më të mirë në kuiz. Po ashtu, Muzeu i Kosovës ndau falënderim për Komunën e Prishtinës për bashkëpunimin e treguar gjatë implementimit të aktiviteteve të Ditëve të Rinisë, me moton “Rini merr pjesë edhe ti”;
- Turneu i mini-basketbollit, organizuar nga Shoqata e Mini-basketbollit të Kosovës, i mbajtur me **28 nëntor**, për nder të Ditës së Flamurit, përkrahur financiarisht nga DKRS, Sektori i rinisë dhe Sportit;
- Në fund të muajit dhjetor është mbajtur ngjarja e madhe sportive manifestimi **“Sportisti i vitit 2015”**, ku është bërë përzgjedhja e sportistëve që kanë treguar rezultate dhe suksese gjatë vitit 2015. Njëherësh janë shpërblyer edhe kategori të tjera, si: “Shpresat e sportit”, “Traineri i vitit”, “Gjyqtari i vitit”, “Klubi më i suksesshëm”, “Punëtori sportiv” si dhe ‘Pedagogu i kulturës fizike dhe sportit’ në nivel fillor dhe atë të mesëm.

- **Turneu memorial i shahut “Hyzri Talla”**, tradicionalisht organizohet nga klubi i shahut “Prishtina” dhe mbahet nën patronatin e Komunës së Prishtinës. Ky turne u mbajt në muajin dhjetor të vitit 2015, ku pjesëmarrës ishin shahistë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Aktivitetet në implementim e sipër:

- Në fund të vitit 2015, është bërë ritenderimi i projektit kapital për ndërtimin e këndeve të lodrave për fëmijë në lagjet: “Dardania”, “Kodra e Diellit”, “Kodra e Trimave” dhe “Kalabria”, që pritet të realizohen në fillim të vitit 2016.
- Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Sektori i Rinisë dhe Sportit, ka iniciuar procedurat për hartimin e Planit të veprimit rinor lokal 2016-2018. Në vazhden e agjendës së punës rreth këtij plani, është planifikuar të organizohet punëtorja triditore me OJQ-të anëtare të KVRL-së dhe me Këshillin e nxënësive të Komunës së Prishtinës. Punëtorja do të mbahet më 25-26-27 janar 2016.
- Projekti kapital “Fusha e futbollit në Hajvali”, i bashkëfinancuar nga MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), pritet të finalizohet në vitin 2016.

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese 2015:

- Shuma e ndarë për subvencione për projektet e Sektorit të Rinisë dhe Sportit për vitin 2015, ka qenë gjithsej **250,000 €**, ku prej tyre janë shpenzuar:
 - a) Projekte në sport 54,217 €,
 - b) Projekte për rini 59,926€
 - c) Subvencione në sport 135,100 €.
- Shuma e përgjithshme e tri pikave të lartpërmendura është **249,243 €**, nga kjo del që prej vlerës së përgjithshme prej 250,000 €, kanë mbetur pa u shfrytëzuar vetëm 757 €.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Gjatë vitit 2015 janë pranuar gjithsej 271 kërkesa / projektpropozime të ndryshme, gjithsej 121 projekte / kërkesa janë përkrahur/subvencionuar, ku prej tyre 90 janë kërkesa nga klubet sportive, ndërsa 31 prej tyre janë nga OJQ-të rinore. Pjesa tjetër e kërkesave kanë qenë kryesisht refuzime dhe përgjigje në kërkesa të ndryshme (si letër-rekomandime, pëlqime etj.).

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHPËTIMIT

Punët të cilat kanë vazhduar të mbikëqyren nga viti i kaluar janë:

- Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitet 2015-2016, në 3 loto;
- Zgjerimi i ndriçimit publik për vitet 2015-2016;
- Mirëmbajtja se fontanave;
- Mirëmbajtja e semaforëve;
- Ndërtimi i semaforëve dhe radarëve statikë në afërsi të shkollave;
- Montimi i shtyllave antiparkim në trotuare dhe sipërfaqe gjelbëruese;
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale për sezonin veror-dimëror, në 8 loto;
- Trajtimi i qenve endacakë;
- Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre sipas planit dinamik, krasitja dhe prerja e drurëve që paraqesin rrezik;
- Përgatitja e paramasave për projektet e proceduara për tenderim;
- Hartimi i programit të punës së KKS-së për vitin 2015 dhe njoftimi i anëtarëve me këtë program pune;
- Azhurnimi i vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Prishtinës për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
- Organizimi i kujdestarisë 24 orë pa ndërpre në Qendrën për Informim, Alarmim dhe Koordinim;
- Kontrollimi i radiolidhjeve nëpër bashkësitë lokale në zonat rurale;
- Mbajtja e evidencës të hyrje-daljeve të punonjësve të Komunës në punë;
- Përgatitja e raporteve mujore;
- Inventarizimi i parkingjeve në disa lagje, rregullimi i komunikacionit në disa pjesë, trajtimi i hapësirave për këmbësorë;
- Analizat në kuadër të sigurisë në rrugë në afërsi të shkollave dhe Institucioneve;
- Kontrolli i bartjes së mbeturinave nga ana e ndërmarrjes “Pastrimi”;
- Rregullimi i parkut të Gërmisë;
- Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve dhe pajisje të tjera për siguri në komunikacion në Prishtinë për vitin 2015;
- Shpimi i puseve dhe montimi i pompave për puse në qytetin e Prishtinës, shprehur në njësi;
- Pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik nga puseta në pusetë;
- Rregullimi i vendeve për kontejnerë nëntokësorë;
- Adoptimi i kamionëve për kontejnerë nëntokësorë;
- Rrethimi i varrezave dhe pastrimi fitosanitar në Kolovicën e Vjetër;
- Rrethimi i varrezave dhe pastrimi fitosanitar në fshatra të Prishtinës;
- Mbjellja e fidanëve në hapësirat e qytetit dhe parqe, pjesa e parë;
- Mbjellja e fidanëve në hapësirat e qytetit dhe parqe, pjesa e dytë për vjeshtë;
- Riparimi i ashensorëve në ndërtesat e qytetit të Prishtinës;

- Furnizimi dhe montimi i shtyllave antiparkim dhe rrethojave për mbrojtjen gjelbërimit;
- Rikonstruktimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik, faza II, për vitin 2015;
- Pastrimi i mbetjeve ndërtimore;
- Furnizimi me drurë dekorativë, pjesa e parë;
- Furnizimi i shtëpizave për tregun dimëror;
- Furnizimi me kontejnerë 1.1 m³;
- Furnizimi me shporta për mbeturina në shkolla.

Aktivitetet e implementuara

Sektori i shërbimeve publike është përqendruar në shërbimet përkatëse që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e projektit të sinjalizimit në rrugët e qytetit, ka vazhduar mirëmbajtja dimërore sipas afatit sezonal është mbikëqyrë puna në parkingun Zona industriale dhe puna e kompanive rimorkiuese (Shërbimi me merimangë), menaxhimi i tregut të veturave, mbikëqyrja e Parkut Gërmia, menaxhimi i punëve me rastin e vërshimeve dhe shumë punë të tjera shërbyese në bazë të kërkesave dhe nevojave të ndryshme. Po ashtu, pranimit, shqyrtimit dhe përgjigjet në lëndët e ndryshme nga qytetarët, bizneset dhe organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve, trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik dhe pusëve

Nga 1 prilli ka filluar mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve, të cilat janë kontrata kornizë në tri loto, për të cilat është bërë vazhdimi i kontratave dimërore deri në përzgjedhjen e kontraktuesve sipas procedurës së prokurimit, të cilat janë në procedurë. Në loton e parë punët kryhen nga kompania "Toifor", në loton e dytë punët kryhen nga kompania "Zahiri", kurse loton e tretë e mbulon NK "Hortikultura" SHA.

Nga 15 maji janë kontraktuar katër kompani për mirëmbajtje verore të rrugëve, trotuareve dhe shesheve ("Zahiri", loton e parë, "VZ Compani" loton e dytë, "Toifor" loton e tretë dhe "Pastrimi" loton e katërt).

Më 17 nëntor janë kontraktuar gjashtë kompani për mirëmbajtje dimërore të rrugëve, trotuareve dhe shesheve në zonën urbane (loton e parë "Dardania", loton e dytë "Toifor", loton e tretë "VZ Compani", loton e katërt "Vemor", loton e pestë KRM "Pastrimi" dhe loton e gjashtë "Niti").

Më 17 nëntor janë kontraktuar edhe dy kompani për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në zonën rurale, në loton e parë "VZ Compani", kurse në loton e dytë "Dardanija" (kjo loto është nën ankes).

Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra dhe ndriçimit - Në bazë të kontratës me NK "Hortikultura" nën mbikëqyrjen e zyrtarëve, ka filluar përgatitja e hapësirave gjelbëruese, krasitja, kositja, mbjellja e bimëve sezonale, po ashtu kjo ndërmarrje ka pastruar mbeturinat e të gjitha llojeve nëpër parqe dhe hapësira gjelbëruese në lagje të ndryshme të qytetit.

Ka vazhduar mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e qytetit dhe hapësirat tjera publike, është planifikuar në tri loto, ku janë përfshirë 411 rrugë. Po ashtu, është bërë mirëmbajtja dhe riparimi i semaforëve nga dëmtimet e ndryshme. Shërbimi energjetik ka përcjellë shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe semaforëve.

Menaxhimi i mbeturinave - Për menaxhimin e mbeturinave ka vazhduar bashkëpunimi me GIZ-in, ku është përgatitur projekti për ndarjen e mbeturinave, fillimisht me shkolla dhe institucione, për të vazhduar në lagjet e qytetit. Është përgatitur raporti i VNM-së për pëlqim mjedisor, sipas Ligjit për ndërtimin e deponisë për mbeturinat nga konstruktiv-demolimi, projekti me i nevojshëm dhe më i rëndësishmi për Komunën e Prishtinës.

Trajtimi i qenve endacakë - Sipas kontratës, në vazhdimësi kemi bërë trajtimin e qenve endacakë, deri më tani janë trajtuar mbi 1502 raste. Me qëllim të rritjes së sigurisë, Komuna ka ngritur shkallën e gatishmërisë emergjente për trajtimin e tyre.

Projektet të cilat janë bartur nga viti 2014 për realizim:

Pozicionet buxhetore	Planifikimi	Procedura
Furnizimi dhe montimi i shtyllave antiparkim, rrethojave për mbrojtje të gjelbërimit dhe shtyllave automatike, Loto I	80,000.00	E përfunduar
Furnizimi dhe montimi i shtyllave antiparkim, rrethojave për mbrojtje të gjelbërimit dhe shtyllave automatike, Loto II	120,000.00	E përfunduar
Paramasa për adaptimin e kamionëve për grumbullimin e mbeturinave	70,000.00	E përfunduar
Furnizimi me traktor dhe pajisje shtesë	30,000.00	E përfunduar
Rikonstruktimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në Prishtinë për vitin 2014, Faza -II	150,000.00	E përfunduar
Ndërtimi i parkingut në hyrje të parkut të Gërmisë, LOTO- I	70,000.00	E përfunduar
Furnizimi dhe montimi i kamerave në parkingun e parkut të Gërmisë, LOTO-II	10,000.00	E përfunduar
Kontejnerët nëntokësorë	33,856.60	E Përfunduar
Pastrimi i mbetjeve ndërtimore	110,000.00	Në realizim
Sinjalizimi vertikal dhe horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve	150,157.95	Në përfundim
Rregullimi i parkut të Gërmisë	60,000.00	

		E përfunduar
Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	111,648.20	E përfunduar
Blerja e makinerisë dhe pajisjeve	270,000.00	E përfunduar
Rregullimi i rrethojave dhe pastrimi fitosanitar	90,000.00	E përfunduar

Projektet e vitit 2015:

Nr.	Pozicionet buxhetore	Të planifikuara	Procedura
1.	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës	700,000.00	E përfunduar
2.	Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve dhe pajisje tjera për siguri në komunikacion në Prishtinë, për vitin 2015	120,000.00	E përfunduar
3.	Mirëmbajtja, rregullimi i fontanave krojeve, monumenteve dhe puseve, për vitin 2015	40,000.00	Në realizim
4.	Mirëmbajtja e semaforëve, invertorëve dhe pajimeve akustike për të verbër në qytetin e Prishtinës, për vitin 2015	60,000.00	Në realizim
5.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik të Prishtinës të shprehur në sasi, për vitin 2015	150,000.00	Në realizim
6.	Zgjerimi i ndriçimit publik në fshatra dhe në Prishtinë, për vitin 2015	200,000.00	Në realizim
7.	Shpimi i puseve dhe montimi i pompave për puse në qytetin e Prishtinës, e shprehur në njësi	108,000.00	Në realizim
8.	Mirëmbajtja e puseve në Prishtinë	12,000.00	Në realizim
9.	Pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik nga puseta në pusete	60,821.00	Në realizim

10.	Mirëmbajtja verore e rrugëve rurale	99,000.00	E përfunduar
11.	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve	200,000.00	Në ri tenderim
12.	Rregullimi i vendeve për kontejnerë nëntokësorë	250,000.00	Në ri tenderim
13.	Rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe parqeve të qytetit	700,000.00	Në realizim
14.	Trajtimi i qeneve endacakë	150,000.00	Në realizim
15.	Adoptimi i kamionëve për kontejnerë nëntokësorë	32,400.00	E përfunduar
16.	Rrethimi i varrezave dhe pastrimi fitosanitar në Kolovicë të Vjetër	10,000.00	E përfunduar
17.	Rrethimi i varrezave dhe pastrimi fitosanitar në fshatra të Prishtinës	79,990.00	E përfunduar
18.	Mbjellja e fidanëve në hapësirat e qytetit dhe parqe, pjesa e parë.	54,000.00	E përfunduar
19.	Mbjellja e fidanëve në hapësirat e qytetit dhe parqe, pjesa e dytë për vjeshtë.	76,000.00	E përfunduar
20.	Riparimi i ashensorëve në ndërtesat e qytetit të Prishtinës	120,000.00	Në procedurë
21.	Furnizimi dhe montimi i shtyllave antiparkim dhe rrethojave për mbrojtjen gjelbërimit	200,000.00	E përfunduar
22.	Rikonstruktimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik, faza II, për vitin 2015	200,000.00	Në tenderim
23.	Pastrimi i mbetjeve ndërtimore	110,000.00	E përfunduar
24.	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale	300,000.00	Në realizim
25.	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytet	550,000.00	Në realizim
26.	Furnizimi me bredha për festat e fundvitit në sheshet e qytetit	70,000.00	E përfunduar

27.	Furnizimi me drurë dekorativë, pjesa e I	130,000.00	E përfunduar
28.	Furnizimi i shtëpizave për tregun dimëror	50,000.00	E përfunduar
29.	Furnizimi me shporta për mbeturina në shkolla	45,000	E përfunduar
30.	Furnizimi me kontejner 1.1m ³	95,000	Në realizim

Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit

Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit ka hartuar planin vjetor të punës për vitin 2015 dhe ka përgatitur raportin vjetor të punës për vitin 2014. Zyrtarët e Sektorit aktivitetin e vet e kanë zhvilluar përmes Brigadës profesionale të zjarrfikësve (BPZ), Qendrës për informim, alarmim dhe koordinim (QIAK-u) dhe zyrtarëve të administratës. Gjatë periudhës raportuese janë freskuar me të dhëna të reja: Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Plani për reagim në nivel komune dhe Plani për mbrojtje nga zjarri. Në këtë periudhë është përgatit Rregullorja, Plani vjetor, Dinamika e punës së KKSb-së për vitin 2015, si dhe Raporti vjetor i punës së KKSb-se për vitin 2015.

Pas reshjeve të pandërprera gjatë muajve shkurt-mars, është ftuar komiteti i MSH-së, është propozuar ngritja e shkallës së gatishmërisë emergjente, kemi propozuar komisionin për vlerësimin e dëmeve, ku kemi qenë bartës të këtij komisioni dhe gjatë punës trijavore kemi marrë 123 kërkesa për vlerësimin e dëmeve nga qytetarët. Të gjitha këto familje janë vizituar dhe është bërë vlerësimi i dëmeve në formularët e përgatitur në bazë të kriterëve të aprovuara nga komisioni, kemi punuar edhe raportin për vlerësimin e dëmeve.

Pas ngritjes së shkallës së gatishmërisë emergjente nga kërcënimet e qenve endacakë, është punuar në Plani operativ për trajtimin human të qenve endacakë, si dhe largimin e mbeturinave nga deponitë ilegale.

Është punuar elaborati për trajnime dhe ushtrime praktike me nxënësit e gjimnazit “Xhevdet Doda”, për shkollën e mesme të ulët “Pjetër Bogdani”.

Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit - Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit gjatë kësaj periudhe kanë hartuar 107 raporte zjarri, 120 procesverbale, subjekteve të kontrolluara u janë dhënë 123 masa për eliminimin e dobësive të evidentuara pas kontrollimit, janë lëshuar 52 pëlqime në elaboratin për mbrojtje nga zjarri, janë dhënë 37 konstatime për shpërthimin e zjarrit në objekte të ndryshme.

Inspektorët për mbrojtje dhe shpëtim - Inspektorët për mbrojtje dhe shpëtim, në kuadër të Sektorit të MSH-së, në këtë periudhë kanë vizituar dhe inspektuar rastet emergjente të shkaktuara nga uji në banesat kolektive, ku janë evidentuar 31 objekte të dëmtuara në shkallë

të ndryshme, për të cilat kanë përpiluar procesverbalet dhe u janë shpërndarë pronarëve të dëmtuar; janë vizituar 82 familje, të cilat kanë bërë kërkesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga reshjet gjatë muajve shkurt dhe mars, si dhe dëmtime të ndryshme nga rrjedhja e ujit nga pakujdesia e bashkëpronarëve të banesave kolektive dhe u janë lëshuar atyre konstatimet-njoftimet. Inspektorët për mbrojtje dhe shpëtim në bazë të procesverbaleve të hartuara, kanë urdhëruar 34 subjekte që të hartojnë dokumente përkatëse për vlerësimet e shkallës së rrezikut dhe planet për mbrojtje dhe shpëtim, në afat kohor të paraparë me ligj.

Qendra për informim, alarmim dhe koordinim

Qendra për informim, alarmim dhe koordinim - Si rëndom, organizon kujdestarin 24 orë, ku operatorët kujdestarë të Qendrës marrin dhe japin informata të ndryshme nga qytetarët dhe organet komunale, në raste emergjente gjithëherë është mobile. Gjatë kësaj periudhe kohore Qendra është kujdesur për mirëmbajtjen e monitorëve në Komunë, por është bërë edhe:

- Përgatitja e informatës ditore;
- Përgatitja e raporteve mujore;
- Kontrollimi i kompanisë së sigurimit fizik “Rojet e Nderit” në objekte komunale, sipas nënshkrimit të kontratës në mes të kompanisë “R.N” dhe Kuvendit të Komunës;
- Vëzhgimi, mirëmbajtja dhe kontrollimi i sistemit vizual të kamerave në objektet komunale dhe institucionet komunale (objekti i ri i Komunës, objekti i vjetër i Komunës, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, Laura në hyrje të parkut në Gërmi, shkollat fillore dhe të mesme);
- Kontrollimi dhe servisimi i repetitorit dhe gjashtë pikave ekzistuese të sistemit të alarmimit publik dhe vendosja e tri pikave të reja;
- Zgjerimi i sistemit të alarmimit edhe me katër pika të reja;
- Përgatitja e tenderit për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike në Qendër;
- Përgatitja e tenderit për kamera dhe dorëzimi në prokurim për shkollat: “Zenel Hajdini”, “Nazim Gafurri”, “Emin Duraku”, “Dardania”, “Dr. Ali Sokoli”, “Iliria”, “Naim Frashëri” dhe “Pavarësia”;
- Vendosja e kamerave në Qendrën Rekreative në Gërmi;
- Vendosja e kamerave në objektin e Drejtorisë së Inspektionit dhe Arkivit Komunal;
- Fillimi i montimit të kamerave dhe pajisjeve të tjera teknike në shkolla.
- Gjenerimi i raporteve të sistemit të qasjes në të gjitha drejtorit për çdo ditë;
- Punimi i kartelave për punëtorët e Komunës dhe regjistrimi i tyre në sistemin e qasjes;
- Kontrollimi i sistemeve të radio-lidhjeve, repetitorëve, sistemi i qasjes dhe pajisjeve tjera teknike në terren.
- Gjatë periudhës janar - dhjetor 2015, janë punuar 285 kartela të punëtorëve, personave tjerë zyrtarë komunalë dhe punëtorë të subjekteve komunale.

Rastet e pranuar nga qytetarët dhe subjektet komunale për periudhën janar – dhjetor 2015, gjithsej janë 6125 raste.

Brigada profesionale e zjarrfikësve

Gjatë kësaj periudhe janë kryer punët që janë paraparë sipas planprogramit, duke përfshirë kërkesat, përgatitjen e stafit me trajnime, si dhe punë të ndryshme të brendshme në BPZ.

Në bazë të Planit të trajnimeve, i hartuar nga AME/MPB për vitin 2015, është bërë trajnimi i stafit të BPZ-së si vijon :

Nr	Titulli i trajnimit	Pjesëtarë
1.	Menaxhimi i vijës së dytë	1
2.	Menaxhimi i vijës së parë	2
3.	Përgatitja e kandidatëve për dhënien e provimit profesional në lëmin e mbrojtjes nga zjarri	2

Tre zjarrfikës kanë përfunduar trajnimin “Si të vepohet me materie të rrezikshme”, dy zjarrfikës kanë qenë në trajnimin “Mënyrën e veprimit nga përmbytjet-vërshimet”, është formuar ekipi për kërkim – shpëtim në sipërfaqet e ujit. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi pasur numër të konsiderueshëm të intervenimeve, duke përfshirë intervenime në zjarre , intervenime teknike, shërbime etj. Për sqarim më të mirë japim të dhënat në tabelë, për numrin e intervenimeve në zjarre, si dhe numrin në intervenime teknike, intervenime-shërbime, po ashtu duke përfshirë edhe numrin e zjarrfikësve pjesëmarrës, numrin e automjeteve pjesëmarrëse, numrin e orëve të punës, dhe për persona të lënduar ose të vdekur.

Viti 2015	Dalje	Nr. i zjarreve	Int. teknike	Int. shërbime	Nr. i zj. pjesëmarrës	Nr. i Auto.	Orë pune	Të lënduar		Të vdekur	
								Qy	Zj.	Qy	Zj.
Janar	94	68	22	4	125	134	462:47:00	3	0	0	0
Shkurt	106	56	42	8	429	150	455:26:00	0	0	0	0
Mars	84	58	23	3	335	120	265:20:00	4	0	0	0
Prill	121	99	21	1	459	160	619:10:00	6	0	0	0
Maj	71	55	14	2	284	102	303:01:00	3	0	0	0
Qershor	86	57	16	13	336	116	313:23:00	2	0	0	0
Korrik	310	283	18	9	939	367	956:09:00	3	0	1	0
Gusht	337	292	40	5	943	385	1016:54:00	2	0	4	0
Shtator	224	184	28	12	654	221	726:38:00	0	0	2	0
Tetor	98	56	30	12	416	136	405:56:00	2	0	0	0
Nëntor	94	68	18	8	441	139	360:10:00	9	0	1	0

Dhjetor	85	65	13	7	350	128	319:27:00	7	0	0	0
Gjithsej	1710	1341	285	84	5711	2158	6204:21:00	41	0	8	0

Duke bërë krahasim me numrin e intervenimeve për periudhën e njëjtë të vitit 2014, del se në vitin 2015 kemi 296 intervenime më shumë.

BPZ kryen edhe punë të tjera sipas planprogramit mësimor për vitin 2015, duke përfshirë: ligjërimet (teorike dhe praktike), si dhe punët që kryhen nga ana e stafit të mekanikëve për mirëmbajtjen e automjeteve .

Aktivitetet në implementim e sipër:

- Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitet 2015-2016, në 3 loto;
- Mirëmbajtja e fontanave;
- Mirëmbajtja e semaforëve;
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, në 7 loto;
- Trajtimi i qenve endacakë;
- Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre, krasitja e drurëve dhe prerje e atyre që paraqesin rrezik;
- Mbikëqyrja e projekteve që janë në realizim e sipër;
- Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në mirëmbajtjen e gjelbërimit nga ana e NPK "Hortikultura";
- Vazhdimësia e fazës së fundit të zhvillimit të aktiviteteve në Projektin "Vendosja e shtyllave antiparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit në qytetin e Prishtinës";
- Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Nxënia dhe trajtimi i qenve endacakë në qytetin e Prishtinës";
- Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Mirëmbajtja e puseve dhe pajisjeve";
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve;
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal, pjesa e tretë;
- Riparimi i ashensorëve në ndërtesat e qytetit, faza e gjashtë;
- Furnizimi me shporta të vogla të mbeturinave për objektet shkollore;
- Furnizimi dhe montimi i shtyllave automatike antiparkim;
- Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve;
- Riparimi dhe renovimi i objektit të Brigadës profesionale të zjarrfikësve;
- Zgjerimi i ndriçimit publik;
- Furnizimi me kontejnerë 1.1 dhe shporta 240 litra.

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Për vitin 2015 kanë qenë të planifikuara 4,290,000.00 euro, pa përfshirë kogjenerimin e ngrohtores “Termokos” dhe projektin e ndërtimit të Fabrikës së ujit në Shkabaj (2.000.000,00 euro), nga to janë shpenzuar 3.285.053,08 euro. Nga mjetet e planifikuara janë në realizim edhe 885.453,00 euro.

Pasqyra e të hyrave për periudhën janar - dhjetor 2015:

• Nga parkingjet	84,528.20 €
• Nga shërbimi me “merimangë”	185,634.95 €
• Hapësira publike me kërkesa	19,197.32 €
• Tavolina dimrit	19,532.89 €
• Tavolina verës para lokaleve	324,846.31 €
• Hapësira për shkallë	15,195.00 €
• Reklama	299,702.63 €
• Të hyrat nga laura e Gërmisë dhe Tregu i veturave	282,792.00 €
<u>Gjithsejtë të hyra</u>	1,231,518.67 €

Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare- gjatë këtij viti kanë qenë dy kërkesa për qasje në dokumente zyrtare të cilat janë realizuar.

Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër - janë pranuar 2592 lëndë gjatë këtij viti prej tyre janë realizuar 2498 ndërsa 294 janë në realizim e sipër.

DREJTORIA E KADASTRIT

Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë vitit 2015, në 5 zyrat pritëse janë pranuar gjithsejtë **31,498** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **31,277** kërkesa, janë refuzuar **105** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **116** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

Aktivitetet e implementuara dhe aktivitetet që janë në implementim e sipër

Gjatë vitit 2015, përmes zyrave pritëse dhe dy sektorëve, Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme.

Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 3,591 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 3,457 kërkesa, janë refuzuar 102 kërkesa, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 32 konkluzione, duke e pezulluar procedurën deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 207 kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione dhe janë miratuar të gjitha;
- 1,578 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, prej të cilave janë realizuar 1,525, ndërsa kanë mbetur vetëm 53 kërkesa në procedurë nga shërbimi i RDPP-së;
- 401 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë aprovuar 384, ndërsa janë refuzuar 3 kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe 14 kërkesa;
- 228 kërkesa për barra tatimore, janë miratuar në tërësi;

- 796 kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe 511 kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë miratuar të gjitha.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 21,975 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kopje të planit;
- 92 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar 89 kërkesa, ndërsa në procedurë kanë mbetur 3 kërkesa;
- 64 kërkesa për bashkim të parcelave - të aprovuar të gjitha;
- 505 kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave), të realizuar të gjitha;
- 876 kërkesa për identifikimin e njësive banesore, nga të cilat janë miratuar 874, ndërsa në procedurë kanë mbetur vetëm 2 kërkesa;
- 118 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 115 dhe në procedurë kanë mbetur 3 kërkesa;
- 246 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 242 dhe 4 kërkesa kanë mbetur në procedurë;
- 260 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, drejtoritë e Komunës së Prishtinës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë miratuar 257 dhe kanë mbetur në procedurë 3 kërkesa;
- 14 kërkesa për ndërrim kulture, nga të cilat janë miratuar 12 kërkesa dhe në procedurë kanë mbetur 2 lëndë;
- 2 kërkesa për plotësim pagese.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka zbatuar më shumë se 90 për qind të planit të paraparë, duke i miratuar, refuzuar ose pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa. E arritur e kësaj drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditësh, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët/subjektet fizike dhe juridike.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër

Aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së pa luajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

Statistikat

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, janar 2015	Nr. i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
Certifikata të pronësisë & kopje të planit	21,975	21,975	0	0
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	3,591	3,457	102	32
Kërkesa zyrtare për historik, historik për persona fizikë dhe juridikë	207	207	0	0
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	1,578	1,525	0	53
Përmirësime në RDPP	401	384	3	14
Barra tatimore	228	228	0	0
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	796	796	0	0
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	511	511	0	0
Ndarjet - parcelimet copëtimet	92	89	0	3
Bashkimi i parcelave	64	64	0	0
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	505	505	0	0
Identifikimi i parcelave dhe njësisve banesore	876	874	0	2
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	118	115	0	3
Ndërrim i kulturës	14	12	0	2
Plotësim pagese - gjeodezi	2	2	0	0
Kërkesat me licencë	246	242	0	4
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	260	257	0	3
Gjithsej:	31,498	31,277	105	116

Takimet me palë

Spektori i kadastrit, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (të martave dhe të enjteve) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjor, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen mesatarisht me 2,548 qytetarë.

Spektori i gjeodezisë ka takime të rregullta me palë, ku gjatë vitit 2015 kemi pranuar 3,179 palë për plotësim të lëndëve, sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, kemi takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Spektori i kadastrit:

- Lëndë të pranuar - 7,348;
- Lëndë të miratuara - 7144;
- Lëndë të refuzuara – 105;

- Lëndë në procedurë – 99.

Sektori i gjeodezisë:

- Lëndë të pranuar - 24,152;
- Lëndë të miratuara - 24,135;
- Lëndë në procedurë – 17.

Takime të tjera

Në drejtori janë mbajtur edhe takime të tjera me palë. Gjithsejtë **5,727** takime për çështje të ndryshme pronësore, nga të cilat takime palët kanë marr rekomandime dhe sugjerime varësisht nga natyra e problemit.

Të tjera

Nga muaji qershor 2015, Drejtorja e Kadastrit ka filluar realizimin e projektit “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore”.

Aktivitetet e realizuara:

Qershor:

- Shpallja e tenderit “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore”, më 17.06.2015, me numër të prokurimit 61615005221;
- Nënshkrimi i kontratës për projektin kapital “Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore”, me numër të prokurimit 61615084221. Ky projekt kapital parashihet të përfundojë për 60 ditë.

Gusht:

- Nënshkrimi i kontratës për realizimin e tenderit “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore”, më 28.08.2015;
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e tenderit “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore” në qytetin e Prishtinës.

Shtator:

- Fillimi i punës dhe menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore”;
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e tenderit “Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në qytetin e Prishtinës”.

Nëntor:

- Menaxhimi dhe mbikëqyrja “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore” ;
- Dorëzimi i tenderit “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore”.

Dhjetor:

- Dorëzimi dhe pranimi i projektit “Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore” dhe punimi i konstatimit për pagesë në prokurim;
- Punimi i konstatimit për pagesë në prokurim për projektin “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore”.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Viti 2015 ishte vit i ristrukturimit dhe fuqizimit të Drejtorisë së Inspeksionit. Gjatë këtij viti përqendrimi ka qëndruar brenda drejtorisë, me qëllim të instalimit të sistemit punues dhe qartësimin të bazës ligjore të Drejtorisë.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Inspeksionit:

- Përpilimi i rregulloreve të nevojshme, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera komunale;
- Digjitalizimi;
- Ristrukturimi;
- Inspektimi dhe mbikëqyrja e vendpunishteve në baza ditore;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Parandalimi i uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale;
- Mbikëqyrja e transportit publik;
- Vendosja e ligjshmërisë për shitësit ambulantë;
- Parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
- Mbikëqyrja e punës së subjekteve juridike në përmbushjen e ligjshmërisë dhe mbrojtjes së shëndetit publik;
- Mbrojtja e ambientit nga ndotja, degradimi dhe dëmtimi.

Aktivitetet e implementuara të Drejtorisë së Inspeksionit:

- Fuqizimi i Inspeksionit:
 - Bartja në objektin e ri;
 - Uniformat;
 - Distinktivat;
 - Identifikimi i veturave të Inspeksionit përmes logos;
 - Tabletat për zyrtarë;
 - Bartja e recepsionit për palë brenda Drejtorisë;
- Mbrojtja e ambientit nga ndotja, degradimi dhe dëmtimi:
 - Identifikimi dhe pastrimi i mbi 100 deponive ilegale;
 - Rrënimi i 119 objekteve të identifikuara si të rrezikshme;
- Parandalimi i uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale:
 - Largimi i mbi 117 veturave të fjetura;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
- Inspektimi dhe mbikëqyrja e vend-punishteve në baza ditore;
- Identifikimi i problematikave të mundshme të procesit të ristrukturimit dhe gjetja e zgjidhjeve të mundshme për ngecjet në fjalë;
- Vizita në terren në baza ditore;
- Bashkëpunimi dhe asistimi i qytetarëve në raste emergjencash.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër:

- Përpilimi i rregulloreve të nevojshme, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera komunale;
- Identifikimi i trajnimeve të nevojshme për stafin;
- Ristrukturimi;
- Digjitalizimi;
- Transferimi i Sektorit të mbrojtjes së pyjeve dhe bujqësisë në Drejtorinë e Inspeksionit;
- Vizita në terren në baza ditore.

Statistikat

Takimet me palë

- Sektori komunal – 705,
- Sektori i komunikacionit – 200,
- Sektori i ndërtimit - 520,
- Sektori sanitar - 220,
- Sektori i përgjithshëm - 200.

Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare: 8 (tetë) kërkesa.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Të pranuar

- Komunal - 718,
- Komunikacion - 1300,
- Sanitar - 311,
- Ndërtim - 854.

Të kryera

- Komunal - 608,
- Komunikacion - 1300,
- Sanitar - 280,
- Ndërtim - 820.